

Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren
QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS
Janar 2014, Prizren

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	2
II. Metodologjia e projektit	3
III. Koncepti i “qytetit gjithëpërfshirës”	4
IV. Të moshuarit dhe planifikimi urban në Prizren	5
V. Gratë dhe planifikimi urban në Prizren	13
VI. Personat me nevoja të veçanta dhe planifikimi urban në Prizren	20
VII. Të rinjtë dhe planifikimi urban në Prizren	28
VIII. Lagjet e varfra/vendbanimet joformale dhe planifikimi urban në Prizren (lagjia Arbana)	36
IX. Mjedisi dhe planifikimi urban në Prizren	44
X. Kultura dhe planifikimi urban në Prizren	52
EC Ma Ndryshe	60

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Qyteti Gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”, që përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, që përkrahet nga Qeveria e Suedisë



I. Hyrje

Ky publikim përmbledh raportet e shtatë ekspertëve, detyra e të cilëve ishte t'i strukturojnë të gjeturat e një cikli të gjatë hulumtues dhe t'i paraqesin ato në formë të dokumenteve udhëzuese për qeverinë lokale të Prizrenit, si kontribut për procesin e planifikimit urban. Autorët e shtatë raporteve që do t'i lexoni në vijim janë shërbyer me të dhëna konkrete nga hulumtimi i zhvilluar me shtatë grupe të komunitetit në Prizren (të moshuarit, gratë, personat me nevana të veçanta, të rinjtë, lagjet e varfra / vendbanimet joformale, mjedisi dhe kultura). Të gjitha raportet janë shkruar duke e respektuar një strukturë standarde, që përfshin: përmbledhjen ekzekutive, hyrjen, situatën aktuale, të gjeturat dhe rekomandimet.

Një numër i madh fokus grupesh janë organizuar fillimisht, për të diskutuar mbi nevojat dhe shqetësimet e shtatë grupeve të interesit. Të gjitha fokus grupet janë fascilituar nga persona që kanë njohuri adekuate mbi grupet përkatëse të komunitetit. Diskutimet në fokus grupe janë orientuar kah identifikimi i nevojave dhe vizionimi i zgjidhjeve për adresimin e shqetësimeve. Në të njëjtën kohë, dy anketime me mostër përfaqësuese kanë identifikuar shqetësimet e qytetarëve të Prizrenit në raport me planifikimin urban. Së fundmi, këto të gjetura janë validuar në debate publike (një për secilin grup të komunitetit), në të cilat kanë marrë pjesë një numër i madh hisedarësh. Të gjitha të gjeturat nga ky cikël i hulumtimit i janë dërguar ekspertëve, të cilët i kanë përpiluar raportet përfundimtare në formë të dokumenteve udhëzuese për qeverinë lokale.

Vizioni i qytetit gjithëpërfshirës përkthehet në ambient fizik përmes projektimit gjithëpërfshirës dhe planifikimit pjesëmarrës. Projektimi gjithëpërfshirës ua mundëson njerëzve nga grupe të ndryshme shoqërore dhe ekonomike që të marrin pjesë në hartim dhe të vlerësojnë projektet. Planifikimi pjesëmarrës është paradigmë e planifikimit urban që mëton përfshirjen e gjithë bashkësisë në proceset strategjike dhe menaxhuese të planifikimit urban. Qasja fillestare të projektimit gjithëpërfshirës është që të binden anëtarët e bashkësisë që të luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e strategjive të herëshme dhe planifikimin e projekteve për qytetin e tyre.

EC Ma Ndryshe është e përkushtuar në nxitjen e ndjenjës së përkatësisë dhe të përgjegjësisë së grupeve të komunitetit ndaj mjedisit të tyre jetësor. Për të arritur këtë, organizata angazhohet në ridefinimin e raportit të qytetarit me qytetin. Ndryshimi esencial që duhet arritur në këtë rast ka të bëjë me shndërrimin e qytetarit nga një marrës (pranues) pasiv i shërbimeve publike në qytetarin pjesëmarrës për definimin dhe rregullimin e mjedisit jetësor dhe në kontribuesin kryesor për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e atij mjedisi. Përmes metodologjisë së "qytetit gjithëpërfshirës", EC Ma Ndryshe ofron një model konkret për ridefinimin e këtij raporti, i cili në të njëjtën kohë është edhe mundësi për të nxitur praktikë demokratike të qeverisjes lokale në fushën e planifikimit urban.

Ky dokument, krahas ofrimit të alternativave të politikave publike, është edhe një thirrje për qeverinë lokale dhe qytetarët për të konceptuar qytetin si hapësirë të përgjegjësisë së përbashkët, e cila duhet të ndërtohet mbi parimet e demokracisë dhe zhvillimit.

II. Metodologjia e projektit

“Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” është projekt tre-vjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t’i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Projekti përkrahet nga Olof Palme International Center dhe ka filluar së zbatuari në muajin janar 2013. Grupet e komunitetit me të cilat po punohet në këtë projekt janë: gratë, të moshuarit, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, banorët e lagjeve të varfra, kultura dhe mjedisi. Me secilin grup të komunitetit, gjatë një viti të projektit organizohen katër fokus grupe dhe një debat publik, ndërsa paralelisht do të zhvillohet procesi i avokimit dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për të siguruar përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në planifikimin urban të qytetit.

Planifikimi urban në Kosovë është një aktivitet teknik dhe i udhëhequr nga ekspertët, që kryesisht bazohet në të dhënat ekzistuese dhe ka pak ndërlidhje me mjedisin (kontekstin) për të cilin hartohet. Kjo praktikë kryesisht prodhon plane që janë jashtë kapacitetit realizues të qeverisë lokale dhe për më tepër, ajo nuk e reflekton realitetin në terren, me ç’rast qytetarët nuk kanë ndjenjë përkatësie. Pjesëmarrja e qytetarëve kufizohet brenda një periudhe të caktuar disa-ditore dhe kryesisht disa ditë para miratimit përfundimtar të planeve.

Ekziston një nevojë imanente për përfshirjen e interesave dhe aspiratave që qytetarëve në planet urbane, e sidomos të atyre grupeve që jetojnë janë të prvuara nga infrastruktura dhe shërbimet adekuate publike. Pjesëmarrja e gjerë e qytetarëve është qenësore që planet urbane të jenë relevante dhe të zbatueshme. Planifikimi urban gjithëpërfshirës ndihmon edhe procesin e demokracisë lokale, duke inkurajuar përfshirjen qytetarë në të gjitha nivelet e procesit. Kjo qasje e re e urbanizmit (Urbanizmi i Ri) sfidon modelin aktual në Kosovë (planifikimin socialist të qyteteve), i cili ofron shumë pak hapësirë për qytetarin.

Projekti do të synojë përmbushjen e këtyre objektivave specifike: [a] Të zhvillojë metodologji dhe qasje gjithëpërfshirëse në planifikimin urban, [b] Të sigurojë lidhjen e munguar mes qytetarëve dhe planerëve urban, [c] Të zhvillojë ndjenjën e përkatësisë së qytetarëve për mjedisin rrethues të jetesës, [d] Të përkthejë interesat dhe nevojat e qytetarëve në plane të zbatueshme urbane, [e] Të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të grupeve të disfavorshme dhe të marginalizuara të shoqërisë, [f] Të promovojë qasjen e integruar të planifikimit urban (social, ekonomik, mjedisor dhe kulturor)

Gjatë secilit vit, metodologjia e projektit parasheh realizimin e fokus grupeve me shtatë grupe të komunitetit, aksioneve / performansave publike me qëllime avokimi (iniciativa komunitare), anketimeve me qytetarë të Prizrenit mbi planifikimin urban, debateve publike dhe raporteve specifike për secilin grup të komunitetit. Në pjesën e fundit të vitit, këto raporte do t’i dorëzohen komunës së Prizrenit dhe fillon faza e avokimit për përfshirjen e shqetësimeve dhe nevojave të qytetarëve në planet urbane të komunës.

III. Koncepti i “qytetit gjithëpërfshirës”

Për Ali Madanipour-in, qyteti “ofrohet dhe menaxhohet nga autoritetet publike”, dhe “shfrytëzohet dhe ndahet nga të gjithë anëtarët e bashkësisë”. Ai është “bota e përbashkët institucionale dhe materiale, hapësirë e ndërmjetme që lehtëson bashkëprezencën dhe rregullon marrëdhëniet ndërpersonale”.¹ Si hapësirë që ndahet barabartë nga të gjithë anëtarët e bashkësisë, dhe si produkt i demokracisë, qyteti poashtu përkufizon dhe shtron rregulla të mirësjelljes dhe respektit për tjetrin.

Konceptet e qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes janë dy koncepte cilësore që shfrytëzohen shpesh në diskutet e fushës së planifikimit dhe zhvillimit. Programi i UN Habitatit e përkufizon qytetin gjithëpërfshirës si qytet që promovon zhvillimin me drejtësi. Qyteti gjithëpërfshirës “është vendi ku të gjithë, pavarësisht mundësive të tyre ekonomike, racës, gjinisë, etnisë apo fesë, mund të marrin pjesë plotësisht në të gjitha mundësitë shoqërore, ekonomike dhe politike që i ofron qyteti”. Sipas këtij programi drejtësia është një nga tri shtyllat e qëndrueshmërisë, dhe më e rëndësishmja që është thelbësore në krijimin e të ardhmës urbane të qëndrueshme dhe të përbashkët. (UN-Habitat, 2001)

Vizioni i qytetit gjithëpërfshirës përkthehet në ambient fizik përmes projektimit gjithëpërfshirës dhe planifikimit pjesëmarrës. Projektimi gjithëpërfshirës ua mundëson njerëzve nga grupe të ndryshme shoqërore dhe ekonomike që të marrin pjesë në hartim dhe të vlerësojnë projektet. Planifikimi pjesëmarrës është paradigmë e planifikimit urban që mëton përfshirjen e gjithë bashkësisë në proceset strategjike dhe menaxhuese të planifikimit urban. Qasja fillestare të projektimit gjithëpërfshirës është që të binden anëtarët e bashkësisë që të luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e strategjive të herëshme dhe planifikimin e projekteve për qytetin e tyre. Me anë të përfshirjes së gjithë bashkësisë, problemet e vërteta, burimi i tyre dhe zgjidhjet potenciale parashtrihen dhe diskutohen në punëtori të ndryshme. Projektet dhe idetë që rrjedhin nga një punë e tillë me bashkësinë zakonisht janë të lidhura me kontekstin, dalin nga nevojat dhe kultura e bashkësisë dhe mjedisi në të cilin ato ekzistojnë. Falë pjesëmarrje të madhe, bashkësia do të kenë një sens të fortë pronësie dhe përkushtimi ndaj projektit.

Në manualin “Qyteti gjithëpërfshirës” Goltsman and Iacofano e paraqesin planifikimin gjithëpërfshirës të qytetit si zgjidhje “të bazuar në politikat e ndjeshme ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe kulturore që ua lejojnë të gjithëve të përmirësohen ekonomikisht bashkë me përmirësimin e hapësirës ku jetojnë”. Ata theksojnë se qytetet kanë nevojë për mënyrë planifikimi që e njeh të drejtën e përfshirjes të secilit njeri në proceset zhvillimore: “përmes pjesëmarrjes, njerëzit mund t’i japin formë mjedisit të tyre për t’i përmbushur nevojat e tyre.” Grupet me të prekura zakonisht rrallë përfshihen në proceset planifikuese meqë u mungojnë shkathtësitë, dija dhe informata. Kjo krijon pastaj rrezikun e mospërfshirjes së nevojave të tyre në planifikimin urban, që më tutje pasqyrohet me keqësimin e mjedisit të tyre jetësor. Për t’i adresuar këto problem, autorët e lartpërmendur sugjerojnë procesin e projektimit gjithëpërfshirës të bazuar në tri kategori: funksionalitet (projektim që ngërthen të gjithë tipet e individëve), ndjeshmëri kontekstuale (harmonia me mjedisin rrethues) dhe impakt të drejtësisë për të “zvogëluar impaktin shoqëror dhe njerëzor tek anëtarët më të prekur të shoqërisë”.²

¹ Madanipour, Ali, (2003) *Public and Private Spaces of the City*, Routledge

² Goltsman, S, Iacofano, D, (2007), *The Inclusive City: Innovative Solutions for Buildings, Neighborhoods, and Urban Spaces*, MIG Communications).

IV. Të moshuarit dhe planifikimi urban në Prizren

Infrastruktura fizike dhe shërbimet publike

Shkruar nga, Fisnik Minci

Përmbledhje ekzekutive

Planifikimi urban është një proces teknik dhe politik që ka të bëjë me shfrytëzimin e tokës dhe projektimin e mjedisit urban, duke përfshirë rrjetet e transportit, për të udhëhequr dhe për të siguruar zhvillimin e rregullt të vendbanimeve dhe të komuniteteve. Përmban në vete hulumtime dhe analiza, të menduarit strategjik, arkitekturë, projektim urban, konsultim publik, rekomandime të politikave, zbatim dhe menaxhim³. EC Ma Ndryshe duke i parë zhvillimet negative në këtë sektor në Prizren është angazhuar në stimulimin e konsultimit publik në mënyrë që me pjesëmarrjen qytetare të rinovohen Planet Rregullative Urbane të qytetit, për të sjellë një dinamikë të re të planifikimit të qëndrueshëm, për të balancuar interesat e komunitetit dhe biznesit, por edhe për të ruajtur traditën arkitektonike dhe trashëgiminë kulturore.

Praktikat e mira në vendet perëndimore kanë treguar se përfshirja e qytetarëve në bërjen e vendit ka pas ndikim në zgjimin e shpirtit të fjetur të qyteteve. Si rrjedhojë koncepti i “planifikimit gjithëpërfshirës” i iniciuar në vitet e 70’ta ka gjetur zbatim të gjerë në vendet që promovojnë vlerat demokratike. Sfidat e zhvillimit hapësinor dhe urban kanë të bëjnë me sfida ditore. Grupe të ndryshme shoqërore kanë kërkesa të lloj-llojshme si për lagjet e tyre ashtu edhe për qytetin si tërësi. Në mesin e këtyre grupeve shoqërore bëjnë pjesë edhe të moshuarit. Të moshuarit e Prizrenit kanë vënë në pah një morri sfidash kundruall urbanizmit dhe planifikimit hapësinor.

Të gjeturat e konsultimit me ta tregojnë se të moshuarit janë të brengosur në shkallë të gjerë me mungesën e Shtëpisë së Pleqve për takime ditore. Bllokimi i trotuareve, uzurpimi i pronës/hapësirës publike është një çështje tjetër që shkakton neveri te ky grup i shoqërisë. Degradimi urbanistik, mospërmbushja e kushteve teknike në ndërtesat e banimit kolektiv, tejkalimi i lejeve ndërtimore dhe ndërtimet pa leje janë po ashtu brenga të moshuarve, që në kujtesën e tyre kanë një imazh tjetër të Prizrenit. Edhe cilësia e ulët e shërbimeve shëndetësore dhe mos mirëmbajtja e duhur e parqeve paraqesin burim të shqetësimit për këtë grup, që ankohet edhe për mungesë të ujit të pijes, mbeturinat dhe ndotjen akustike.

Rekomandimet shkojnë në atë drejtim që Komuna e Prizrenit duhet të siguroj kushte jetese që i përshtaten qytetarëve të të gjitha grupmoshave. Një nga detyrat qenësore të zhvillimit urban në Prizren në vitet e ardhshme duhet të jetë përfshirja e të moshuarve në jetën shoqërore dhe kapitalizmi nga përvoja e tyre jetësore. PO ashtu, strategjitë kryesore të procesit të PZHKP, nuk duhet të mbesin në nivel deklarativ, por në praktikë duhet të ofrojnë një qasjeje integruese dhe sigurimin e pjesëmarrjes dhe në këtë drejtim duhet të krijohen mekanizma, që do të siguronin kontributin edhe nga të moshuarit. Autoritetet komunale përgjegjëse për planifikimin hapësinor e urban duhet të promovojnë konsultimin publik, që ngërthen në vete edhe mendimin strategjik, hulumtimet, analizat, propozimet, etj, që vijnë nga banorët dhe shoqëria civile, pa favorizim të bizneseve. Ndërsa të moshuarit rekomandojnë decentralizimin brenda komunës, respektivisht funksionalizimin e bashkësive të dikurshme lokale, si dhe vendosjen e standardeve që mundësojnë pjesëmarrjen e të moshuarve në debatet publike, duke nisur nga tryeza gjithëpërfshirëse për ndërtimin e Shtëpisë së Pleqve.

³ Taylor, Nigel (2007). Urban Planning Theory since 1945, London, Sage

Hyrje

Domosdoshmëria e përfshirjes së të moshuarve në planifikimin urban rrjedhë nga fakti se e ardhmja e njerëzimit do të jetë e vjetër dhe urbane. Sipas një hulumtimi të Departamentit për Çështje Ekonomike dhe Sociale të Kombeve të Bashkuara⁴ del se në vitin 2050 për herë të parë në historinë e njerëzimit, do të ketë më shumë njerëz mbi moshën 60 vjeçare se sa fëmijë mes moshës 0-14 vjeç. Dhe asnjë pjesë e botës nuk bën përjashtim nga procesi i urbanizmit. Në këtë rast, edhe pse Kosova në përgjithësi dhe Prizreni në veçanti kanë një popullatë relativisht të re, megjithatë duhet t'i kushtojnë rëndësi të posaçme nevojave të komunitetit të moshuarve, në aspektin e urbanizmit dhe të planifikimit hapësinor, pasi që personat mbi 65 vjeç përbëjnë 6.41 për qind të popullatës së Prizrenit, me tendencën që kjo përqindje të rritet në dekadat e ardhshme.

Të dhënat e regjistrimit të fundit të popullsisë në Kosovë⁵ tregojnë se Kosova ka gjithsej 1,739,825 banorë, me 116,785 banorë mbi moshën 65 vjeçe, prej të cilëve 44,398 jetojnë në zonat urbane dhe 72,387 në zonat rurale. Mirëpo ky raport ndryshon në komunën e Prizrenit. Nga 177,781 banorë të Prizrenit, 11,404 janë të moshuar, ku 6,499 sosh jetojnë në zona urbane dhe 4,905 në ato rurale. Pra që prej vitit 2011, Prizreni ka më shumë të moshuar në zonat urbane dhe si rrjedhojë planifikimi hapësinor duhet t'i përfshijë nevojat e tyre në mënyrë që ata të kenë një ambient më të mirë dhe më të lehtë jetësor.

Studiuesit Marcello Martinoni dhe Alma Sartoris në hulumtimin e tyre lidhur me kriteret që duhet t'i përmbush qyteti për të moshuarit⁶ theksojnë se njëra nga pyetjet themelore që duhet shtruar është se çka nënkuptojmë me termin "të moshuar"? Sipas tyre ekziston një tendencë që "të vjetrit" të njëjtësohen me "të paftit".

Duke e cituar Wannerin dhe të tjerët (2005), Martionion dhe Sartoris shpjegojnë se sot të qenit i moshuar nënkupton personin mbi moshën 65 vjeçe, që sapo është pensionuar, që ka disa hobi dhe po ashtu ndonjë të afërm e miq, që e shijon kohën e lirë. Por këta studiues vlerësojnë se duhet të zhvillohet një perspektivë e re në të cilën në vend se të përfaqësojnë problem, personat e moshuar mund të jenë aktivë dhe të luajnë rol në hapësirën urbane.

Koncepti i të moshuarit të suksesshëm sipas Rowes dhe të tjerëve (1997) që përmenden nga Martionion dhe Sartoris ka të bëjë me tri komponentë kryesore: probabilitet të ulët të sëmundjes ose paftësisë që lidhet me sëmundjen, kapacitetin e lartë të funksionimit njohës dhe fizik dhe angazhimit aktiv me jetën. Në të njëjtën kohë autorët bazuar në Barton dhe të tjerët (2004), Lawrence (1996) dhe WHO (2001) vlerësojnë se cilësia e jetesës në përgjithësi varet më shumë nga ndërveprimi i frytshëm me mjedisin jetësor në format e saj të ndryshme sesa nga çështja e gjendjes shëndetësore.

⁴ United Nations Department of Economic and Social Affairs/Population Division, Living Arrangements of Older Persons Around the World, <http://www.un.org/esa/population/publications/livingarrangement/introduction.pdf>

⁵ Agjencia e Statistikave të Kosovës, Të dhënat demografike sipas komunave, <http://esk.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore%20demografike%20sipas%20komunave.pdf>

⁶ Marcello Martinoni & Alma Sartoris, Criteria for the elderly people city? Simplify the complexity to act in concrete terms, http://www.nfp54.ch/files/nxt_projects_86/21_07_2011_09_30_28-NFP54ALTERNDEGESELLSCHAFTCriteriafortheelderlypeoplecity.pdf

Prandaj propozimi që këta japin, me mbështetje në të gjeturat e Creedy dhe të tjerëve (2007), është se urbanizmi duhet të përballlet me sfida të reja, ku bashkë me zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme edhe përfshirja sociale e banimi i përshtatshëm do të jenë përcaktuesit kryesorë të zhvillimit urbanistik. Prandaj, Martionion dhe Sartoris theksojnë se është e domosdoshme që të ketë një qëndrim shumë sektorial për të zbatuar politika të qëndrueshme urbane.

Ndërsa Enrico Sassi dhe Elena Molteni që kanë punuar paralelisht me Martionion dhe Sartoris në projektin “UrbAging - Designing urban space for an aging society” (Dizajnimi i hapësirave publike për një shoqëri në plakje⁷), në kuadër të punimit të tyre shpjegojnë se hapësira urbane përballlet me shumë sfida në të njëjtën kohë dhe se rritja e shpejtë e qyteteve, zhvendosja demografike dhe kërkimi për rritjen e cilësisë së jetesës janë të ndërlidhura mes vete.

Për tu përqendruar në cilësinë e ambientit të ndërtuar, Sassi dhe Molteni, theksojnë se duhet të jemi të vetëdijshëm për rëndësinë e marrëdhënieve ndërmjet gjeneratave, të cilat krijojnë një shoqëri më të fortë dhe më të ekuilibruar në aspektin social. Sipas tyre ambienti i ndërtuar mund t'i nxisë këto marrëdhënie, me kushte të caktuara. Përzjerja e përshtatshme e funksioneve dhe mundësimi i qasjes në vende të njëjta për moshë dhe grupe të ndryshme sociale, janë kriteret kryesore për hapësirën e ndërtuar që të kontribuojë në ekuilibrin social të shoqërisë, por edhe krijimin e një hapësire të qëndrueshme urbane.

Shembujt pozitiv të aplikimit të këtyre kriterëve janë qytetet e Lluganos dhe Usterit në Zvicër, për të cilat janë kryer hulumtimet e sipërpërmendura. Mirëpo shembuj të ngjashëm të përfshirjes së të moshuarve në planifikimin urban mund të hasen edhe në vendet tjera, si qyteti i Manchesterit.

Ndërkaq qyteti i Vjenës ka dhënë një shembull mjaft të mirë në vitin 2005, kur Drejtoria komunale për Urbanizëm e Planifikim Hapësinor ka iniciuar projektin “sALTo”⁸, për të hulumtuar se si qyteti mund ti ndihmojë të moshuarit që të jetojnë me dinjitet dhe të pavarur në lagjet e tyre. Informatat e grumbulluara me këtë hulumtim i kanë ndihmuar komunës që të përpilojë plane dhe politika më të mira urbane, sikurse edhe programe më të mira parandaluese shëndetësore për të moshuarit në lëvizje. Për këtë projekt Vjena është dekoruar me disa çmime ndërkombëtare.

Rrjedhimisht, komuniteti i të moshuarve mund të ofrojë kontributin në planifikimin urban marrë parasysh se si pjesë e shoqërisë posedon njohurinë, përvojën dhe aftësinë, të grumbulluar gjatë viteve të aktivitetit në shoqëri.

Situata aktuale

Situata aktuale e komunitetit të moshuarve në raport me planifikimin urban në komunën e Prizrenit nuk është shumë e favorshme. Ata nuk janë përfshirë në konsultimet publike lidhur me planet urbane të komunës së Prizrenit dhe si rrjedhojë sfidat me të cilat ata ballafaqohen në këtë drejtim mbeten të pazgjdhura.

⁷ Enrico Sassi & Elena Molteni, Design of public space in the city of the elderly, http://www.nfp54.ch/files/nxt_projects_86/21_07_2011_09_31_24-NFP54ALTERNDEGESELLSCHAFTDesignofpublicspaceinthecityoftheelderly.pdf

⁸ NYC Global Partners' Innovation Exchange, Best Practice: Urban Planning to Support Seniors, http://www.nyc.gov/html/unccp/gprb/downloads/pdf/Vienna_Salto.pdf

Autoritetet e planifikimit hapësinor para se t'i finalizojnë të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor përmes njoftimit publik duhet t'i ftojnë qytetarët dhe të zhvillojnë konsultime dhe shqyrtime publike. Në të njëjtën kohë duhet që të sigurojnë pjesëmarrjen e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor⁹.

Udhëzimi Administrativ 54/2005 i MMPH-së për zbatimin e ligjit për planifikim hapësinor lidhur me procedurën e shqyrtimit publik për planet hapësinore dhe urbanistike thekson se "duke promovuar qeverisjen e mirë, Ministria dhe Komunitat do të marrin parasysh nevojat e veçanta të PAK-ve, të moshuarve, grave, minoriteteve dhe të rinjve"¹⁰ dhe se do të inkurajojnë pjesëmarrjen transparente publike.

Ndërkaq komunitat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës¹¹. Po ashtu Kuvendi i Komunës, komitetet dhe komisionet e tij, para miratimit të rregulloreve komunale, duhet të mbajnë konsultime publike, duke i ofruar publikut informata të nevojshme për propozime¹².

Praktikat e zbatuara nga komuna e Prizrenit në dekadën e fundit nuk i kanë përmbushur këto dispozita ligjore në raport me grupin e të moshuarve. Në fakt, komuna ka organizuar debate publike dhe i ka ftuar qytetarët për pjesëmarrje me shpallje publike, mirëpo nuk ka bërë përpjekje tjera për të siguruar pjesëmarrjen e publikut, e aq më pak të grupeve të veçanta të komunitetit, siç është ai i të moshuarve.

Së fundmi, Kuvendi Komunal i Prizrenit ka miratuar edhe Planin Zhvillimor Komunal, ku analiza sociale nuk i ka përfshirë të moshuarit si grup të veçantë të komunitetit dhe nevojat e tyre në kuadër të planifikimit strategjik të zhvillimit të ardhshëm të komunës. Megjithatë, strategjitë kryesore të procesit të PZHKP, ndër të tjera përfshijnë edhe ofrimin e një qasjeje integruese dhe sigurimin e pjesëmarrjes dhe në këtë drejtim mund të krijohen mekanizma, që do të siguronin kontributin edhe nga të moshuarit.

Të moshuarit të mbledhur nën ombrellën e Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës kanë shprehur gatishmëri që të marrin pjesë në konsultimet publike, që organizohen nga autoritetet, qoftë në hapësirat e komunës qoftë në ambientet e kësaj organizate, në mënyrë që të adresojnë propozimet dhe shqetësimet e tyre, me qëllim të kapërcimit të vështirësive urbanistike, me të cilat ballafaqohen në jetën e përditshme.

Të gjeturat

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren" gjatë vitit 2013 ka organizuar katër fokus grupe dhe një debat publik me komunitetin e personave të moshuar, ndërkohë që ata i ka përfshirë edhe në

⁹ Neni 20, Ligji për Planifikimin Hapësinor, <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20planifikimin%20hapesinor.pdf>

¹⁰ Neni 3, paragrafi 4 Udhëzimi Administrativ 54/2005 i MMPH, http://mmp-h-rks.org/repository/docs/UA_54_2005.pdf

¹¹ Neni 68, Ligji për Vetëqeverisje Lokale, http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf

¹² Neni 91, Statuti i Komunës së Prizrenit, http://kk.rks.gov.net/prizren/getattachment/Home/satuti_komunes_tetor_2008_04_12.pdf.aspx

hulumtimin përmes anketimit, që ka shërbyer si bazë për hartimin e një analize mbi preokupimet e qytetarëve në lidhje me çështjet urbanistike në qytetin e Prizrenit.

Të gjeturat në kuadër të këtyre aktiviteteve shpalosin sfidat, problemet dhe kërkesat me të cilat ballafaqohen të moshuarit në raport me urbanizmin dhe planifikimin hapësinor. Megjithatë, në të gjitha takimet të moshuarit si problem dhe brengë kryesore kanë identifikuar statusin e tyre social, që buron nga shuma e ulët e pensioneve dhe statusi i pazgjdhur i Fondit Pensional të Kosovës, për të cilën gjë kanë kërkuar një angazhim dhe kujdes më të madh nga institucionet shtetërore.

Analiza e hulumtimit¹³ tregon se nga 249 të intervistuar rreth 11 për qind të respondentëve kanë qenë mbi moshën 65 vjeçare dhe se nga këndvështrimi i këtyre të moshuarve prioriteti kryesor është ndërtimi i një hapësire për takimin e të moshuarve. 80 për qind të respondentëve mbi moshën 65 vjeçare mendojnë se u mungon një hapësirë e dedikuar, pastaj 50 për qind janë të shqetësuar me bllokimin e trotuareve, 30 për qind kërkojnë mirëmbajtje më të mirë të trotuareve gjatë dimrit, ndërkohë që 30 për qind mendojnë se ndërtimet pa leje janë problem, 26,7 për qind ankohen për qasjen në institucione shëndetësore dhe 20 për qind për mungesën e hapësirave gjelbra, etj.

Ndërsa sa i përket temave që kanë të bëjnë me planifikimin urban, që janë diskutuar në fokus grupe dhe në debat, të moshuarit kanë veçuar çështje të ndryshme, të cilat në thelb kanë ngjashmëri me shqetësimet e dala nga anketimi.

Mungesa e Shtëpisë së Pleqve për takime ditore

Të moshuarit në dy fokus grupe kanë kërkuar që në kuadër të investimeve kapitale të komunës së Prizrenit të përfshihet projekti për ndërtimin e shtëpisë së pleqve. Sipas tyre gjatë caktimit të lokacionit duhet të merren parasysh kërkesat e të moshuarve. E njëjta vlen edhe për hartimin e planit. Të moshuarit kanë bërë të ditur se ka përfaqësues të komunitetit që janë të gatshëm që të dhurojnë pronën e tyre për ndërtimin e një shtëpie të tillë.

Bllokimi i trotuareve, uzurpimi i pronës/hapësirës publike

Në Fokus Grup është përmendur problemi i theksuar i parkingjeve në qytet, që për pasojë ka sjellë që trotuaret të bllokohen nga automjetet ndërkohë që këmbësorëve u pengohet lëvizja e lirë. Gjithashtu është cekur parkimi i automjeteve mu në hyrjet e banesave kolektive, që është përshkruar si një praktikë neveritëse. Pastaj vendosja e shkallëve të lokaleve në trotuare. Të moshuarit kanë bërë të ditur se në lokacionin e quajtur “4 Kullat” platforma që ka shërbyer si kënd lojërash për fëmijët e këtyre banesave kolektive është uzurpuar dhe në të është ndërtuar një shtëpi katërkatëshe pa asnjë leje urbanistike. Uzurpimet janë përmendur në pjesë të ndryshme të qytetit.

Degradimi urbanistik

Të moshuarit kanë shprehur brengën se mungesa e planifikimit të mirëfilltë dhe aferat korruptive të dhënies së lejeve të ndërtimit kanë ndikuar në shkatërrimin e arkitekturës karakteristike të Prizrenit. Si raste konkrete të degradimit urbanistik janë përmendur projektet e ndërtesave shumëkatëshe të banimit kolektiv në lagjet “Jeni Mëhallë”, te Stacioni i Autobusëve, “Terzimahallë”, etj. Është theksuar se në disa pika të qytetit janë ndërtuar banesa të tilla pa analizën e duhur urbanistike, planifikuese, ambientale, etj. Është potencuar se në lokacionet ku diku kanë jetuar nga 30 familje janë ndërtuar banesa për më shumë se 200 familje që paraqesin një ngarkesë të madhe për rrjetin e kanalizimit,

¹³ EC Ma Ndryshe, Planifikimi urban për qytetarët, 2013, http://ecmandryshe.org/repository/docs/ANALIZA_Planifikim_urban_per_qytetarët.pdf

ujësjellësin, rrugët, por edhe për ambientin përreth ngase në të shumtën e rasteve është uzurpuar prona publike e gjelbër, që nuk i është kthyer komunitetit si park apo kopsht, që do të shërbenin për aktivitetet rekreative ditore të fëmijëve, rinjve, prindërve dhe të moshuarve.

Mospërmbushja e kushteve teknike në ndërtesat e banimit kolektiv

Pensionistët kanë shprehur qëndrimin se disa ndërtesa të banimit kolektiv nuk kanë dalje emergjente dhe se në 2-3 rastet e fundit të shpërthimit të zjarreve është vërejtur rreziku që një gjë e tillë paraqet për jetën e banorëve të këtyre ndërtesave, ndërkohë që pamundësohet edhe intervenimi efikas i zjarrfikësve. Sipas tyre çdo ndërtesë duhet të ketë shkallët për dalje emergjente, sikurse edhe hidrantin në secilin kat, që nuk është rasti në Spital, në banesat e ndryshme në Ortakoll, te 4 Kullat, te Stacioni i Autobusëve dhe të tjera.

Tejkalimi i lejeve ndërtimore

Të moshuarit janë ankuar për ndërtimet e larta që nuk i përmbahen lejeve ndërtimore dhe kriterëve urbanistike, sikurse edhe për ndërtimet pa leje në zonën e parë të mbrojtur. Sipas tyre afër ish-tregut të bulmetit është ndërtuar një ndërtesë e banimit kolektiv, derisa të gjitha ndërtesat përreth saj janë shtëpi individuale. E njëjta ankesë vlen edhe për hapësirën në ish-Shtypshkronjë. Të moshuarit kanë kërkuar të dinë se kush i lëshon këto leje, a i monitoron dikush zbatimin e tyre dhe për çfarë shërben Inspektorati nëse nuk arrin që t'a ndaloj degradimin urbanistik të qytetit, që sipas tyre në vitet e fundit ka marrë përmasa alarmante, saqë është ndryshuar edhe struktura e lagjeve të tëra në afërsi të qendrës së qytetit. Zyrtarë të DUPH-së kanë pranuar se rreziku më i madh është mundësia e miratimit të Ligjit për Legalizimin e objekteve pa leje, që sipas tyre do ta legalizonte krimin urbanistik dhe institucionet do të viheshin para aktit të kryer.

Cilësia e ulët e shërbimeve shëndetësore

Të moshuarit janë ankuar se shërbimet shëndetësore në mjekësinë primare nuk janë të cilësisë së lartë dhe se personeli teknik e mjekësor nuk i kushton rëndësi të madhe mirësjelljes dhe trajtimit të moshuarve.

Mos mirëmbajtja e duhur e parqeve

Mos mirëmbajtja e duhur e parqeve në qytet është vlerësuar si një zhvillim negativ nga të moshuarit. Sipas tyre kompleksi i Marashit edhe pse është nën mbrojtje institucionale nuk e gëzon kujdesin e duhur, ngase ka qarkullim e parkim automjesh, uzurpim të kopshteve nga bizneset lokale dhe injorim total të kërkesave të banorëve të kësaj ane. Parku i Qytetit sipas të moshuarve edhe pse është rregulluar me donacionin e Ankarasë së Turqisë, është në shkatërrim e sipër për shkak të mungesës së mirëmbajtjes së duhur, me ç'rast janë evidentuar dëmtime të ulëseve, shtyllave, kubëzave, etj.

Çështje tjera

Disa nga shqetësimet e tjera të ngritura gjatë diskutimeve me të moshuarit janë: mungesa e ujit të pijes, mbeturinat në ish-Stacionin e hekurudhës dhe prania e qenve endacakë, vendosja e Luna Parkut në Qendrën Sportive shqetëson banorët e lagjeve përreth, ndotja akustike, etj.

Rekomandimet

Rekomandimi 1: Duke i marrë për bazë të gjitha këto, një nga rekomandimet e fuqishme të komunitetit të moshuarve për zgjidhjen e çështjeve të sipërpërmendura ka qenë nevoja për decentralizimin brenda komunës, respektivisht funksionalizimin e bashkësive të dikurshme lokale, si brenda qytetit ashtu edhe në fshatrat e komunës së Prizrenit.

Të moshuarit kanë shpjeguar se organizata e pensionistëve dhe invalidëve të punës funksionon dhe mban kontaktin me bazën në saje të disa njësive lokale në lagjet e fshatrat e qytetit dhe se kjo praktikë ka mundësuar adresimin më të drejtë të prioriteteve.

Pensionistët kanë përkujtuar se bashkësitë lokale dikur kanë qenë aktive dhe se kjo strukturë e organizimit komunitar mund të sjellë dobi në përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, pasi që problemet, shqetësimet, propozimet dhe projektet prioritare do të diskutoheshin pikë së pari në bashkësi lokale dhe më pas udhëheqja e bashkësisë lokale do t'i adresonte ato te menaxhmenti i komunës së Prizrenit.

Ata kanë bërë të ditur se Prizreni ka shumë lagje të mëdha, me numër të konsiderueshëm të banorëve, përfshirja e të cilëve në vendimmarrje nuk mund të konsumohet nga komuna, në përbërjen aktuale të formacioneve të vetëqeverisjes.

Sipas tyre, bashkësitë lokale do të kishin rolin e qendrave komunitare, ku popullata e lagjeve të caktuara do të mbledhej për të diskutuar për adresimin e problemeve dhe gjetjen e zgjidhjeve, në bashkëpunim me udhëheqjen komunale, ndërkohë që në shumicën e kohës objektet do t'i jepeshin në përdorim të rinjve, grave, profesionistëve, të moshuarve, etj. sipas një orari të caktuar për t'u shoqëruar dhe për të realizuar aktivitete rekreative të ndryshme.

Aktivizimi i bashkësive lokale sipas të moshuarve pos që do të kishte dobi për komunitetet lokale ato do të ishin të frytshme edhe për komunën, ngase në këtë mënyrë përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje do të ishte më efikase, njëjtë sikurse edhe përcaktimi i projekteve prioritare në interes të qytetarëve të komunës.

Rekomandimi 2: Të moshuarit, po ashtu kanë rekomanduar që komuna të vendos standarde që mundësojnë pjesëmarrjen e të moshuarve në debatet publike të Komunës, për çështje të interesit publik.

Rekomandimi 3: Ata kanë rekomanduar organizimin e një tryeze të përbashkët (komuniteti i të moshuarve, Komuna, shoqëria civile, biznesi, donatorët), që do të shërbente si platformë për iniciimin e konsultimeve publike për ndërtimin e Shtëpisë së Pleqve.

Rekomandimet e autorit të raportit:

Rekomandimi 4: Komuna e Prizrenit duhet të siguroj kushte jetese që i përshtaten qytetarëve të të gjitha grupmoshave.

Rekomandimi 5: Një nga detyrat qenësore të zhvillimit urban në Prizren në vitet e ardhshme duhet të jetë përfshirja e të moshuarve në jetën shoqërore dhe kapitalizmi nga përvoja e tyre jetësore. Gjithashtu edhe promovimi i pavarësisë së të moshuarve në hapësirën publike.

Rekomandimi 6: Strategjitë kryesore të procesit të PZHKP, nuk duhet të mbesin në nivel deklarativ, por në praktikë duhet të ofrojnë një qasjeje integrale dhe sigurimin e pjesëmarrjes dhe në këtë drejtim duhet të krijohen mekanizma, që do të siguronin kontributin edhe nga të moshuarit.

Rekomandimi 7: Autoritetet komunale përgjegjëse për planifikimin hapësinor e urban duhet të promovojnë konsultimin publik, që ngërthen në vete edhe mendimin strategjik, hulumtimet, analizat, propozimet, etj, që vijnë nga banorët dhe shoqëria civile, pa favorizim të bizneseve.

Rekomandimi 8: Të rriten aktivitetet inspektuese dhe kontrollet si në Qendrën Historike të Prizrenit ashtu edhe në pjesët tjera të qytetit.

Rekomandimi 9: Të stimulohet kohezioni social përmes raporteve të duhura ndërmjet hapësirës publike dhe private.

Rekomandimi 10: Pas miratimit të PZHKP-së, të nisë menjëherë procesi për hartimin e Planit Zhvillimor Urbanistik 2014-2025+, në bashkëpunim me të gjitha grupet shoqërore dhe në partneritet me shoqërinë civile.

V. Gratë dhe planifikimi urban në Prizren

Amviset dhe Nënata e vetme

Shkruar nga, Eli Gashi

Përmbledhje Ekzekutive

Qyteti gjithëpërfshirës nuk është koncept i ri, prandaj diskutime dhe teori të shumta janë zhvilluar lidhur me përfshirjen e banorëve në planifikim të qytetit. Pjesëmarrja e grupeve, pa dallim race, gjinie, besimi fetar, në planifikim të qytetit duhet të konsiderohet si e drejtë elementare. Diskutimi për këtë çështje mund të zhvillohet nga dy aspekte: si e *drejtë elementare* e qytetarit të marr pjesë në vendimmarrje për hapësirën në të cilën jeton, punon dhe investon; si dhe *obligim i Komunës* të marr mendimin dhe aprovimin e taksapaguesve për çfarëdo plani që krijon apo/edhe ndryshon. Investimet në hapësirën publike nga ana e Komunës janë investime nga buxheti i krijuar me taksat e qytetarëve, prandaj është detyrë e Komunës të përfshijë komunitetin e saj në këtë proces.

Ky raport diskuton pjesëmarrjen e grave në planifikim urban, dhe ka për qëllim të sjell në pah relacionin që gratë kanë me qytetin; pabarazitë (gjinore) në relacion me planifikimin urban; jetën e përditshme të grave, si dhe mënyrën se si qyteti si hapësirë prodhon dhe riprodhon norma dhe identitete gjinore.

Analiza e publikuar në shtator 2013 “Planifikim urban për qytetarët”, tregon se praktikrat e planifikimit urban, apo planifikimit të qytetit, nuk dallojnë shumë nga praktikrat tjera zhvillimore, të cilat gjithmonë zhvillohen mbi marrëdhëniet e fuqisë, praktika këto me nuanca patriarkale.

Qyteti i Prizrenit ka një plan zhvillimor, mirëpo ka anashkaluar dhe nuk ka konsultuar gratë të cilat e popullojnë qytetin. Në pesë fokus grupe të organizuara me gratë (kryesisht amvise dhe nëna të vetme), brenga me të cilën janë identifikuar të gjitha grupet ishte mospërfshirja e grave në diskutimet rreth planifikimit urban.¹⁴ Në mënyrë specifike janë ngritur këto çështjet: degradimi i qytetit, transporti urban, siguria, okupimi i hapësirës publike, mungesa e hapësirës për persona me nevoja të veçanta, etj. Të gjitha këto çështje do të diskutohen më gjerësisht në pjesën e tretë të raportit.

Disa nga rekomandimet nga takimet me grupet e grave ishin:

Për institucionet: a) të krijohen mekanizma për pjesëmarrje të grave gjatë takimeve për planifikim të qytetit; b) të ftohen gratë në dëgjimet publike që organizon Komuna e Prizrenit.

Për gratë: a) të ketë organizim në nivel të lagjeve, ndërtesave, duke zgjedhur nga një përfaqësuese për secilën ndërtesë të banimit kolektiv apo lagje, me qëllim që të përcjellin informatat e rëndësishme për çështjet publike të qytetit tek Komuna¹⁵ dhe anasjelltas.

Për shoqërinë civile: a) krijimi i mekanizmave për avokim në nivel lokal dhe qendror rreth involvimit të grave në planifikim urban; b) të krijojë mundësi për bashkëbisedim mes qytetarëve dhe udhëheqësve të planifikimit urban brenda Komunës etj

¹⁴ Nga analiza “Planifikim urban për qytetarët” vetëm 33.3% e pjesëmarrësve gra kanë deklaruar se kanë informatë që qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me qytetin.

¹⁵ Përgjatë raportit do të përdorë Komuna duke iu referuar Kuvendit Komunal dhe departamenteve përkatëse brenda Komunës.

Hyrje

Trendet në zhvillimin urbanistik, gjinia dhe teoritë feministe

Studimet gjinore dhe ato të zhvillimit urban edhe pse mbesin të ndara mund të bashkëtojnë duke intervenuar njëra tek tjetra. Në përgjithësi studimet gjinore fokusohen në relacionet shoqërore dhe relacionet gjinore; implikimet ekonomike dhe politike të ndarjes së pushteti mes burrave dhe grave në hapësirën publike dhe atë private. Studimet gjinore, në mënyrë specifike në Kosovë, nuk kanë treguar ndonjë interesim në studimin e planifikimit të hapësirës publike. Është e rëndësishme të theksohet se gratë dhe burrat nuk kanë relacion të njëjtë me qytetin, ata/o e përjetojnë dhe e shohin ndryshe qytetin, dhe kjo vjen si rezultat i roleve të përcaktuara, apo më mirë të themi të konstruara gjinore

Raporti në vijim do të trajtoj brengat, kërkesat dhe rekomandimet e grave që janë nëna të vetme dhe amvise.¹⁶ Kjo është për arsye se brenda grupit të grave ka dallime të mëdha në mënyrën se si ato e shohin dhe e përjetojnë qytetin dhe çfarë do të thotë qyteti për ato. Lëvizja e grave në Kosovë mund të konsiderohet si lëvizje e suksesshme në trajtimin e temave të caktuara, tema këto që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen politike të grave, gratë në tregun e punës, dhuna në familje etj. Nga përvoja e lëvizjeve feministe në vendet e tjera, gratë brenda lëvizjeve dështojnë të shohin specifikat dhe rëndësinë e çështjeve të “vogla” siç është planifikimi urban. Trajtimi i temës së planifikimit urban është çështje politike, ekonomike dhe sociale, dhe nuk mund të shihet si e ndarë, apo që i takon një grupi të caktuar.

Modelet nga vendet tjera

Suedia: është një shembull i mirë i demokracisë direkte, duke përcjell idenë e pjesëmarrjes së qytetareve në planifikimin e qyteti, duke i kushtuar rëndësi të veçantë pjesëmarrjes së grave. Bordi nacional për Banim, Ndërtim dhe Planifikim në Suedi, në vitin 2006 ka filluar me qasje të ndeshme gjinore për planifikim duke involvuar gratë dhe duke kërkuar nga gratë të marrin pjesë në planifikim. Ky bord planifikimin e sheh si forum për dialog. Në anën tjetër, lëvizja feministe në Suedi ka dështuar të përfshijë qasjen e njëjtë me gratë emigrante.¹⁷

Vjena, Austria: Artikulli “Si të dizajnojmë një qytet për gratë” sjell një shembull tjetër të mirë dhe interesant sa i përket planifikimit të qyteti nga perspektiva e grave. Ky artikull tregon se si në vitin 1999, zyrtarët e Vjenës, kanë pyetur banorët e qytetit se sa shpesh e përdorin transportin publik? Kishte një dallim shumë të madh mes burrave dhe grave në përgjigje. Doli se gratë përdorin shumë më shumë transportin publik, dhe atë disa herë në ditë, derisa burrat kryesisht veturat e tyre private. Në përshkrimin e këtij artikulli autorja tregon se si gratë nuk ndaleshin së përshkruari aktivitetet e tyre ditore: si p.sh dërgimi i fëmijëve në çerdhe, puna, pazarin ditor etj. Natyrisht, doli që gratë përdornin shumë më shumë trotualet dhe ecnin më shumë në këmbë se sa burrat. Kështu planifikuesit urban, filluan të mendojnë dhe të zhvillojnë plane të cilat do të iu shërbenin grave. Artikulli në fund thotë se Vjena është qyteti më i përshtatshëm për gratë.¹⁸ Natyrisht se edhe kjo qasje mund edhe të riprodhoj stereotipet gjinore, por të paktën e bënë më të lehtë jetën e grave që e frekuentojnë qytetin.

¹⁶ Në vitin 1982, feministja e njohur bell hooks, kërkon nga gratë e bardha të rishikojnë punën dhe teoritë e tyre të përgjithshme sa i përket grave, dhe të merren me kompleksitetin e identitetitve “racore”, sepse sipas hooks: “cdo grua” është një kategori e panevojshme e cila prodhohet nga gratë e bardha që flasin nga pozicioni i tyre i privilegjuar. Kjo kritikë fillon një diskutim të ri në lëvizjen feministe rreth asaj se a mund të flasin disa gra në emër të të gjitha grave, pa bërë dallimin në mes të klasës, racës, orientimit seksual etj.

¹⁷ Listerborn, Carina. 2008 “Who speaks, Who listens”, *GeoJournal, Springer Science*.

¹⁸ Foran, Clare. 2013. *How to Design a City for Women*. <http://www.theatlanticcities.com/commute/2013/09/how-design-city-women/6739/> (qasur më 16 shtator, 2013)

Situata Aktuale

Nga diskutimet në fokus grupe, brengat, kritika dhe shembujt që kanë dalë nga ky diskutim konfirmon edhe një herë që qytetet, apo në mënyrë më specifike qyteti i Prizrenit është i projektuar me vlera dhe praktika mashkullore. Një nga kritikantët të cilat gratë kanë pasur dhe shprehur është që transformimi i qytetit të Prizrenit vjen si rezultat i investimeve të cilat sektori i bizneseve të vogla dhe të mesme kanë bërë. Të gjitha këto natyrisht pa plan urbanistik dhe me uzurpim të hapësirës publike, në këtë rast mungesë të trotuareve.

Siç është përmendur edhe më lartë, pjesëmarrëse në fokus grupe kanë qenë zakonisht nënave të vetme dhe amviset, tek të cilat rrallë arrin edhe njoftimi për pjesëmarrje në debate të hapura nga Komuna.

Politikat për barazi gjinore dhe ato zhvillimore

Gjinia: Komuna e Prizrenit ka të aprovuar planin për barazi gjinore (2012 – 2014), dhe ky plan obligon Komunën që të ketë qasje afirmative në punësimin e grave, në ofrimin e mundësive për zhvillim të bizneseve si dhe përfshirjen e grave në planifikimin edhe zhvillimin e politikave të Komunës. Natyrisht, kjo shënon arritje në nivel të krijimit të strategjive për përfshirjen e grave në procese të rëndësishme në nivel lokal mirëpo, në praktikë gratë nuk janë pjesë e këtyre proceseve, siç nuk janë pjesë e planifikimit urban.

Planifikimi: Qyteti i Prizrenit ka Planin Zhvillimor që është aprovuar në shtator të vitit 2013.¹⁹ Pothuaj se në asnjë nga qytetet e Kosovës aplikohet metoda e konsultimit të qytetarëve për ndryshime në planet urbanistike, e aq më pak të bëhen analiza apo hulumtime rreth asaj se cilat janë ndryshimet e duhura. Është e nevojshme që qyteti të jetë në shërbim të atyre që jetojnë në të, dhe qyteti të jetë hapësirë ku qytetarët marrin pjesë në mënyrë aktive dhe e ndjejnë qytetin pjesë të jetës së përditshme.

Qasja ndaj qytetit

Analiza e publikuar në shtator 2013, tregon se bllokimi i trotuareve me makina, dhe mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit janë dy çështje me të cilat preokupohen gratë që kanë marrë pjesë në këtë hulumtim. Pjesa tjetër e çështjeve që janë ngritur: janë ndërtimet pa leje, mungesa e hapësirave të gjelbëruara, problemet për qarkullimin e qytetarëve me nevoja të veçanta, mungesa e çerdheve për fëmijë dhe ujësjellësi.

Nga 249 të intervistuar për këtë analizë vetëm 1/3 e grave kanë raportuar se kanë informatë nëse qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin.²⁰ Të njëjtën kanë konfirmuar edhe gratë pjesëmarrëse në fokus grupe të cilat kanë deklaruar se informacioni për dëgjimet publike nuk arrijnë tek ato, sepse Komuna kryesisht përdorë afishe të cilat vendosen afër ndërtesës së Komunës, dhe radion apo edhe televizionin.

Në anën tjetër, nga debati me gratë dhe zyrtarin e Departamentit për Planifikim Urban (DUPH) në Komunën e Prizrenit, del se buxheti i Komunës së Prizrenit ka diku 80% projekte për investime kapitale dhe vetëm 20% shkon për shërbime ndaj qytetarit. Sipas zyrtarit të Komunës, DUPH pranon diku rreth 1500 kërkesa gjatë vitit për leje ndërtimore, renovime, dhe projekte të ndryshme të trashëgimisë kulturore.

¹⁹ 2013. EC Ma Ndryshe. Raport nga Debati, "Gratë dhe Planifikimi Urban", Prizren

²⁰ 2013. EC Ma Ndryshe. Analize e Shkurtë, "Planifikimi Urban për Qytetarët", Prizren

Të Gjeturat

Të gjeturat nga diskutimet në fokus grupe, debate dhe anketa prezantohen në vijim të raportit, në bazë të asaj se sa gratë janë të preokupuara me çështje të caktuara. Për të vendosur radhitjen e çështjeve (në fillim ato më shqetësuese për gratë) është përdorur metoda e kodimit. Në pesë fokus grupe të zhvilluara çështje të caktuara janë përsëritur dhe kjo tregon që ato çështje janë të rëndësishme për gratë. Prandaj Komuna duhet të ketë parasysh këto çështje në mënyrë që të adresoj shqetësimet e grave.

Degradimi i qytetit

Degradimi i qytetit mund të mos jetë çështja dominante për të gjitha pjesëmarrëset në fokus grupe, mirëpo mund të shihet si ombrellë e të gjitha problemeve në vijim. Me ndërtimet e larta, është shkatërruar edhe struktura urbane e qytetit të vjetër të Prizrenit, dhe ka humbur ndjesia që gratë kanë pasur për qytetin, si dhe relacioni i tyre me qytetin nuk ekziston si më parë. Një pjesëmarrëse thotë që "harmonia e shtëpive të vjetra qytetare është zëvendësuar më ndërtime që kanë ngufatur pamëshirshëm hapësirën publike të qytetit duke i privuar qytetarët nga shijimi i hapësirës së dedikuar për ta."²¹ Këto ndërtime të larta dhe pa plan urbanistik prekin të gjitha çështjet në vijim: sigurinë, mungesën e hapësirës publike, mungesën e privatësisë së grave në hapësirën private, etj. Prandaj është e rëndësishme të vendoset si temë kyçe e të gjitha diskutimeve sepse degradimi i qytetit është në një mënyrë shkaktar kryesor për çështjet e ngritura në vijim.

Siguria

Të gjitha fokus grupet kanë nxjerr çështjen e sigurisë në hapësirë publike përmes problemeve të caktuara të cilat janë përmendur.

Ndriçimi: Gratë mendojnë se siguria e grave në hapësirën publike, është skajshmërisht e neglizhuar duke filluar në mungesën e ndriçimit publik nëpër rrugët e qytetit. Janë përmendur raste të plaçkitjeve dhe sulmeve, prandaj gratë detyrohen të marrin rrugën tjera, të cilat mund të jenë më të gjata, për të arritur në destinacionin e caktuar. Komuna duhet në mënyrë urgjente të filloj ndriçimin e rrugëve dhe rrugicave të qytetit në mënyrë që banorët të ndihen të sigurt në qytetin e tyre.

Mbeturinat: Si pjesë e sigurisë është përmendur edhe çështja e mbeturinave, të cilat ndikojnë në kontaminim të ajrit, në përhapjen e vireve dhe baktereve të ndryshme, e të gjitha këto ndikojnë në shëndetin e qytetarëve. Një shembull që është marr nga një pjesëmarrëse është rruga për në Kala të qytetit, rrugë kjo që frekuentohet më së shumti gjatë motit të mirë. Lidhur me këtë, janë përmendur edhe mungesa e kontejnerëve për mbledhjen e mbeturinave. Në mungesë të kësaj vegje, është vështirë edhe të mirëmbahet pastërtia e qytetit.

Shtyllat elektrike: Një brengë tjetër sa i përket sigurisë ka të bëjë me shtyllat elektrike të cilat janë të mbi ngarkuara dhe çka është edhe më e rrezikshme, janë shtylla të pjerrëta të cilat mund të rrëzohen dhe të rrezikojnë jetën e qytetarëve. Janë treguar disa raste me shembuj specifik dhe rrugë specifike siç janë: Rruga "Tahir Meha" nr.30, Zona Europa, rrugës për në Kala, si dhe një shtyllë që ishte rrëzuar kohë më parë në Rrugën "Bajram Curri".

Shkallët emergjente: Ndërtimet e reja në qytetin e Prizrenit nuk janë duke respektuar rregullat për shkallët emergjente. Mungesa e shkallëve emergjente si në ndërtime të vjetra po ashtu edhe në ato të reja, është çështje që duhet të adresohet nga Komuna, dhe departamenti i DUPH.

²¹ Pjesëmarrëse në Fokus Grup, 15 shkurt, 2013

Hapësira Publike kundrejt Hapësirës Private

Uzurpimi i hapësirës publike nga bizneset e vogla private është një çështje tjetër që preokupon gratë, të cilat kanë diskutuar për këto shembuj:

Parku i Qytetit (në pjesën e pasme të Stadiumit të Qytetit): Një biznes privat ka uzurpuar parkun duke ofruar lojëra me pagesë për fëmijë. Kjo praktikë është në kundërshtim me konceptin e “parkut të qytetit” dhe nuk mund shndërrosh hapësirën publike, e cila është në shërbim të gjithë qytetarëve në hapësirë private për përfitime personale. Parku i Qytetit nuk mund të shfrytëzohet nga të gjithë fëmijët, për shkak të kushteve të rënda financiare të shumë familjeve në Prizren, sidomos nënave të vetme.

Trotuaret për këmbësor: Pjesëmarrëset kanë shpreh shqetësimin e tyre se shumica e trotuareve për këmbësor janë uzurpuar dhe shndërruar në zona parkingu. Me këtë pengohet qarkullimi i lirshëm i njerëzve, krijohen mundësi për aksidente trafiku si dhe krijojnë pasiguri për këmbësoret. Në të njëjtën temë është përmendur edhe vendosja e tavolinave dhe karrigeve nga lokalet gjatë stinës së verës, kryesisht në Shatërvan.²²

Hapësira dhe Personat me Nevoja të veçanta

Është shkelje ligjore kur ndërtimet nuk parashohin vendkalime për personat me nevoja të veçanta. Kjo praktikë është shumë prezente në Prizren, dhe një nga çështjet e ngritura nga gratë në FG. Ka mungesë të dukshme të pjerrinave, të cilat do të duhej të ishin në secilin ndërtim, rrugë kalim, institucion etj. Prandaj Komuna e Prizrenit duhet të filloj menjëherë të rishikoj të gjitha kërkesat për ndërtime, dhe të ndërmarr masa në vendosjen e pjerrinave në vendet ku kërkohet.

Transporti Urban

Transporti urban në qytetin e Prizrenit sipas pjesëmarrëseve është po thuaj se jo funksional. Linjat ekzistuese nuk janë të rregulluara si duhet, pasi që ato i anashkalojnë shumë lagje dhe nuk ofrojnë qasje të lehtë për qytetarët. Gratë kanë theksuar se do të ndihmonte shumë nëse do të hynin në funksion një numër më i madh i linjave të autobusëve duke iu ndihmuar të punësuarave të shfrytëzojnë transportin i cili është më i lirë dhe më i sigurt.

Fëmijët

Hapësira për lojëra: Natyrisht që nënat kanë vëmendje të veçantë për fëmijët e tyre, për mënyrën se si rriten dhe hapësirën që i rrethon ata. Është pajtim i përgjithshëm nga gratë se në lagjet e qytetit mungojnë hapësirat adekuate për lojë për fëmijët, ndërsa edhe ato hapësira ekzistuese janë shumë afër rrugëve motorike dhe fëmijët rrezikohen seriozisht nga automjetet.

Mungesa e hapësirës në shkolla fillore: Është diskutuar rreth asaj se si disa shkolla fillore të qytetit punojnë me tri ndërrime, dhe ndërrimi i fundit është ai i natë. Sipas pjesëmarrësve kjo paraqet shqetësim tek prindërit me që fëmijët kthehen në shtëpi nëpër rrugë pa ndriçim dhe mungesë të trotuareve për këmbësor.

²² Në diskutimin me gratë dhe zyrtarin e Komunës, është thënë se DUPH nuk ka fuqinë e largimit të karrigeve dhe tavolinave nga rruga dhe se në atë se këto tavolinat e karriget ndikojnë në rritjen e fitimit për bizneset dhe krijohet hapësirë për më shumë vizitorëve.

Uji i Pijshëm

Ka indikacione që furnizimi me ujë në Komunën e Prizrenit bëhet në mënyrë të pabarabartë mes zonës urbane dhe asaj rurale. Ka reduktime drastike të ujit të pijshëm. Gratë kanë treguar që në shumë raste kanë bërë presion tek organet kompetente mirëpo ky problem mbetet ende në listën e problemeve të pazgjidhura.

Diskutime tjera

Privatësia: Privatësia e grave nëpër shtëpitë (banesat) dhe dhomat e tyre cenohet nga afërsia e ndërtesave kolektive dhe mundësia që fqinjët të kenë qasje vizuale edhe në hapësirat intime të dhomave.

Punësimi: Gratë janë tejet të diskriminuara në çështjen e punësimit, sidomos në sektorin privat. Sipas pjesëmarrësve, edhe pse gratë i plotësojnë kushtet formale të konkursit (edukimi, profesionalizmi, etj.), ato shpesh eliminohen për shkak të kriterëve joformale të moshës, dukjes së jashtme, statusit martesor, shtatzënisë, etj.

Pushimi i lehonisë: Siç duket pushimi i lehonisë po shkakton probleme tek gratë të cilat janë të punësuar apo kërkojnë punësim në sektorin privat. Sipas grave, bizneset private orientohen më tepër nga gratë e reja dhe të pamartuara gjatë përzgjedhjes së punëtorëve. Kjo çështje duhet të adresohet në nivel lokal dhe qendror.

Liritë fetare: Është cekur që diskriminimi në punësim dhe shkollim i grave të mbuluara si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat është i dukshëm. Janë raportuar edhe raste të detyrimit për të hequr mbulesën, si kushtëzim për të ruajtur vendin e punës thonë disa nga pjesëmarrjes në fokus grupe. Me që çështja e shamisë tani më diskutohet në nivel të drejtës së grave për të vendos për vete, kjo e drejtë është e pamohueshme, dhe gratë që nuk kanë të drejtë të zgjedhin nëse duan të mbajnë shaminë, duhet të klasifikohen si raste që janë diskriminuar.

Rekomandimet

Rekomandimet e paraqitura me poshtë janë kombinim i rekomandimeve nga fokus grupet dhe rekomandime nga autorja e raportit.

- Komuna në bashkëpunim me organizatat të cilat janë të përfshira në këtë studim, të realizojn një studim i cili do të krijonte një hartë për vendet të cilat janë problematike sa i përket sigurisë, e cila për qëllim do të kishte, ndriçimin, pastrimin dhe lirim e hapsirës publike nga uzurpimet,
- Rregulloret e punës si dhe udhëzimet administrative të Komunës, duhet të jenë të orientuara kah e drejta e qytetarit të informohet dhe të marr pjesë dhe influencoj vendimet për planifikim të qytetit, dhe në mënyrë të veçante të krijoj hapësirë dhe mundësi që gratë të marrin pjesë në mënyrë aktive në këtë proces,
- Zbatimi dhe implementimi i plotë i rregulloreve në fuqi,
- Komuna duhet të pranoj rolin e vecantë të gruas në proceset që kanë të bëjnë me planifikimin urban. Të bëjë pjesë atë duke adresuar të gjitha kërkesat që ndërliken me qytetin,

- Gratë duhet të insistojnë në ushtrimin e të drejtës elementare për të qenë pjesë e vendimeve të Komunës, kur ka të bëjë me qytetin dhe hapësirën ku ajo jeton,
- Transporti publik të reformohet dhe gratë të kenë qasje më të lehtë në transport publik,
- Të krijohen mekanizma për implementim të rregullores për përfshirejn e grave në procese vendim-marrëse,

VI. Personat me nevoja të veçanta dhe planifikimi urban në Prizren

Qasja publike

Shkruar nga, Rozafa Basha

Përmbledhje ekzekutive

Qyteti mund të kontribuojë në krijimin e një shoqërie më të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe kohezive nëse vendet që i banojmë, infrastruktura që përdorim, lagjet tona dhe vendtakimet do të ishin të projektuara për të qenë të qasshme dhe gjithëpërfshirëse.²³ Edhe pse e organizuar në organizata të cilat mbrojnë interesat e grupeve të ndryshme të këtij komuniteti, personat me nevoja të veçanta në Kosovë vazhdojnë të përballen me barriera të shumta në shoqërinë kosovare.

Janë të shumta problemet e qasjes së personave me nevoja të veçanta në qytet, dhe janë të mëdha barrierat me të cilat ata ndeshen përditë. Sot, asnjë mjedis urban në Kosovë, nuk ofron kushte elementare që ky komunitet të jetë pjesëmarrës dhe kontribues në shoqëri. Gjithëpërfshirja shoqërore paraqet një sfidë të veçantë në projektimin e mjedisit urban dhe ngre një numër problemesh që kanë të bëjnë me mobilitetin dhe pjesëmarrjen në jetën e përditshme. Qasja nënkupton mundësinë për të mbërritur nga shtëpia deri te një numër i destinimeve shoqërore, të edukimit, rekreimit dhe punës. Kjo po ashtu nënkupton edhe qasjen në sistemin këmbësorik dhe transportues.

Në udhëzuesin e arritjes së mundësive të barabarta për të gjithë dhe gjithëpërfshirja shoqërore për secilin person të shoqërisë në BE (2004), mes tjerash, insistohet në rritjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së njerëzve në shoqëri dhe obligohen institucionet e ndryshme të BE-së që për sigurimin e kësaj pjesëmarrje, të **largojnë pengesat (kufizimet) fizike që pamundësojnë pjesëmarrjen qytetare**, duke vendosur kështu respektin për dinjitetin, autonominë dhe pavarësinë²⁴.

Në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” u zhvilluan debate me fokus grupe të ndryshme, mes tjerash edhe me grupin me persona me nevoja të veçanta. Nga 5 debate me këtë fokus grup dolën një numër brengash dhe shqetësimesh, por edhe sugjerimesh nga pjesëtarët e këtij komuniteti, të cilat janë të përmbledhura në këtë raport.

Në Kosovë tashmë ekzistojnë ligje dhe udhëzues administrativ që ndalojnë diskriminimin në bazë të aftësisë së kufizuar në pjesëmarrje shoqërore, si dhe rregullojnë pjesëmarrjen aktive në edukim, aftësimin dhe punësimin e personave me nevoja të veçanta, por edhe parametrat teknikë që mundësojnë qasjen dhe lëvizjen e lirë të këtyre personave. Mirëpo, mungojnë mekanizmat e kontrollit të zbatimit të këtyre ligjeve në fazën e planifikimit si dhe mbikëqyrjes së cilësisë së realizimit teknik të këtyre parametrave teknikë.

²³ Commission for Architecture and the Built Environment, The principles of inclusive design, <http://www.designcouncil.org.uk/Documents/Documents/Publications/CABE/the-principles-of-inclusive-design.pdf> (qasur më 01.11.2013)

²⁴ Achievement of Equality of Opportunity & Social Inclusion for Every Person in the European Union (EU), Guideline Framework, <http://www.sustainable-design.ie/sustain/gfindex.htm> (qasur më 01.11.2013)

Së këndejmi, rekomandimet të përmbledhura në këtë raport, krahas sugjerimeve të tjera teknike, theksojnë nevojën urgjente të vendosjes së këtyre mekanizmave që do të siguronin zbatimin e këtyre parametrave teknikë në të gjitha fazat e realizimit të projekteve arkitektonike dhe urbane.

Hyrje

Qyteti mund të kontribuojë në krijimin e një shoqërie më të barabartë, gjithëpërfshirëse dhe kohezive nëse vendet që i banojmë, infrastruktura që përdorim, lagjet tona dhe vendtakimet do të ishin të projektuara për të qenë të qasshme dhe gjithëpërfshirëse.²⁵

Në frymën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe sipas kornizës udhëzuese të arritjes së mundësive të barabarta për të gjithë dhe gjithëpërfshirja shoqërore për secilin person të shoqërisë në BE (2004), konsultimi i drejtpërdrejtë dhe kuptimplotë me njerëzit, partneriteti me të gjitha sektorët e shoqërisë, konsensusi, transparenca, hapja institucionale, llogaridhënia politike, janë elementet qenësore të Mirëqenies për të gjithë. Në këtë udhëzues, mes tjerash, insistohet në rritjen dhe fuqizimin e pjesëmarrjes së njerëzve në shoqëri dhe obligohen institucionet e ndryshme të BE-së që për sigurimin e kësaj pjesëmarrje të **largojnë pengesat (kufizimet) fizike që pamundësojnë pjesëmarrjen qytetare**, duke vendosur kështu respektin për dinjitetin, autonominë dhe pavarësinë; të shqyrtojnë qasjen/hyrjen/ evakuimin dhe shëndetin/ sigurinë /çështjet e mirëqenies në dritën e mundësive të barabarta, të drejtën për pjesëmarrje dhe eliminimin e diskriminimit direkt dhe indirekt të bazuar në gjini, racë dhe origjinë etnike, fe dhe besim, paaftësi, moshë dhe orientim seksual.²⁶

Konceptet e qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes janë dy koncepte cilësore që shfrytëzohen shpesh në diskutet e fushës së planifikimit dhe zhvillimit. Programi i UN Habitatit e përkufizon qytetin gjithëpërfshirës si qytet që promovon zhvillimin me drejtësi. (UN Habitat 2011)

Parë nga këndvështrimi i qasjes fizike, bazuar në parimet e dizajnit gjithëpërfshirës të përpiluara nga CABE në vitin 2006, mjediset dhe hapësirat gjithëpërfshirëse janë ato te të cilat dizajni fillestar dhe menaxhimi i tyre akomodojnë plotësisht nevojat e ndryshme dhe të ndryshueshme të njerëzve që i përdorin ato. (...) Mjediset gjithëpërfshirëse ofrojnë alternative që sigurojnë barazi dhe dinjitet për të gjithë. Për shumë njerëz, megjithatë, gjithëpërfshirja shkon përtej çështjeve normalisht të asocuara me qasjen; ato nënkuptojnë të kuptuarit e marrëdhënies së dizajnit dhe menaxhimit me masat e tjera të barazisë brenda shoqërisë. Ato përfshijnë, p.sh. mënyrën se si mjediset dhe hapësirat e rrisin mirëqenien fizike dhe mentale; reflektimin e diversitetit të shoqërisë moderne; mënyrën se si e inkurajojnë marrëdhëniet harmonike dhe të ndërsjella ndërmjet grupeve shoqërore: si dhe e sigurojnë alokimin dhe shfrytëzimin e drejtë të resurseve ekonomike.²⁷

Për Ali Madanipour-in, qyteti “ofrohet dhe menaxhohet nga autoritetet publike” dhe “shfrytëzohet dhe ndahet nga të gjithë anëtarët e bashkësisë”. Ai është “bota e përbashkët institucionale dhe materiale,

²⁵ Commission for Architecture and the Built Environment, The principles of inclusive design, <http://www.designcouncil.org.uk/Documents/Documents/Publications/CABE/the-principles-of-inclusive-design.pdf> (qasur më 01.11.2013)

²⁶ Achievement of Equality of Opportunity & Social Inclusion for Every Person in the European Union (EU), Guideline Framework, <http://www.sustainable-design.ie/sustain/gfindex.htm> (qasur më 01.11.2013)

²⁷ Commission for Architecture and the Built Environment, The principles of inclusive design, <http://www.designcouncil.org.uk/Documents/Documents/Publications/CABE/the-principles-of-inclusive-design.pdf> (qasur më 01.11.2013)

hapësirë e ndërmjetme që lehtëson bashkëpresencën dhe rregullon marrëdhëniet ndërpersonale”.²⁸ Për t'u arritur e gjithë kjo, është qenësore që nevojat dhe aspiratat e gjithë anëtarëve të bashkësisë, të merren parasysh qysh në zanafillë, në procesin e planifikimit, projektimit, implementimit dhe në fazat e shfrytëzimit dhe të jenë të vendosura në qendër të secilit proces të dizajnit dhe vendimmarrjes²⁹.

Situata aktuale

Edhe pse e organizuar në organizata të cilat mbrojnë interesat e grupeve të ndryshme të këtij komuniteti, personat me nevoja të veçanta në Kosovë vazhdojnë të përballen me barriera të shumta në shoqërinë kosovare. Në shtetet e zhvilluara deri në vitet e '70 të shekullit të kaluar, aftësia e kufizuar është parë sipas modelit mjekësor dhe problemi perceptohej si problem i individit, i cili ka një kufizim aftësie, më pas këto shoqëri e përqaftuan modelin e jetës së pavarur, ku shihej shoqëria që ka barriera dhe pamundësi që t'i kënaqë nevojat e veçanta për këta individë. Fatkeqësisht në Kosovë, vazhdon të mbretëroje një qëndrim kulturor, që aftësia e kufizuar është një gjendje mjekësore dhe që personat e prekur nga to nuk kanë asnjë mundësi të zhvillojnë jetë të pavarur. Në bazë të këtyre qëndrimeve kulturore, familjet priren që personat me nevoja të veçanta t'i lënë larg edukimit dhe pjesëmarrjes aktive në shoqëri, sidomos ato të gjinisë femërore.

Me gjasë, të prirë nga një qëndrim i tillë, edhe pse me legjislacion i cili i parashtron qartë parametrat teknikë dhe obligimet ligjore, institucionet nuk inkurajojnë pjesëmarrje të qytetarëve me nevoja të veçanta në edukim, ofrohen pak mundësi punësimi, etj. Jo të rralla janë rastet ku drejtorët e shkollave, më parë se të sigurojnë fonde për të realizuar rampa dhe të sigurojnë tualete për persona me nevoja të veçanta, i largojnë nga shkollat fëmijët me nevoja të veçanta. Kjo bie ndesh me alinenë 2.1. të nenit 40 (Parimi i arsimit gjithëpërfshirës) të ligjit Nr. 04/L-032 për arsim parauniversitar e cila thotë se: *institucionet arsimore dhe aftësuese duhet të akomodojnë të gjithë fëmijët, pa dallim të kushteve të tyre fizike, intelektuale, sociale, gjuhësore apo të tjera dhe duhet të promovojë integrimin dhe kontaktin mes fëmijëve.*

Në Kosovë jo rrallë familjet që kanë pjesëtarë persona me nevoja të veçanta janë edhe në situatë të rëndë ekonomike. Institucionet shtetërore dhe kompanitë publike dhe private nuk ofrojnë mundësi të barabarta të punësimit për persona me nevoja të veçanta, edhe pse sipas alinesë 2 të nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-019 (Punësimi në tregun e hapur të punës) *çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me nevoja të veçanta në çdo pesëdhjetë (50) punëtorë edhe çdo lloj diskriminimi në bazë të aftësisë së kufizuar (...) në të gjitha situatat ndalohet sipas alinesë 3 të nenit 5 të Ligjit Nr. 03/L-019. Të gjitha janë këto barriera kulturore të cilat s'po mënjanohehen dhe u vihen ndesh ligjeve në fuqi.*

Por edhe aty ku ekziston vullneti i familjes, i individit por edhe i institucioneve/ kompanive për punësim dhe përfshirje në arsim të personave me nevoja të veçanta konform ligjeve në fuqi, janë barrierat fizike që pamundësojnë një lëvizje dhe jetë të pavarur dhe e pamundësojnë pjesëmarrjen e këtyre qytetarëve në shoqëri, ashtu siç garantohet nga një nga parimet udhëzuese të Konventës së KB-së për personat me

²⁸ Madanipour, Ali, (2003) *Public and Private Spaces of the City*, Routledge (version Kindle)

²⁹ Commission for Architecture and the Built Environment, The principles of inclusive design, <http://www.designcouncil.org.uk/Documents/Documents/Publications/CABE/the-principles-of-inclusive-design.pdf> (qasur më 01.11.2013)

nevoja të veçanta “respekt i qenësishëm për dinjitetin, autonominë individuale, lirinë për të bërë zgjedhje vetanake, si dhe për pavarësinë e personave”.³⁰

Gjithëpërfshirja shoqërore paraqet një sfidë të veçantë në projektimin e mjedisit urban dhe ngre një numër problemesh që kanë të bëjnë me mobilitetin dhe pjesëmarrjen në jetën e përditshme. Qasja nënkupton mundësinë për të mbërritur nga shtëpia deri te një numër i destinimeve shoqërore, edukimit, rekreimit dhe punës. Kjo nënkupton po ashtu edhe qasjen në sistemin këmbësorik dhe transportues. Në Konventën e KB-së për të drejtat e personave me nevoja të veçanta, thuhet se *secili njeri me nevoja të veçanta ka të drejtë të jetojë tërësisht i pavarur dhe të marrë pjesë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore, prandaj (...) duhet të merren masa të duhura për të siguruar që personat me nevoja të veçanta të kenë qasje në mjediset fizike, transport, teknologji informative dhe komunikuese dhe në shërbimet tjera publike*.³¹ Së këndejmi, në vendet e zhvilluara, tashmë është bërë një zhvillim në teknologjitë ndihmuese, dhe përmirësim të dizajnit e produkteve për përdorim individual apo në shtëpi; zgjidhja e problemit të qasjes është realizuar me largimin e barrierave fizike për qasjen me karroca, vendosjen e platformave të ulura të stacioneve të autobusëve, autobusë më dysheme të ulët, ulje të buzë trotuareve, si dhe janë bërë intervenime në faktorët e tjerë mjedisor, sikurse ndriçimi, informatat audio-vizuale si dhe informatat orientuese.

Vendbanimet e Kosovës janë përplot barriera fizike, të cilat pamundësojnë lëvizjen e lirë të personave me nevoja të veçanta. Në vitin 2007 është miratuar Udhëzimi administrativ nr. 33/ 2007, për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me nevoja të veçanta, me të cilin rregullohen të gjitha aspektet teknike që sigurojnë një jetë dhe lëvizje të pavarur të personave me nevoja të veçanta në qytete. Parametrat teknikë në këtë udhëzim përcaktojnë përmasat dhe rregullimin funksional të banesave, hyrjeve, shkallëve të brendshme, objektet administrative, kulturore dhe sportive, si dhe parametrat e pjerrtësisë së rampave, sipërfaqeve, rrugëve, kalimi të semaforët, etj. Me këtë udhëzim administrativ rregullohet edhe përmbajtja e dokumentacionit teknik të të gjitha projekteve arkitektonike, inxhinierike, elektrike, si parakusht për marrjen e lejes së ndërtimit nga drejtoritë komunale të urbanizmit etj.

Udhëzimi vazhdon të mbetet në letër dhe komunat nuk i ndjekin procedurat e zbatimit të këtyre kërkesave teknike në projektet arkitektonike dhe urbanistike. Andaj, personat me nevoja të veçanta përballen me barrierat në qasje në objekte dhe në rrugë. Edhe ato pak tentime për të lehtësuar qasje, bëhen shkel e shko, pa respektuar rregullat e udhëzimit të sipërpërmendur. Në qytete mund të shohim intervenime gjysmake që na shfaqen me rampa me pjerrtësi jashtë standardeve; mungesë të platformave taktore dhe shenjzime me ngjyra kontrastuese në dysheme/sipërfaqe të rrugës për persona me aftësi të kufizuara pamore. Mungojnë WC publike për persona me nevoja të veçanta, ose edhe ato të cilat janë projektuar si të tilla, janë të pamobiluara me mobiliarin e nevojshëm dhe shndërrohen në depo. Inspektoratet komunale nuk mbikëqyrin zbatimin e udhëzimit administrative për WC për persona me nevoja të veçanta në objekte shërbyese, e as për rampat qasëse, etj. Transporti publik është i papërshtatshëm dhe në asnjë nga qytetet e Kosovës nuk ekzistojnë autobusët apo kombibusët me dysheme të ulët apo me platforma hidraulike, që me ulje mundësojnë qasjen e personave me nevoja të veçanta.

³⁰ UN, Convention on the Rights of Persons with Disabilities, <http://www.un.org/disabilities/default.asp?id=263> (qasur më 01.11.2013)

³¹ UN, Convention on the Rights of Persons with Disabilities, <http://www.un.org/disabilities/default.asp?id=269> (qasur më 01.11.2013)

Të gjeturat

Në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” u zhvilluan debate me fokus grupe të ndryshme, mes tjerash edhe me grupin me persona me nevoja të veçanta. Gjithsej u organizuan 5 debate me këtë fokus grup dhe mëposhtë do të shënohen sfidat dhe brengat e shpalosura gjatë këtyre takimeve:

Fokus grupet u mbajtën më 7 mars, 18 prill, 17 maj, 3 korrik dhe 2 tetor 2013, dhe gjatë diskutimeve u ngritën çështjet si në vijim:

- Adresimi i të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me qasjen e personave me nevoja të veçanta duhet të bëhet në nivelin qendror dhe nivelin lokal të qeverisjes.
- Transporti urban dhe ai ndërrurban nuk posedon mjete të përshtatshme për përdoruesit e karrocave, por edhe për persona të grupeve të tjera të aftësisë së kufizuar.
- Sipërfaqet e trotuareve dhe rrugëve nuk janë të përshtatura për shfrytëzim për persona që shfrytëzojnë karrocën, për persona të verbër dhe me aftësi të kufizuar pamore: të vendkalimet e rrugëve, trotualet nuk kanë rampë dhe nëse diku gjendet rampa, ajo nuk e ka të përshtatshme pjerrtësinë; përgjatë gjithë sipërfaqeve të trotuareve, rrugëve dhe hapësirave publike, mungojnë shenjzimet orientuese – sipërfaqet taktore për të mundësuar lëvizjen e të verbërve; mungon shenjzimi me ngjyra me kontraste të forta në dysheme/trotuare dhe shtyllëza për persona me aftësi të kufizuara pamore.
- Pengesat në shfrytëzimin e trotuareve dhe shtigjeve nga persona me nevoja të veçanta paraqesin edhe uzurpimi i tyre prej automjeteve, mallrat e vendosura përpara shitoreve, etj
- Ndërtimet e reja, qoftë private a publike, nuk i përmbahen kërkesave teknike të parashtruara me udhëzimin administrativ nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me nevoja të veçanta.
- Gjerësitë e shkallëve nuk janë të përshtatshme për përdorues të shkopit, patericave dhe shëtitoreve, por edhe për persona të verbër që lëvizin me ndihmën e shkopit të bardhë.
- Mungojnë WC – të publike të projektuara me parametrat teknik të përshtatshëm për shfrytëzim nga përdorues të karrocave, por edhe në lokalet shërbyese dhe ndërtesat publike.
- Personat me nevoja të veçanta nuk kanë mundësi të shfrytëzimit të hapësirave publike.
- Personat me nevoja të veçanta nuk kanë mundësi të qasjes në objektet sportive dhe kulturore.
- Çështje që lidhet me mirëqenien sociale është edhe strehimi i këtyre familjeve. Janë të shumta familjet me një apo dy pjesëtarë me nevoja të veçanta të cilët kanë parashtruar kërkesa për strehim në objekte shumëbanesore kolektive, etj.
- Qasja në objekte shëndetësore është mjaft e vështirësuar, meqë ka barriera fizike për përdorues karrocash. Mungojnë interpretë të gjuhës së shenjave për persona të shurdhër në klinika, etj.
- Profesionistët të cilët merren me planifikim dhe projektim nuk kanë njohuri për detajet specifike, nuk i njohin edhe udhëzimet administrative që përcaktojnë parametrat për sigurimin e një mjedisi pa pengesa.
- OJQ-të dhe agjencitë tjera nuk kanë politika të qarta për mjedisin pa barriera për lëvizjen e njerëzve.

Nga këto takime dolën rekomandimet e mëposhtme:

- Të ngrihet vetëdija e personave me nevoja të veçanta mbi potencialet dhe mundësitë e pjesëmarrjes së tyre në shoqëri.
- T’iu mundësohet personave me nevoja të veçanta qasja në kurse trajnimi dhe riaftësimi profesional.

- Të zbatohet ligji nr. 03/2010, për aftësimin, riaftësimin dhe punësimin e personave me nevoja të veçanta, sipas të cilit, në të dy sektorët, çdo i 50 punëtor duhet të jetë pjesëtar nga grupi i personave me nevoja të veçanta.
- Të sigurohet mjedisi i përshtatshëm i punës për persona me nevoja të veçanta (përshtatshmëria e vendit të punës, sigurimi i mjeteve teknologjike asistuese, infrastruktura përcjellëse e përshtatshme: WC-të, ashensori, rampat, transporti, mjetet komunikuese, etj).
- Të krijohet një bazë të dhënash për statusin e punës dhe atë të aftësive profesionale të personave me nevoja të veçanta
- Të ofrohet një spektër më i gjerë i përzgjedhjes për aftësim profesional dhe punësim për persona me nevoja të veçanta, etj.
- Të gjenden mekanizma për të zbatuar ligjet dhe udhëzimet administrative në lidhje me qasjen e personave me nevoja të veçanta në objekte.
- Të gjenden mekanizma që komunat të përfshijnë persona me nevoja të veçanta në komisionet e vlerësimeve të tenderëve për objekte publike apo intervenime të tjera infrastrukturore në qytet.

Nga anketimi i qytetarëve të Prizrenit, i publikuar në analizën e shkurtër “Planifikimi urban dhe qytetarët” të botuar në shtator 2013 nga EC Ma Ndryshe, nga grupi i interesit i personave me nevoja të veçanta u ngritën këto çështje si brenga të këtij komuniteti:

- Mungesa e qasjes së personave me aftësi të kufizuar në transport urban,
- Mungesa e rampave për qasje në institucione publike,
- Mungesa e shenjzimeve – sipërfaqeve taktore në trotuare, për persona të verbër,
- Uzurpimi i trotuareve nga shitësit dhe makinat e parkuara.
- Mungesa e vendeve të rezervuara për persona me nevoja të veçanta.

Rekomandimet

Qyteti gjithëpërfshirës promovon zhvillimin përmes pjesëmarrjes së barabartë, ku të gjithë pavarësisht racës, etnisë, fesë, gjinisë, aftësive fizike fuqizohen dhe iu mundësohet pjesëmarrja e plotë në planifikimin dhe vendimmarrjen në lidhje me çështjet e qytetit.³²

Janë të shumta problemet e qasjes së personave me nevoja të veçanta në qytet dhe janë të mëdha barrierat me të cilat ata ndeshen përditë. Sot, asnjë vendbanim në Kosovë, nuk ofron kushte elementare që ky komunitet të jetë pjesëmarrës dhe kontribuues në shoqëri. Si pasojë e qëndrimit kulturor në familje dhe rreth dhe neglizhencës institucionale në zbatimin e ligjeve në fuqi, personat me nevoja të veçanta mbesin larg arsimit, aftësimin profesional dhe punësimin dhe krijimit të një ekonomie vetanake, me çka do t’iu mundësohej jetë plotësisht e pavarur.

Sipas Goltsman dhe Iacofano, qytetet kanë nevojë për planifikim që e njih të drejtën e përfshirjes të secilit njeri në proceset zhvillimore: “përmes pjesëmarrjes, njerëzit mund t’i japin formë mjedisit të tyre për t’i përmbushur nevojat e tyre”. Këta autorë theksojnë se personat me nevoja të veçanta, janë prej personave që janë më të prekur nga proceset e planifikimit të mjedisit dhe mospërfshirja e tyre shpeshherë rezultojnë prej mungesës së shkathtësive, dijeve dhe informatave. Nga ajo që u tha më lartë del se duhet të insistohet në arsimimin, aftësimin dhe riaftësimin profesional të këtij komuniteti. Ligjet e arsimit në Kosovë obligojnë përfshirjen e këtij komuniteti në arsim dhe do të duhej të krijoheshin

³² EC Ma Ndryshe, Planifikimi urban për qytetarët, fq. 14, 2013, në http://ecmandryshe.org/repository/docs/ANALIZA_Planifikim_urban_per_qytetaret.pdf

mekanizma të kontrollit të zbatimit të këtij ligji, por edhe të cilësisë së mësimdhënies për këtë komunitet nga drejtoritë komunale të arsimit.

Mospërfshirja e nevojave të personave me nevoja të veçanta në procesin e planifikimit dhe projektimit të qytetit rezulton në përkeqësimin e mjedisit të tyre jetësor. Prandaj, autorët Goltsman dhe Iacofano sugjerojnë që projektimi gjithëpërfshirës duhet të bazohet në tri kategori: funksionaliteti (projektim që ngërthen të gjitha tipat e individëve), ndjeshmëria kontekstuale (harmonia me mjedisin rrethues) dhe impakti i drejtësisë për të “zvogëluar impaktin shoqëror dhe njerëzor tek anëtarët më të prekur të shoqërisë”.³³ Për të realizuar një planifikim dhe projektim të këtillë gjithëpërfshirës, komuna duhet të ndërtojë një platformë të informimit dhe vetëdijesimit të popullsisë mbi planet strategjike dhe zhvillimore përmes materialit të shtypur, mediave, por edhe përmes organizimit të takimeve të rregullta me këshillat e lagjeve, banesave, etj. Krahas platformës informuese, në ekipet e punës për planifikim dhe zhvillim të këtyre strategjive për qytetin, por edhe në diskutimin e fazave të projektimit të hollësishëm të zonave, shesheve, rrugëve, objekteve publike, etj. duhet të përfshihen të gjitha grupet të cilat preken drejtpërdrejt nga ai planifikim.

Sa i përket parametrave teknikë që ndërlidhen me largimin e barrierave arkitektonike dhe barrierave të tjera fizike që e pengojnë lëvizjen e lirë të personave me nevoja të veçanta dhe duke qenë se të gjitha këto rregullohen me udhëzuesin administrativ nr. 33/2007, mjafton të insistohet në krijimin e mekanizmave kontrollues në fazën e projektimit (drejtoritë komunale do të duhej të kushtëzonin zbatimin e këtyre parametrave teknik gjatë fazës së aplikimit për dhënien e lejes për ndërtim) dhe mekanizmave inspektues të zbatimit të neneve të këtij udhëzuesi gjatë fazës së ndërtimit, por edhe në fazën e pranimit teknik dhe dhënies së lejes së shfrytëzimit pas përfundimit të ndërtimit.

Siç u theksua më lart, pengesa kryesore për një jetë të pavarur të personave me nevoja të veçanta janë barrierat kulturore dhe ato fizike. Barrierat kulturore mënjanohen me më shumë vështirësi se sa barrierat fizike. Për krijimin e një mjedisi shoqëror që pranon tjetrin pavarësisht dallimeve fizike, kulturore, gjinore, etj., duhet ndërtuar një platformë vetëdijesimi që do të ishte pjesë e kurrikulave arsimore prej cikleve të ulëta të shkollimit. Klasat e mësimi gjithëpërfshirës janë tashmë pjesë e legjisllacionit për arsim, por edhe të shkollave fillore gjithandej Kosovës. Por jo gjithkund funksionojnë si të tilla. Janë të shumta rastet kur ato klasë janë vetëm pro forma, dhe fëmijët me nevoja të veçanta largohen nga drejtorët e shkollave nga procesi mësimor. Për t’i evituar këto situata, drejtoritë komunale duhet t’i shpeshtojnë vizitat e inspektorëve të arsimit në shkolla dhe pjesëtarët e komunitetit të personave me nevoja të veçanta duhet të raportojnë menjëherë rastet e tilla në këto drejtori, por edhe në nivele të tjera qeverisëse, po qe se drejtoritë nuk veprojnë pas raportimit.

Jo të gjitha shkollat kanë mundësi qasjeje për persona me nevoja të veçanta, por edhe WC-të dhe parametrat e tjerë teknikë për shfrytëzimin e këtyre objekteve nuk janë konform standardeve për shfrytëzim nga ky grup. Drejtoritë komunale të urbanizmit në bashkëpunim me drejtoritë e arsimit duhet t’i vënë në krye të agjendës përmirësimet e këtyre kërkesave konform standardeve, që të sigurojnë pjesëmarrjen sa më të madhe të fëmijëve në arsim dhe me këtë për të krijuar klimën e tolerancës dhe pranimit të gjithë individëve pavarësisht dallimeve. Duhet të gjendet mënyra që barrierat fizike që tashmë i kemi të trashëguara nga planifikimi dhe projektimi i përpamë të evidentohen dhe të mënjanohen përmes intervenimeve përmirësuese. Për të evidentuar gjendjen

³³ Goltsman, S, Iacofano, D, (2007), *The Inclusive City: Innovative Solutions for Buildings, Neighborhoods, and Urban Spaces*, MIG Communications).

reale në terren, komuna do të duhet të bënte një hartëzim të këtyre barrierave fizike në gjithë shtrirjen e qytetit dhe pastaj të ndërtonte një plan strategjik për eliminimin e tyre.

Krahas qasjes në objekte, barrierat fizike më kritike janë ato te trotuaret, të cilat janë komponentë kritike të hapësirës publike, meqë ato janë hapësirë e përbashkët ku njerëzit interaktojnë mes veti. Shumë prej trotuareve janë në gjendje të keqe. Ky shkatërrim i tyre vështirëson në masë të madhe shfrytëzimin e tyre nga këmbësorët pa probleme fizike dhe pamundëson shfrytëzimin nga personat me nevoja të veçanta. Nëse sipërfaqja e rrugëve nuk është e dëmtuar, atëherë është e uzurpuar nga shitësit dhe nga shtyllëzat, makinat e parkuara, etj. Komuna është ajo që ka përgjegjësi të plotë të kontrollit mbi këto elemente të infrastrukturës, ata i dizajnojnë, por edhe i mirëmbajnë dhe i menaxhojnë. Akomodimi i personave me nevoja të veçanta në trotuare duhet të jetë në krye të agjendës të planifikimit, menaxhimit dhe mirëmbajtjes të këtyre sipërfaqeve nga ana e komunës.

Por nuk janë vetëm sipërfaqet e trotuarëve, por janë edhe WC-të për persona me nevoja të veçanta si WC publike por edhe ato në objekte shërbyese, rampat qasëse te vendkalimet këmbësorike, te objektet shërbyese, publike, sipërfaqet taktore për lëvizjen e të verbërve, ngjyrat kontrastuese për personat me shikim të dobësuar në sipërfaqet e rrugëve, shkallë publike, etj., mungesa ose mospërshtatja e të cilave pengon dhe pamundëson lëvizjen e lirë në qytet për pjesëtarë të këtyre grupeve.

Nga debatet e zhvilluara me fokus grupin e personave me nevoja të veçanta, është i theksuar shqetësimi në lidhje me transportin urban të papërshtatshëm. Transporti urban është një prej elementeve kyç të mobilitetit në qytet për të gjithë qytetarët dhe jo vetëm për personat me nevoja të veçanta. Sot në botë ekziston një përzgjedhje e madhe e llojeve të autobusëve të qasshëm që do të shërbenin për transport publik. Komuna duhet të përfshijë në planifikimin buxhetor edhe sigurimin e autobusëve të tillë dhe aktivizimin e tyre në linjat urbane brenda qytetit të Prizrenit.

Një problem tjetër i hasur është edhe mungesa e vendeve të rezervuara të parkimit të veturave që ngiten nga persona me nevoja të veçanta. Edhe ato të pakta që janë të evidentuara, janë kryesisht të zëna nga veturat tjera. Andaj, rekomandohet që komuna të përcaktojë më shumë vende të tilla në vendparkimet e qytetit të Prizrenit, si dhe në bashkëpunim me organet e rendit të kujdesen që ato që janë të mos zaptohen nga vetura të tjera.

Në përmbyllje, gjithnjë duke iu referuar autorëve, Goltsman dhe Iacofano, për t'i ndihmuar një komuniteti që të jenë pjesëmarrës aktivë në shoqëri, duhet që fillimisht të binden rreth rolit dhe kontributit të tyre në atë shoqëri dhe pastaj të inkurajohen që aktivisht të marrin pjesë në të gjitha fazat e përpilimit të strategjive dhe planifikimit të qytetit. Stimulimi i mendimit kritik rreth burimeve të vërteta të problemeve si dhe zgjidhjeve potenciale duhet të jetë proces participator, që përfshin të gjithë komunitetin.³⁴ Me participim të gjerë, komunitetit do t'i forcohet ndjenja e pronësisë dhe e përkatësisë ndaj një projekti të caktuar dhe ndaj qytetit të tyre në përgjithësi.³⁵

³⁴ The Inclusive City, Inclusive Design Criteria and Policies,

<http://www.inclusivecity.com/Content/10002/InclusiveCityDesignCriteriaandPolicies.html> (qasur më 01.11.2013)

³⁵ Po aty.

VII. Të rinjtë dhe planifikimi urban në Prizren

Nxënësit e shkollave të mesme dhe studentët

Shkruar nga, Kreshnik Basha

Përmbledhje ekzekutive

Përfshirje apo pjesëmarrje janë vetëm disa ndër shprehjet të cilat përshkruajnë angazhimin e të rinjve në proceset vendimmarrëse; dhe për vendet sikurse që është Kosova me një popullsi të re është shumë me rëndësi që ata mos të jenë dëshmitar pasiv në proceset e rëndësishme që ndodhin përreth por me kontributin e tyre të japin më të mirën për krijimin e mirëqenies së shoqërisë sonë. Sot nuk bëhet më fjalë se a duhet të kemi përfshirje të të rinjve por si ta bëjmë atë në mënyrë më të mirë. Planifikimi urban i bërë nga të rriturit jo çdoherë i përgjigjet kërkesave dhe nevojat rinisë. Në të shumtën e rasteve e kemi parë që në të kaluarën rinia ishte jashtë proceseve të planifikimeve në nivel lokal dhe si të tillë ata janë ndje të tjetërsuar; kjo është edhe arsyeja që nuk kishte shumë qasje aktive nga ane e tyre, pasi që të rinjtë nuk kishin përfitim nga ai proces.

Organizata EC Ma Ndryshe në bashkëpunim me Këshillin Lokal Rinor dhe me grupet rinore gjatë semestrit të parë të vitit 2013 ka organizuar një seri të takimeve me qëllim të mbledhjes së mendimeve dhe sugjerimeve të rinisë në lidhje me rolin e tyre në procesin e planifikimit urban në Komunën e Prizrenit. Qëllimi i këtyre takimeve ishte të artikulojë nevojat e grupeve rinore dhe t'i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Në fund synohet që të sigurohet përfshirja e kërkesave të rinisë në planifikimin urban të qytetit, nëpërmjet një procesi të avokimi dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

Gjatë kësaj kohe është theksuar se sa më i madh të jetë përfshirja e të rinjve, aq më i rëndësishëm është roli i tyre në këtë proces të planifikimit urban nga ana e përfaqësuesve komunal. Sikurse që është parashikuar me projekt, janë organizuar katër takime (gjatë muajve shkurt, mars, maj dhe qershor), ku morën pjesë përfaqësues të grupeve rinore dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme lokale; dhe gjatë këtyre takimeve është potencuar që vetëm me plotësimin e kërkesave të rinisë mund të kemi një pjesëmarrje të mirëfilltë në planifikimin urban që i përgjigjet të gjitha segmenteve të shoqërisë sonë.

Të gjeturat kryesore të këtyre takimeve theksonin se rinia Prizrenase pavarësisht nga cila zonë e qytetit graviton është e preokupuar me probleme pak a shumë të ngjashme. Ndër aspektet më të theksuara në këto takime ishin se planifikimi urban ka nevojë që të ketë parasysh disa dimensione të cilat të ndërlihdura ndikojnë tek rinia, dhe ato janë: infrastruktura publike, trashëgimia kulturore, shkollat, sport dhe kultura, ambienti, etj. Ajo çka ishte e përbashkët për të gjithë pjesëmarrësit është se gjatë planifikimeve të bëra komuna shumë rrallë është konsultuar me përfaqësuesit rinor dhe nuk është marrë mendimi i tyre mbi disa projekte të përcaktuara. Nëpërmjet përfshirjes së kërkesave të rinisë mund të vlerësohet edhe largpamësia e autoriteteve që ti përgjigjen qytetareve të tyre të rinj në mënyrë të mirëfilltë. Për fat të mirë gjatë realizimit të këtyre takimeve është vërejtur që përfaqësuesit qeveritar janë vetëdijësuar me rëndësinë e të rinjve andaj edhe kanë kërkuar të marrin sugjerimet e tyre nëpërmjet raportit përfundimtar të këtij projekti.

Hyrje

Së bashku me përfaqësuesit e organizatave rinore, autoritetet lokale të Prizrenit duhet të krijojnë kushte për zhvillimin dhe aprovimin e një politike të mirëfilltë për mjedis urban e cila është në harmoni me

bashkëveprimin shoqëror dhe zhvillimin e mirëfilltë të sipërfaqeve publike. Kjo për arsye se Kosova është nënshkruese e shumë dokumenteve ndërkombëtare dhe shumë dokumente të tjera janë pjesë përbërëse e legjislacionit vendor.

Sipas Kartës së rishikuar Evropiane mbi pjesëmarrjen e të rinjve në jetën publike theksohet se “Autoritetet lokale dhe rajonale duhet të ushtrojnë politikën e banimit dhe mjedisit urban të cilat i përfshijnë të rinjtë në marrëveshjet konsultuese së bashku me përfaqësuesit e zgjedhur lokal dhe rajonal, ekonomistët dhe vendimmarrësit, udhëheqësit e asociacioneve dhe arkitektët. Qëllimi i tyre është: i) të hartojnë programe për një mjedis më të harmonishëm e të përshtatshëm për vetëkënaqje personale dhe zhvillimin e një solidariteti të vërtetë mes gjeneratave; dhe ii) të zhvillojnë politikë të përbashkët për mjedisin urban që merr parasysh realitetin shoqëror dhe ndërkulturor të banorëve...”.

Po ashtu edhe në takimin e lart të ministrave të organizuar nga UN-Habitat me temën “ Trendët globale të urbanizimit dhe rritja demografike e të rinjve” të mbajtur në korrik të vitit 2013 në Gjenevë të Zvicrës është theksuar se duhet të punohet në ndërrimin e modelit të tanishëm të urbanizimit dhe të kemi një qytete me produktiv duke u fokusuar në çështje strategjike sikurse që janë legjislacioni urban, planifikimi urban, shfrytëzimi i tokave, etj që si të tilla duhet të kenë të gërshetuara kërkesat rinore në qendër të këtij transformimi urban.

Arsyeja se pse është e rëndësishme që të përfshihet rinia në proceset e planifikimit urban në komunën e Prizrenit kanë të bëjnë edhe me faktin që pjesa më e madhe e qytetareve tanë janë të moshës së re dhe ndikimi i tyre mund të jetë progresivë në zhvillimin në nivel lokal. Ajo çka ka nevojë të adresohet është çështja e përfshirjes së tyre pasi që një pjesë e madhe e tyre e ndjen veten të marginalizuar nga agjendat e politikë bërjes lokale. Një gjë e tillë është vërtetuar edhe me analizën e veçantë të përpiluar nga ana e organizatës Ec me Ndryshe.

Po ashtu edhe Kuvendi Komunal i Prizrenit me vendimin e Marsit të vitit 2012 për revidimin e politikave rinore e njeh rëndësinë e pjesëmarrjes së të rinjve në vendimmarrje; dhe në të gjitha proceset që e prekin statusin e të riut dhe zhvillimin individual si qytetar aktiv sot dhe bazë për zhvillim të qëndrueshëm të komunës tani dhe në të ardhmen. Ky dokument ka theksuar se mungesa e politikave të qëndrueshme ka bërë që sot një numër i madh i organizatave, grupeve dhe individëve të moshave rinore në qytetin e Prizrenit të mos kenë hapësira fizike ku mund të zhvillojnë njohuritë dhe aftësitë e veta jashtë sistemit të arsimit formal. Po ashtu, edhe shumë të rinj jashtë shkollorë, që janë të papunësuar, kanë nevojë për këto hapësira fizike për të ushtruar e zhvilluar aktivitete e njohuri në lëmi të ndryshme. Me një dizajnim më të mirë të politikave për rininë do të kishim arritur që të ndikonim në përmirësimin e infrastrukturës rinore si asaj fizike ashtu dhe asaj ligjore. Ndërsa sa i përket pjesëmarrjes se të rinjve kërkohet nga drejtorit përgjegjëse që të ndërmarrin veprime afirmative që në bashkëpunim me zyrtarin për rini të komunës së Prizrenit të krijojnë kushte për plotësimin e kërkesave të tyre.

Situata aktuale

Situata aktuale sa i përket përfshirjes së rinisë në planifikimin urban ka theksuar se fillimisht pjesëmarrja e tyre në këtë proces është shumë e vogël; kjo është ndërlidhur edhe me problemin e vetëdijesimit qytetar për pjesëmarrje në procesin e planifikimit urban. Njëkohësisht në bashkëbisedime me përfaqësuesit rinor është përmendur se nuk kemi një mekanizëm të mirëfilltë që do të sigurojë përfshirjen e tyre në këto procese dhe që do të ju garantojë atyre që sugjerimet dhe rekomandimet e tyre do të merren parasysh. Së dyti nuk ka ekzistuar një mobilizim i mirëfilltë dhe gjithë përfshirje e grupeve rinore me qëllim që të jenë pjesë e procesit për rishikimin e politikave lokale; dhe inkurajimi i rinisë që të

merr pjesë në përpilimin e politikave lokale duhet të fokusohet në fuqizimin e tyre dhe këtu autoritetet lokale duhet të ofrojnë mundësi që ata të jenë pjesë e këtyre proceseve.

Ndër parimet bazë të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 theksohet që planifikimi hapësinor dhe rregullimi duhet ta bëjnë promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndër-sektoriale në formulimin e strategjive zhvillimore dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor. Kjo nënkupton që gjatë këtij procesi duhet të merret edhe mendimi i rinisë pasi që ajo përbën shumicën dërmuese të shoqërisë Kosovare dhe njëkohësisht roli i saj në shtytjen pozitive të proceseve shoqërore është i madh.

Sipas Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës theksohet se qytetarët kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitetet e komunës; dhe Neni 68.4 nga kapitulli Për demokracinë e drejtpërdrejtë dhe mekanizmat e pjesëmarrjes së qytetarëve të këtij ligji thekson: “Kuvendi i komunës miraton rregulloren komunale që promovon transparencë të organeve legjislative, ekzekutive dhe administrative të komunës, duke e rritur pjesëmarrjen e opinionit në marrjen e vendimeve në nivel lokal dhe duke lehtësuar qasjen publike në dokumentet zyrtare të komunës. Ministria përgjegjëse për qeverisjen lokale mund të nxjerrë udhëzime administrative për transparencë komunale”. Në këtë mënyrë edhe inkurajohen komunat që gjatë procesit të bërjes së planeve zhvillimore, politikave lokale, përcaktimet apo planifikimet buxhetore të konsultohen aktoret kryesor me qëllim që ato të jenë në përputhje me kërkesat e qytetarëve.

Asociacioni i Komunave të Kosovës në Deklaratën Parimore mbi Planifikimin Urban dhe Rural thekson së planifikimi hapësinor është i një rëndësie thelbësore për zhvillimin e Kosovës. Sipas këtij dokumenti është konstatuar se planifikimi urban dhe rural është proces dinamik dhe i vazhdueshëm dhe si i tillë mbetet prioritet në përmbushjen e synimeve zhvillimore dhe të përmirësimit të jetës së qytetarëve të Kosovës. Mbi bazën e planeve të hartuara deri më sot, është arritur që të identifikohen nevojat aktuale dhe ato të ardhshme të vendbanimeve të Kosovës. Në këtë kuadër, zhvillimi i planifikuar i banimit, hapësirave publike, infrastrukturës teknike dhe sociale, si dhe përkrahja e ndërmarrjeve, shoqërisë civile dhe iniciativave qytetare dhe rinore, mund të ndikojnë në përmirësimin gradual të kushteve për investime private dhe për partneritet publik-privat.

Fatkeqësisht në të kaluarën shumë vendime janë marrë duke mos u konsultuar grupet e interesit dhe kjo është arsyeja që në legjislacionin Kosovar është përfshirë krijimi i mekanizmave që do të siguronin që zëri i të gjitha shtresave të popullatës (dhe në rastin tonë rinisë) do të dëgjojë dhe mendimi i saj do të merret në konsideratë. Kjo për arsye se më një demokraci të mirëfilltë jo vetëm politikave lokale por edhe të gjitha vendimet do të duhej të ishin në përputhje me kërkesat e të sotmes por edhe të ardhmes; duke krijuar vlera të reja dhe duke mos dëmtuar ato çka janë ndërtuar me shekuj në këto treva. Andaj nëpërmjet këtij dokumenti kërkohet që në përputhje me legjislacionin Kosovar të krijohet një qasje proaktive me qëllim të përfshirjes së mirëfilltë të tyre në këto procese.

Të gjeturat

Gjatë punës në fokus grupe, bashkëbisedimeve, debateve dhe analizave të ndryshme me grupet rinore të Prizrenit është theksuar se në të kaluarën përfshirja e rinisë në planifikimin urban nuk është bërë në mënyrë të mirëfilltë gjë që mund të shihet qartazi edhe me situatën aktuale në terren sikurse është shprehur nga ana e tyre. Shpesh herë planifikimet urbane bëhen pa u konsultuar grupet rinore dhe kjo reflektohet me veprime që nuk janë në pajtim me kërkesat dhe nevojat e këtij grupi shoqërorë. Gjatë takimeve me këto grupe përfaqësuesit e organizatës Ec më Ndryshe kanë mbledhur të gjitha brengat e

tyre dhe mbas një analize është vërejtur së ato prekin disa dimensione të planifikimit urban, sikurse që janë: Infrastruktura publike dhe trashëgimia kulturore; Infrastruktura arsimore dhe shkollat; Infrastruktura për punësimin e rinisë; dhe ndikimi i menaxhimit urban tek rinia.

Infrastruktura publike dhe trashëgimia kulturore

Sa i përket infrastrukturës publike në takimet me grupet rinore janë theksuar disa probleme që kanë të bëjnë me rrugë të pa asfaltuara dhe mungesës së ndriçimit publik në lagjet e frekuentuara dhe ato periferike; Mbindërtimet dhe ndërtimet e egra dhe uzurpimi i hapësirave publike nga bizneset e ndryshme; Shkatërrimi i strukturës urbane të lagjeve të Prizrenit, në të cilat ka dominuar harmonia e shtëpive të vjetra qytetare dhe komercializimi i parkut të qytetit që kufizon qasjen e lirë të rinisë në ato mjedise; Po ashtu pjesëmarrësit nga grupet rinore kanë theksuar edhe probleme që kishin të bënin me mungesën e pjerrinave në shkolla dhe objektet publike; në të shumtën e rasteve me ndërtime të pakontrolluara janë kufizuar rrugët qarkulluese për makina por edhe trotuaret.

Mbrojtja e objekteve kulturore është rrezikuar me ndërtimet pa leje në zonën Historike të qytetit dhe kjo dëmton edhe objektet me rëndësi nacionale sikurse që është Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; në shumë raste edhe ndalimi i punimeve të restaurimit sikurse që është rasti me Kalanë e Prizrenit ndikon në dëmtimin e saj dhe rrezikimin e qytetareve. Mos aplikimi adekuat i Planeve Rregullative Urbane ka shkaktuar që shumë hotele dhe objekte tjera afariste të ngritën në mënyrë të pakontrolluar në zonën e mbrojtur të qytetit dhe kjo ka afektuar negativisht imazhin e qytetit të Prizrenit si qytet që mbron trashëgimin kulturore të saj.

Infrastruktura arsimore dhe shkollat

Ndër problemet që infrastruktura arsimore dhe shkollat ndikon tek te rinjtë e qytetit janë se objektet e reja shkollore kanë probleme strukturore sikurse që janë dëmtimet dhe plasaritjet dhe në disa raste kjo ka nxitur edhe reagimin e prindërve. Për shkak të mungesës së mjediseve të mjaftueshme shkollore në disa shkolla ende mësimi vijohet në tre (3) ndërrime, ndërsa nxënësit e ndërrimit të fundit të disa shkolla detyrohen të kthehen në shtëpi nëpër rrugët pa ndriçim të qytetit. Në disa shkolla ende është evidente problemi elementare, sikurse që është furnizimit me ujë apo edhe nxehje, dhe në raste të keqësimit të kushteve klimatike kjo mund të ndikon edhe në shëndetin e tyre.

Në shumë raste mos rregullimi i mirëfilltë i infrastrukturës rrugore ka shkaktuar parkimin e veturave në trotuaret në afërsi të shkollave; që paraqet pengesë në qarkullimin e lirë të nxënësve. Disa prej të rinjve kanë ngrit çështjen e mungesës së objekteve përcjellëse në të cilat nxënësit mund të kryenin aktivitetet të shumta arsimore sikurse që janë hapësira për lexues në bibliotekën e qytetit; disa nga e rinjtë e potencuan se problemi i vendeve të kufizuara në konviktin e qytetit e pamundëson shkollimin e më tutjemë të rinisë nga zonat rurale.

Infrastruktura rekreative sportive për të rinjtë

Një pjesë e rinisë ka potencuar që sa i përket infrastrukturës sportive problem kryesor fillimisht është gjendja e mjerueshme e Stadiumit të Qytetit, edhe pse ka filluar shtruarja e barit sintetik; në të shumtën e rasteve ka edhe mungesë të hapësirave të mjaftueshme rekreative sportive në lagje të qytetit që e pamundëson rininë të merret me aktivitete të mirëfillta shoqërore. Qendra Sportive e qytetit është jo e gatshme plotësisht për shfrytëzim aktivë të saj dhe ka mungesë të ngrohjes që e pamundëson bërjen e aktiviteteve në sezonin dimërore;

Fushat sportive nëpër shkollat fillore dhe të mesme kanë qasje të kufizuara apo edhe kushte shumë të dobëta për kryerjen e aktiviteteve sportive nga të rinjtë. Në fund pjesëmarrësit kanë theksuar se klubet

sportive të qytetit kanë një infrastrukturë të mjerueshme dhe nuk ka një plan të mirëfilltë për përkrahjen e tyre nga drejtorit gjegjëse; në të shumtën e rasteve ka një mungesë të hapësirave adekuatë për zhvillimin e sporteve të reja. Po ashtu të rinjtë që gravitojnë nga zonat rurale kanë theksuar që është e nevojshme të bëhet ndërtimi i terreneve sportive edhe në fshatra pasi që rinia në këto zona ndjehet e marginalizuar dhe nga këto mangësi kufizohet pjesëmarrja e tyre në gara të ndryshme të nivelit komunal apo regjional.

Infrastruktura kulturore dhe rinia

Sa i përket gjendjes aktuale të infrastrukturës kulturore dhe mundësisë së rinisë për afirmimin e saj në këtë aspekt është përmendur që si e domosdoshme që të bëhet renovimi i Shtëpisë së Kulturës; dhe njëkohësisht autoritetet lokale duhet të gjejnë zgjidhje të mirëfilltë sa i përket menaxhimit të këtij objekti pasi që problem evident është funksionimi i tre institucioneve brenda kësaj ndërtese. Një pjesë e ka theksuar edhe nevojë për përmirësimin e kushteve në Shkollën e Mesme të Muzikës “Lorenc Antoni” ku një numër i të rinjve vijojnë aktivitetet kulturore. Kuvendi komunal nuk ka krijuar krijoj kushte të mirëfillta për shfrytëzim të hapësirave publike gjatë organizimit të festivaleve në qytetin e Prizrenit.

Ambient i mirëfilltë urban dhe rinia

Me qëllim ofrimi të kushteve të mirëfillta për jetesë për qytetaret e komunës së Prizrenit, është potencuar nga rinia se ekziston një nevojë e madhe për qasje me aktive në mbrojtjen e ambientit jetësor nga autoritetet lokale. Shumë të ri kanë shprehur se ka një mungesë të aktiviteteve për vetëdijësimin publik por edhe pastrim nga ana e kompanive publike gjë që reflektohet edhe me kufizimin e hapësirave publike sikurse që janë parqet nga deponimi i mbeturinave. Në shume prej shkollave nuk ka aktivitete të organizuara nga drejtoria për pastrimin e oborrit të shkollave dhe mbjelljen e fidanëve të cilat do të ofronin një pamje me të mirë dhe përmirësonin imazhin e komunës së Prizrenit.

Në disa zona të qytetit ekziston një praktike e djegies së mbeturinave që shkakton ndotjen e më tutjeme të ambientit dhe shumë herë nuk është vërejtur reagimi i shpejtë i institucioneve gjegjëse komunale apo edhe atyre të sigurisë për parandalimin e tyre. Është theksuar se autoritetet lokale nuk janë duke i përdor praktikën e mirë për mbrojtjen e ambientit nga shtetet e ndryshme të rajonit dhe këtu merret si shembull konkret modeli i Sllovenisë. Në shumë lagje të qytetit ka mungesa të shportave dhe kontejnerëve, gjë që shkakton krijimin e deponive joformale. Për shkak të hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave Lumëbardhi është ndotur në mënyrë të konsideruar; dhe kur kësaj i shtohet edhe kycja ilegale e rrjetit të kanalizimit kundërmimi gjatë periudhës së verës është shumë i rend. Në fund duhet të theksohet se edhe ndotja akustike ka një ndikim të madh në krijimin e një ambienti të mirëfilltë dhe institucionet e rendit dhe autoritet lokale nuk kanë ndërmarr asnjë veprim afirmative për ta zgjidhur atë.

Infrastruktura për punësimin e rinisë

Njeri ndër problem e theksuara nga të rinjtë ishte pamundësia e punësimit të tyre dhe shumë prej tyre kanë shprehur pakënaqësitë sa i përket ofertave të kufizuara për punësim të plot apo pjesëshëm. Disa nga aspektet e lartpërmendura kanë ndikimin e tyre direkt apo të tërthorët në krijimin vendeve të reja të punës duke përfshirë këtu edhe punët sezonale. Në shume raste për shkak të kushteve të dobëta ekonomike është duke u prekur edhe mundësia e tyre për vijimin e shkollimit të më tutjem.

Në disa raste rinia ka potencuar se për shkak të mos përkrahjes së bizneseve lokale edhe mundësia për gjetjen e vendeve të reja të punës është e kufizuar. Ofertat e tregut për të rinjtë janë zakonisht për punë të “nivelit të ulët” gjë që ndikon në mënyrë negative në frymëzimin e tyre për zhvillim të më tutjemë personal dhe profesional. Zakonisht institucionet lokale nuk ofrojnë një kontroll të mirëfilltë për

mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve posaçërisht atyre të rinj; dhe nuk ka politika të mirëfillta lokale për krijimin e vendeve të reja të punës.

Ndikimi i menaxhimit urban tek rinia

Menaxhimi i mirëfilltë urban do të parandalonte organizimin e aktiviteteve negative sikurse që janë narkomania dhe alkoolizmi, njëkohësisht nga mungesa e një veprimi parandalues sot në kemi shumë të rinjtë të ndikuar nga fenomenet negative. Rast konkret të cilën rinia e ka marr si shembull është puna e pakontrolluar e lokaleve deri në ore të vona dhe mos kontrollimi i shfrytëzimit të materieve të ndaluara në këto mjedise. Institucionet lokale shpesh herë janë vetëm dëshmitar të tyre dhe nuk ndërmarrin asnjë veprim për luftimin e tyre.

Rekomandime

Me qëllim të përfshirjes së të rinjve në procesin e vendimmarrjes për planifikim urban disa ndër rekomandimet që duhet të merren parasysh nga autoritetet lokale janë:

Rekomandimi 1: gjatë organizimit të takimeve publike duhet të ftohen përfaqësuesit e grupeve rinore që të japin sugjerimet e tyre nëse këto plane janë ne përputhje me kërkesat rinore; këtu një rol të rëndësishëm mund të luaj Këshilli për Veprim Lokal dhe në bashkëpunim të ngushtë me Zyrtarin për Rini pran kuvendit komunal të Prizrenit.

Rekomandimi 2: Zonat përreth shkollave dhe mjediseve ku frekuenton rinia duhet të kenë të zgjidhur problemin e ndriçimit publik dhe njëkohësisht edhe rrugët duhet të ofrojnë një siguri më të madhe nga lëvizja e makinave dhe këtu duhet të bëhet një analizë se ku duhet të bëhet ndërtimi i mbikalimeve.

Rekomandimi 3: Duhet të ndërmerren veprime afirmative për ndalimin e ndërtimeve të egra në zonat publike dhe të ndalet praktika e komercializimit të mjediseve të cilat shfrytëzohen nga rinia.

Rekomandimi 4: në të gjitha objektet publike duhet të instalohen pjerrinat me qëllim që të mundësohet qasje e lire e personave me aftësi të kufizuara; po ashtu në projektet e reja infrastrukturore duhet të bëhet kriter që ato ti kenë të inkorporuar këto kërkesa;

Rekomandimi 5: duhet të fillon aplikimi i mirëfilltë i legjislacionin dhe Planit Rregullative Urban që mundëson mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zonës historike të qytetit; autoritetet lokale në bashkëpunim me ato qendrore duhet të ndalojnë ndërtimet e egra të objekteve afariste.

Rekomandimi 6: Autoritetet lokale duhet të kenë kontroll më të madh gjatë procesit të pranim dorëzimit të objekteve të reja shkollore duke i mbajtur përgjegjës kompanitë ndërtimore dhe duke aplikuar ndëshkime në rast të mos respektimit të kushteve të kontratës për ndërtim;

Rekomandimi 7: duhet të ofrohen kushte të mirëfillta mësimore në të gjitha shkollat e komunës së Prizrenit; këtu fillimisht duhet të bëhet analiza e situatës dhe të shikohet se cila është gjendja aktuale e këtyre objekteve dhe të parashikohet me kornizën afat-mesme buxhetore investimet për bërjen e këtyre rregullimeve.

Rekomandimi 8: Policia e shtetit duhet të ndërmerr veprime afirmative në parandalimin e parkimit të veturave pran objekteve shkollore që pamundëson qasjen e lire të nxënësve dhe personelit arsimor në këto objekte;

Rekomandimi 9: duhet të ndahet një buxhet i mirëfilltë për rregullimin e infrastrukturës sportive në qytet me fokus të veçantë në Stadiumin e qytetit dhe Qendrën sportive me qëllim të krijimit të kushteve të mirëfillta në këto objekte; njëkohësisht në bashkëpunim me grupet rinore duhet të bëhet identifikimi i hapësirave për ndërtimin e zonave rekreative në lagje të ndryshme të qytetit.

Rekomandimi 10: duhet të ofrohet një mbështetje më e madhe për klubet sportive të qytetit me qëllim që ato të ofrojnë shërbime më të mira për rinin; këtu do të nënkuptonte edhe përfshirjet e përfaqësuesve nga këto klube në procesin e planifikimit dhe bërjes së buxhetit për vitin vijues.

Rekomandimi 11: Kuvendi komunal nëpërmjet drejtorisë për kulturë duhet të bëjë një investim më të madh në renovimin e Shtëpisë së Kulturës dhe të gjej zgjidhje për menaxhimin më të mirë të këtij institucioni; me qëllim që të ofrohet një qasje e lirë për rinin që të organizoj aktivitetet të ndryshme kulturore. Krijimi i një plani kulturor të qytetit me aktivitetet që planifikohen të organizohen brenda viti do të ofronte një informatë të mirëfilltë për rinin që ata të përfshihen në këtë proces.

Rekomandimi 12: duhet të bëhet një investim më i madh në Shkollën e Mesme të Muzikës “Lorenc Antoni” me qëllim që kushtet për mësim dhe organizimin e aktiviteteve kulturore brenda këtij institucioni të jenë më të mira.

Rekomandimi 13: autoritetet lokale duhet të punojnë më tepër në vetëdijesimin publik për mbrojtjen e ambientit jetësor, këtu sugjerohet të vazhdohet me aplikimin e çmimit “Rruga më ekologjike” që bëhet çdo vit në qytet.

Rekomandimi 14: drejtoritë e shkollave në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe këshillat e nxënësve duhet të organizojnë aktivitete të ndryshme me qëllim të pastrimit të oborreve të shkollave dhe parqeve duke përfshirë mbjelljen e fidanëve të reja.

Rekomandimi 15: autoritetet komunale në bashkëpunim me policinë e shtetit duhet të parandalojnë fenomenin e djegies së mbeturinave dhe të fillojnë me aplikimin e politikës së gjobave për dëmtuesit e ambientit (duke përfshirë këtu edhe ndotjen akustike) dhe këtu sugjerohet të analizohen dhe aplikohen praktikat e mira nga shtetet e tjera.

Rekomandimi 16: autoritetet lokale duhet të instalojnë shporta dhe kontejner në zona të ndryshme të qytetit me qëllim të parandalimit të hedhjes së mbeturinave në qytet; këtu sugjerohet që ky aktivitet të organizohet në bashkëpunim me grupet rinore për identifikimin e lokacioneve më të përshtatshme.

Rekomandimi 17: projekti për mbrojtjen e Lumëbardhit duhet të iniciohet nga autoritetet lokale dhe ato qendrore dhe të parandalohet kycja ilegale e rrjetit të kanalizimit; këtu kërkohet që qeveria lokale të jetë më proaktive me kërkesa ndaj autoriteteve qendrore për arsye se nga derdhjet e kanalizimit në lum rrezikohet jo vetëm shëndeti publik, por edhe dëmtohet rëndë flora dhe fauna e Lumëbardhit.

Rekomandimi 18: autoritetet komunale duhet të dalin me një strategji komunale për zhvillim ekonomike e cila do të përfshinte rinin dhe do të ofronte mundësi për hapjen e vendeve të reja të punës; këtu përfshihet edhe lehtësimet për ato ndërmarrje të cilat ofrojnë vende të punës për student.

Rekomandimi 19: autoritetet lokale duhet të rrisin nivelin e kontrollit tek ndërmarrjet afariste me qëllim që të parandalojnë që ato të bëjnë shkeljen e të drejtave të punëtorëve me fokus të veçantë në rininë si pjesë më e brishtë e shoqërisë sonë.

Rekomandimi 20: autoritetet lokale në bashkëpunim me policinë e shtetit duhet të ndërmarrin veprime afirmative për inspektim të rregullt të orarit dhe kushteve të punës në lokale të ndryshme me qëllim të parandalimit të shkeljes së të drejtave të tyre dhe parandalimin e aktiviteteve të ndryshme negative.

VIII. Lagjet e varfra/vendbanimet joformale dhe planifikimi urban në Prizren

Lagjia Arbana, Prizren

Shkruar nga, Nol Binakaj

Përmbledhje ekzekutive

Për një proces të mirëfilltë të rregullimit urban, padyshim se komuniteti duhet të jetë pjesë e procesit që nga fillimi. Pjesëmarrja aktive e komunitetit është cdo proces në të cilin nëpërmes përfshirjes dhe marrjes së informatave nga ata arrihet deri te vendim-marrja apo zgjidhja e problemit. Ky proces njëkohësisht cilësohet si informim, edukim, konsultim, pjesëmarrje dhe bashkëpunim që rezulton në përfshirjen e interesave të grupeve të vecanta, vlerave që ata i cmojnë dhe sygjerimet e tyre për përmirësimin e kushteve elementare në politikën për rregullim.

Komunitetet që banojnë në vendbanimet joformale janë të marginalizuara sa i përket pjesëmarrjes në vendimmarrje. Nuk janë mjaft të përfshirë në vendimet e nivelit lokal për politikën zhvillimore që ndikojnë në komunitetin e tyre, apo vetëm janë të informuar për vendimet. Kjo qasje definohet vetëm si përpjekje simbolike për të përmbushur kërkesat ligjore, pa pasë mundësi që komuniteti të paktën të negocijojë apo të bëjë kompromise për politikën zhvillimore që në fund të fundit hartohen për vetë komunitetin.

Në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” në lagjen “Arbana” u zhvilluan debate me grupe të ndryshme të interesit, në të cilat janë trajtuar tematikat dhe problemet dhe mundësitë rreth planifikimit urban. Problemet kryesisht kanë të bëjnë me informalitetin e vendbanimit, duke filluar nga ndërtimet pa leje që dita ditës po shtohen, mungesës së ujit të pijshëm, mungesës së kanalizimit, pra probleme nga më bazike deri tek ato të cilat kanë të bëjnë me rritjen e mirëqenies së qytetarëve, pra shërbimi apo përkujdesja shëndetsore, arsimore, mungesa e hapësirave për rekreim, mungesa e ndriqimit publik dhe siguria e banorëve në përgjithësi.

Mënyra e rekomanduar e përmirësimit të gjendjes ekzistuese në lagjen “Arbana” duhet të bazohet në përmirësimin/zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve ekzistuese. Përparësi e kësaj mënyre të trajtimit është se nuk e shqetëson jetën ekonomike dhe sociale të komunitetit. Vlerësohet lartë dhe është më se e domosdoshme pjesëmarrja e komunitetit në procesin e përmirësimit të vendbanimit, ndërkaq komuna duhet të fokusohet në legalizimin e ndërtimeve pa leje, përmirësimin e kushteve mjedisore, sociale dhe ekonomike përmes rregullimit të infrastrukturës, hapësirave publike, shërbimeve bazike publike si shkollat, transporti publik, menaxhimi i mbeturinave, furnizimi me ujë, telefon etj.

Hyrje

Për një proces të mirëfilltë të rregullimit urban, padyshim se komuniteti duhet të jetë pjesë e procesit që nga fillimi. Pjesëmarrja aktive e komunitetit është cdo proces në të cilin nëpërmes përfshirjes dhe marrjes së informatave nga ata arrihet deri te vendim-marrja apo zgjidhja e problemit. Ky proces njëkohësisht cilësohet si informim, edukim, konsultim, pjesëmarrje dhe bashkëpunim që rezultojnë në përfshirjen e interesave të grupeve të vecanta, vlerave që ata i cmojnë dhe sygjerimet e tyre për përmirësimin e kushteve elementare në politikën për rregullim.

Pjesëmarrja e komunitetit në vendim-marrje përveq se është kërkesë ligjore, ndikon në ngritjen e kualitetit të vendimeve, dhe në qeverisjen e mirë dhe transparente. Pjesëmarrja kontribon në vendime më të mira dhe racionale, sepse vendim-marrësit janë të inforumuar për problemet, faktet, vlerat dhe pikëpamjet e publikut, posaqërisht kur kemi të bëjmë me trajtimin e vendbanimeve joformale. Vendimet apo planet e hartuara në këtë mënyrë janë reale dhe të zbatueshme. Si rezultat i pjesëmarrjes së publikut çdo vendim është legjitim dhe i përkrahur, dhe ka më pak mundësi të kundërshtohet nga publiku në fazën e implementimit.

Në vijim janë të përmendura disa nga rastet dhe modele të mira të cilat kanë rezultuar me zgjedhje konkrete për grupe të ndryshme të interesit. Këto modele janë aplikuar në shtete të rajonit dhe ato perendimore, dhe duke pas parasysh kontekstin kosovar janë lehtë të implementueshme.

Shqipëri – Planifikimi lokal pjesëmarrës

Projekti i programit të përbashkët të KB-së “Fuqizimi i Komuniteteve të Ndjeshme Lokale në Shqipëri” synon të promovojë siguri njerëzore në mes të komunitetit RAE. Projekti është zbatuar nga autoritetet lokale të rajoneve të Durrësit, Elbasanit, Fierit dhe Tiranës në bashkëpunim me programin e përbashkët të KB-së.

Planifikimi pjesëmarrës përbën një ndër tre komponentat e projektit. Si pjesë e procesit të planifikimit pjesëmarrës është themeluar një grup këshillues i përbërë nga komuniteti RAE, në grup ka pasë përfaqësim të balancuar gjinor. Detyra e grupit ka qenë identifikimi dhe prioritizimi i nevojave lokale. Komunikimi në mes të grupit dhe nivelet lokal është bërë duke shfrytëzuar një person të moshuar. Problemet dhe prioritet janë përfshirë në planin lokal zhvillimor, dhe zbatimi i tyre është bërë në bashkëpunim me programin e KB-së. Projektet e dala nga këto prioritetet janë rrugë, sisteme të kanalizimit, dhe infrastrukturë sociale. Kjo qasje aktualisht është duke u zgjeruar edhe në rajonet e tjera të Beratit, Korçës, dhe Vlorës dhe financohet nga projekti i Unionit Evropian “Përfshirja sociale e Komunitetit RAE në Shqipëri”.

Mali i Zi – hartimi i planeve lokale të veprimit për integrimin e komunitetit RAE

Hartimi i planeve lokale të veprimit për komunitetin RAE është inicuar nga OJQ Pocetak në Nikshiq në vitin 2007 duke mbledhur të dhëna me ndihmën e një eksperti, dhe ka vazhduar në Herceg Novi dhe Tivat nga OJQ Mladi Romi në bashkëpunim me nivelin lokal. Plani në Nikshiq është mbështetur financiarisht nga ambasada e SHBA-ve në Podgorice, dhe planet në Tivat dhe Herceg Novi janë mbështetur nga Fondacioni Instituti për Shoqëri të Hapur.

Komuna Berane, Bijelo Polje, dhe Ulqin në vitin 2012 kanë themeluar grupet punuese të përbërë nga komunitetet RAE, stafit të administratës lokale, edukimit, shëndetësisë, mirëqenjes sociale dhe planifikimit urban. Detyrë e grupit punues ka qenë hartimi i planeve të veprimit lokal bazuar në përvojën e komunave të Tivatit, Herceg Novi, dhe Nikshiq.

Serbi – bashkëpunim i qendrueshëm në mes të komunës dhe OJQ-ve lokale

Në komunën e Beogradit, në Surcin, kryetari i komunës ka inicuar bashkëpunimin me dy OJQ lokale të komunitetit RAE. Bashkëpunimi ka qenë i sukseshëm falë komunikimit të vazhdueshëm personal të kryetarit dhe OJQ-ve.

Në fillim bashkëpunimi në mes të OJQ-ve dhe komunës ka qenë i fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës, më vonë ky bashkëpunim është zgjeruar edhe në fushat tjera si edukim, punësim dhe mbështetje materiale.

Komuna është mbështetëse financiare e këtij bashkëpunimi në mënyrë konstante, alokimi i mjeteve bëhet nën projektin “Përmirësimi i standardeve të jetës së komunitetit RAE”. Për të rritur mjete financiare, kryetari i komunës organizon dy ngjarje në vit për të mbledhë donacione nga banorët lokal. Komuna shton shumë të njëjtë të parave mbi ato që mbledhen nga banorët lokal, dhe gjithashtu mbledhën mjete nga lotaria lokale.

Austri – Vjenë „Gratë-Puna-Qyteti”

Në kontekstin e zgjerimit të zonës urbane, në Vjenë është pilotuar me një pjesë të periferisë së qytetit ku krahas punës me gra dhe femra, analizës së nevojave të tyre për zhvillimin sa më të lehtë të aktiviteteve të përditshme, elementet e planifikimit dhe dizajnit urban janë hartuar nga gratë eksperte të kësaj fushe. Objektivi kryesorë i kësaj qasje ka qenë shëndërrimin e aspekteve të shumanshme të jetës së përditshme të grave në kriter thelbësor të planifikimit dhe dizajnit. Për më tepër angazhimi i arkitekteve për këtë projekt është motivuar nga pritjet që jeta e përditshme e tyre komplekse – e që është e ndryshme nga e burrave – të reflektojë pozitivisht në dizajnet e tyre.

Kjo qasje ka rezultuar në planifikim të mirëfilltë, qëi ka mundësuar grave lehtësim të aktiviteteve të tyre të përditshme, duke filluar nga shkurtimi i rrugës për në stacionin e autobusëve, integrimin e funksioneve komplementare si qerdhe dhe qendër të mjeksisë familjare në afërsi, apo në vetë bllokun e banimit, parqe me qasje të lehtë dhe pa bariera. Gjithashtu është përmirësuar siguria në lagje duke investuar në ndriqimin publik edhe në shumë pjesë tjera të vendbanimit që më parë janë cilësuar si investime të panevojshme.

Situata aktuale

Vendbanimet joformale janë të përhapura dhe paraqesin një dukuri tashmë afatgjate në komunat e Kosovës. Ekzistojnë lloje të ndryshme të vendbanimeve joformale mirëpo kryesisht karakterizohen me posedim joformal dhe jo të sigurt të pronës, qasje joadekuate në shërbimet themelore, mungesë të infrastrukturës fizike dhe sociale. Bazuar në hulumtimin e bërë nga Planet hapësinore dhe urbanistike të miratuara derimë tani si dhe rezultateve të puntorive regjionale për identifikimin e Vendbanimeve Joformale me komunat e Kosovës janë identifikuar 174 vendbanime joformale.

Komunitetet që banojnë në vendbanimet joformale janë të marginalizuar sa i përket pjesëmarrjes në vendimmarrje. Nuk janë mjaft të përfshirë në vendimet e nivelit lokal për politikat zhvillimore që ndikojnë në komunitetin e tyre, apo vetëm janë të informuar për vendimet. Kjo qasje definohet vetëm si përpjekje simbolike për të përmbushur kërkesat ligjore, pa pasë mundësi që komuniteti të paktën të negocijojë apo të bëjë kompromise për politikat zhvillimore që në fund të fundit hartohen për vetë komunitetin.

Në kuadër të rregullimit dhe zhvillimit të vendbanimeve joformale ekzistuese njëra ndër sfidat kryesore është kompletimi i legjislacionit me anë të hartimit të ligjeve dhe udhëzimeve administrative në mënyrë që të orientohet tregu i tokës si dhe të kontribohet në zhvillimin kompakt të vendbanimeve. Aprovimi i Ligjit për Legalizimin e Ndërtesave pa Leje, i cili është në proces të diskutimit në Kuvendin e Kosovës, gjegjësisht në Komisionin për Planifikim Hapësinor, cilësohet si një nga ligjet kryesore me anë të së cilës do të mundësohej ri-vlersimi dhe kategorizimi i këtyre zonave dhe strukturave ekzistuese në to, si dhe krijimin e mundësive të zhvillimit nëpërmjet planifikimit të mirëfilltë, gjithmonë duke pas parasyshë kërkesat e komuniteteve. Një nga sfidat në nivelin komunal janë revidimet e Planeve Zhvillimore Urbane me anë të së cilës evidentohen këto zona si prioritare për trajtim.

Nevojë imediate është përpilimi i profileve dhe krijimi i bazës së dhënave përvendbanimet joformale nga komuna në mënyrë që të përcaktohen vendbanimet prioritare për rregullim. Rrjedhimisht nga këto të dhëna do të paraqitet mungesat e infrastrukturës fizike dhe sociale në vendbanimet joformale, si bazë për hartimin e programeve komunale dhe parashikimin e buxhetit për përmirësimin e këtyre kushteve.

Të gjeturat

Në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” në lagjen “Arbana” u zhvilluan debate me grupe të ndryshme të interesit, në të cilat janë trajtuar tematikat dhe problemet dhe mundësitë rreth planifikimit urban. Gjithsej u organizuan 5 diskutime me banorë me tematika të ndryshme, prej nga dolën problemet dhe kërkesat të cilat do të duhej të merren parasysh në fazën e planifikimit:

Ndërtesat pa leje ndërtimore

Në bazë të dhënave që banorët e lagjës posedojnë, vetëm 10% të ndërtesave janë të paisura me leje ndërtimi nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor. Si rezultat i kësaj gjendje shtëpitë e ndërtuara janë shumë afër njera tjetër dhe poashtu janë të vendosura shumë afër rrugëve kryesore, fakti ky që do të rezultojë me pamundësimin e planifikimit dhe zgjerimit të rrugëve në këtë lagje. Arsye tjetër e kësaj gjendje është edhe mos efikasiteti i Inspektoriatit Komunal për të ndërprerë ndërtimin pa leje.

Mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm

Cilësohet si një nga problemet kryesore të banorëve të lagjes, dhe deri më tani zgjidhjet e bëra nuk janë të qëndrueshme dhe janë kryesisht në baza individuale. Një pjesë e madhe e lagjës, diku rreth 300 shtëpi, nuk është kycur fare në rrjetin ekzistues të furnizimit me ujë nga Hidroregjioni Jugor i Komunës së Prizrenit. Shumica e tyre e përdorin ujin për ujitje edhe për nevojat e tyre për pastrim. Uji i puseve që përdoret nuk është i pijshëm. Puset që janë krijuar vetë nga banorët për ujë të pijshëm pengojnë në kalimin nga rruga. Pjesa tjetër që ka kycje poashtu nuk ka cilësi të ujit si problem i rrjetit të vjetëruar dhe gypeve nga azbesti.

Mungesa e rrjetit të kanalizimit

Mungesa e kanalizimit në lagje, i ka shtyer banorët që poashtu të ndërmarrin hapa të paqëndrueshëm dhe individual për zgjidhjen e këtij problemi. Kryesisht zgjidhja e problemit është bërë nëpërmjet hapjes së gropave septike, ku përpos ndikimit në nivelin e pa-pastërtisë dhe kundërmimit të lagjes, poashtu rrezikojnë edhe ndotjen e puseve të ujit dhe rrisin mundësinë e shfaqjes të ndonjë epidemie e cila mund t'a kaplojë jo vetëm lagjen si veqanti por dhe qytetin të tërësi.

Furnizimi me energji elektike

Infrastruktura ekzistuese e furnizimit me energji elektrike është e dobët dhe si e tillë nuk i përmbushë kërkesat e konsumatorëve në këtë lagje. Situata bëhet edhe më e rëndë duke pas parasysh faktin se në këtë lagje është duke u rrit numri i banorëve dhe ndërtimeve tjera dita ditës. Rryma është shumë e dobët dhe jo më e fortë se 160 volt ndërkaq trafo ekzistuese nuk ka kapacitet t'i përfshijë të gjitha shtëpitë e lagjes.

Infrastruktura e dobët rrugore

Rrugët ekzistuese sekondare janë të pa asfaltuara dhe të pakufizuara me trotuarë. Mungesa e trotuarëve bën që të cenohet siguria e banorëve në këtë lagje. Për shkak të qarkullimit të automjeteve

me shpejtësi të madhe, kryesisht fëmijët janë kategoria më e rrezikuar për shkak se janë të obliguar të frekuentojnë këto rrugë si qasje kryesore për në shkollë. Ndërkaq rrugët kryesore janë të asfaltuara, brenda një periudhe kohore të shkurtër dhe për çështje elektorale, mirëpo cilësia e punimeve është e dobët për shkak të mos trajtimit të infrastrukturës përcjellëse që këto rrugë duhet ta kenë.

Mungesa e ndriqimit publik

Në të gjithë lagjen nuk ka ndriqim publik, dhe kjo është një nga faktorët kryesorë, krahas trotoreve, që kjo lagje cilësohet si e pasigurtë. Përveq mungesës së ndriqimit publik në këtë lagje qarkullojnë dhe shumë qenë endacak çka i kufizon banorët e kësaj lagje të kenë liri të lëvizjes.

Mungesa e konsistencës në shërbimin e Qendrës së mjeksisë Familjare në lagje

Kërkesë imediate e këtyre banorëve është që QMF e lagjes “Arbana” të punojë edhe gjatë ditëve të vikendit. Banorët ankohen se për çdo nevojë të vogël që mund t’i shërbejë QMF e Arbanës, ata detyrohen të shkojnë në Spital apo në QKMF-në e qendrës në qytet. Kjo vlenë për ata të cilët kanë gjendje financiare të mirë kurse ata të cilët janë pa një punë të vetme i vuajnë sëmundjet në shtëpitë e tyre.

Mungesa e funksioneve komplementare kulturore dhe rekreative

Kërkesë tjetër e banorëve e shprehur dhe potencuar gati në të gjitha takimet e mbajtura me ta është kërkesa për ndërtimin e një qendër kulturore dhe një fushë rekreative sportive, në mënyrë që qytetarët, sidomos grupet e të rinjëve të kenë hapësira ku do të mund të kalonin kohë me aktivitete të ndryshme kulturore e sportive. Një fushë ekzistuese rekreative sportive në lagjen Arbana është në gjendje jo të mirë si mungesë e mirëmbajtjes.

Rekomandimet e dala nga takimi me banorët

- Të ndalohet dukuria e pagesës së inspektorëve për objektet biznesore pa leje dhe të shkohet me procedura të rregullta për marrjen e lejes së punës nga DUPH;
- Në mungesë të trotuarëve në lagjen Arbana (kah pjesa e tregut) e drejt rrugës për në autostradë, një preventivë e vogël kundër rreziqeve të mëdha nga qarkullimi me shpejtësi i automjeteve është vendosja e policëve të shtrirë në rrugë. Kjo zgjidhje është e shpejtë dhe e dobishme për aq periudhë kohore deri sa të krijohen trotuarët nga Komuna;
- Kerkohet nga lagjet e Prizrenit që të mobilizohen dhe me perfaqësuesin e tyre t’i drejtohen drejtëpërsdrejti Hidroregjionit Jugor dhe t’i paraqesin problemet që kanë me ujën. Një projekt duhet të përfundohet vetëm atëherë kur bashkëpunojnë tri palë: Komuna, përfaqësuesit e lagjes dhe Hidroregjionit Jugor.

Rekomandimet

Duke u nisur nga ajo që secili banor duhet të kenë “të drejtën e tij për qytet” do të thotë të drejtën për të pasur qasje në strehim, infrastrukturë, shërbime dhe mundësi të kontribuimit aktiv në procesin e planifikimin hapësinor dhe urbanistik, rrjedhë se është e drejtë e patjetërsueshme e komunitetit të vendbanimeve joformale të përfshihen në procesin e rregullimit të tyre. Në këtë kuptim, ligjet, programet, politikat dhe praktikët duhet të harmonizohen si dhe të diskutohen publikisht, për të arritur pjesëmarrjen e kënaqshme të banorëve në planifikimin hapësinor dhe urbanistik dhe që të sigurohet legjitimiteti i politikave të menaxhimit urban.

Mënyra e rekomanduar e përmirësimit të gjendjes ekzistuese në lagjen “Arbana” duhet të bazohet në përmirësimin/zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve ekzistuese. Përparësi e kësaj mënyre të trajtimit është se nuk e shqetëson jetën ekonomike dhe sociale të komunitetit. Vlerësohet lartë dhe

është më se e domosdoshme pjesëmarrja e komunitetit në procesin e përmirësimit të vendbanimit, ndërkaq komuna duhet të fokusohet në legalizimin e ndërtimeve pa leje, përmirësimin e kushteve mjedisore, sociale dhe ekonomike përmes rregullimit të infrastrukturës, hapësirave publike, shërbimeve bazike publike si shkollat, transporti publik, menaxhimi i mbeturinave, furnizimi me ujë, telefon etj.

Rregullimi nëpërmjet përmirësimit / zhvillimit

Rregullimi i vendbanimeve joformale nëpërmjet përmirësimit apo zhvillimit karakterizohet përmes një qasje gjithëpërfshirëse, duke theksuar nevojën për intervenime në tri nivelet e vendimmarrjes. Kjo qasje e integruar siguron që komuniteti është dëgjuar në tërësi dhe nevojat e tyre janë konsideruar, ndërkohë që niveli komunal dhe qendror duhet të vëzhgojë dhe analizojë ndikimin në zonë më të gjerë dhe ti monitoroj ndërlidhjet strategjike që mund të paraqiten. Një avantazh kryesorë qëka kjo qasje është se për cdo inkonsistencë, apo mospërputhje në nivelin politik dhe alokimet financiare, identifikohet më herët dhe këto probleme ballafaqohen që në fillim, dhe ky fakt nxit një qasje më strategjike për të gjetur zgjidhje për mjedisin kompleks të informalitetit urban.

Krahas Planit Rregullativ Urban, praktikat e urbanistikës në përmirësimin e vendbanimeve joformale kanë identifikuar një proces të përbërë prej katër hapave deri në arritje të zgjidhjes:

- Procesi duhet të inicohet nga një punëtori gjithëpërfshirëse në mënyrë që të përcaktohet Vizioni i kuartit për këtë zonë.
- Hapi i dytë përfshin inkuadrimin e departamenteve komunale relevante për të promovuar transparencë të plotë të procesit dhe të raportimit të rezultateve.
- Së treti, duhet të krijohet një forum për përfshirjen e vazhdueshme të komunitetit në të gjitha fazat, në mënyrë që të sigurohet pronësia e procesit nga ana e përfituesve, dmth banorët e lagjes.
- Hapi i katërt është llogaridhënia e ekipit profesional dhe komunitetit në kuadër të projektit. Kjo thekson rëndësinë e shkëmbimit të informacionit dhe mbështetjen e njëri-tjetrit për tu përballuar me ndryshimin, si dhe duke bërë rekomandime të politikës qendrore dhe lokale.

Sa më e plotë që është kjo qasje e integruar, aq më shumë do të inkorporohet zhvillimi i infrastrukturës fizike dhe sociale, si komponentë kyce e përmirësimit. Gjithashtu do të bëjë të mundshëm që implikimet financiare për përmirësimin e infrastrukturës të sigurohen nëpërmjet partneritetit me komunitetin, duke pas parasysh që kjo qasje e integruar përpos që ndërton relacione e bën të mundshëm edhe komunikimin.

Buxhetet e vogla të komunave të Kosovës, nuk mund ti përgjigjen në mënyrë adekuate nevojave të ndryshme për financimin e rregullimit dhe përmirësimit të kushteve të jetesës, veçanërisht për vendbanimet joformale, rregullimi i të cilëve kërkon mjete të shumta financiare. Komunitet duhen të gjejnë forma alternative të financimit me anë të:

Inkurajimit të partneriteteve publike private;

- Krijimin e mundësive për participimin e komunitetit në bashkë-financimin e infrastrukturës bazike;
- Shfrytëzimit të fuqisë punëtore nga komuniteti i vendbanimet joformal për zbatimin e projekteve infrastrukturore si dhe rregullimit të shtëpive në vendbanimet joformale;
- Inkurajimi i institucioneve mikrofinanciare për ofrimin e mënyrave për gjenerimin e mjeteve për të ofruar kredi;
- Hulumtuimit të partneriteteve me donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare për të zbatuar mekanizma të reja financiare për të mundësuar përmirësimin e vendbanimet joformale;

- Mobilizim të burimeve financiare nga niveli qeveria qendror i qeverisë dhe nivelit lokal për financim të rregullimit të vendbanimeve joformale.

Regullimi përmes legalizimit

Legalizimi i ndërtesave pa leje nduhet të fillojë menjëherë pas aprovimit të Ligjit në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Legalizimi ka të bëjë me dhënien e mandatit ligjor për banorët e vendbanimeve joformale, e që do të sjellë pasurinë e akumuluar në mënyrë joformale në tregun formal. Ky koncept forcohet edhe më shumë me mundësinë e rritjes së të ardhurave publike përmes vjeljes së tatimit në pronë.

Rëndësia e sigurimit të bartësve të pronësisë është e pamohueshme për shkak të përfitimit që ajo ofron për individët privatë, si dhe ndihmon dhe mbështetë zhvillimin e tregut formal të pronës duke kontribuar kështu edhe në qytetin si tërësi. Në aspekt të planifikimit, nëpërmjet legalizimit do të mundësohet ri-vlersimi dhe kategorizimi i këtyre zonave dhe strukturave ekzistuese në to, si dhe do të krijoheshin mundësitë e zhvillimit nëpërmjet planifikimit të mirëfilltë të qëndrueshëm, gjithmonë duke pas parasyshë kërkesat e komuniteteve.

Infrastruktura urbane dhe sociale

Hulumtimi i vendbanimeve joformale në Kosovë tregon se 155 vendbanime apo 88.91% nuk kanë apo pjesërisht kanë infrastrukturë urbane, njëkohësisht konsiderohet që këto vendbanime janë ndotës direkt të mjedisit. Ndërsa 122 vendbanime përkatësisht 70% janë pa infrastrukturë sociale. Në këtë kontekst komunat në kuadër të programit për rregullimin e vendbanimeve joformale në territorin e vet duhet të ofrojnë infrastrukturë fizike dhe sociale si dhe duhet përmirësuar shërbimet në mënyrë optimale. Në projekt buxhetet komunale për vitet vijuese, për projektet infrastrukturore, për vendbanimet joformale prioritare, duhet të parashihet buxhet i mjaftueshëm që të mundet të konkurojnë për përfitime të donacioneve si fonde shtesë për këtë çështje.

Në kuadër të kësaj pike rekomandimet kryesore, e që janë edhe refleksion i problemeve të qytetarëve, të shprehur nëpërmjet diskutimeve publike janë:

- *Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit* – Të bëhet planifikimi dhe shtrirja e rrjetit të furnizimit me ujë, kanalizimit fekal dhe atij atmosferik, sipas standardeve bashkëkohore, gjithmonë duke u bazuar në numrin e banorëve dhe funksioneve që zhvillohen në zonë, e të cilat dalin nga profili urban i gjendjes ekzistuese të lagjes, por gjithashtu duke i paraparë edhe trendet zhvilluese të lagjes bazual në planin rregullues urban të zonës;
- *Përmirësimi i rrjetit të rrugëve dhe rritja e sigurisë së qytetarëve në komunikacion* – Të bëhet sistemimi i rrugëve në zonë, të kategorizohen në bazë të frekuentimit të qytetarëve. Rrugët duhen të planifikohen në bazë të standardeve bashkëkohore dhe të dimensionohen në bazë të qarkullimit të automjeteve, gjithmonë të kompletuara me infrastrukturën përcjellëse, trotore dhe brezat gjelbërues. Gjithashtu të shikohet mundësia alternative e shfrytëzimit të rrugëve. Në ato rrugë në të cilat nuk ka mundësi zgjerimi, e që cilësohen si kryesore, mund të shfrytëzohen vetëm për automjete, përderisa rrugët tjera sekondare mund të shfrytëzohen vetëm për qarkullimin e banorëve në këmbë apo bicikleta. Pra të mendohet në krijimin e arterieve të cilat do të shfrytëzoheshin vetëm për këmbësorët, dhe këto arterie të lidhin shkollën, qendrën e mjekësisë familjare, fushën e sportit dhe qendrën kulturore në të ardhmën. Rekomandohet gjithashtu në përdorimin e sinjalistikës për rregullimin e komunikacionit. Të bëhet shenjzimi i rrugëve dhe shtëpive.

- *Përmirësimi i sigurisë së banorëve në lagje* – Në kuadër të kësaj pike duhet ti kushtohet rëndësi ndriqimit publik, sidomos në pjesët ku janë të frekuentuara më së shumti nga banorët, dhe ato arterie të cilat lidhin pjesë të lagjeve me funksionet tjera sociale si psh. shkollën, qendrën e mjekësisë familjare, fushën e sportit. Në zonat ku janë rrugët kryesore dhe ku ka qarkullim të madh të trafikut të automjeteve të mendohet në realizimin e barrierave fizike me anë të brezave tëgjelbërimit ku do të bëhet ndarje e kjartë në mes automjeteve dhe këmbësorëve. Rekomandohet gjithashtu në përdorimin e sinjalistikës për rregullimin e komunikacionit.
- *Përmirësimi i infrastrukturës sociale dhe rekreative* – Kërkesë e banorëve është ndërtimi i një qendre kulturore për lagjen. Kjo ndërtesë duhet të jetë multifunktionale, me qëllim të krijimit të hapësirave të nevojshme për aktivitete të ndryshme për grupë moshë të reja dhe të vjetra. Gjithashtu, në mënyrë që ndërtimi i objektit të jetë racional nga aspekti hapësinor dhe financiar, një pjesë e ndërtesës do të duhej të shfrytëzohet edhe si qerdhe/kopsht për fëmijë si funksion i domosdoshëm për lagjen. Në kuadër të kësaj qendre të parashihen edhe fusha të sportit, të cilat do të mirëmbaheshin më mirë nga menaxhmenti i ndërtesës.

IX. Mjedisi dhe planifikimi urban në Prizren

Trashëgimia natyrore

Shkruar nga, Dukagjin Bakija

Përmbledhje ekzekutive

Qëllimi i këtij dokumenti është të mbështesë një integrim më të efektshëm të çështjeve mjedisore dhe shqetësimet në planifikimin hapësinor dhe proceset e zhvillimit në administratën nivelit lokal. Përveç kësaj, ky veprim ka objektiva të tjera shtesë, duke përfshirë rritjen e vetëdijes për rëndësinë e përfshirjes së 'mjedisit' në çështjet urbane, si dhe mbështetje për adaptim dhe zbutje të gjithnjë në ndryshimi të kushteve mjedisore.

Arsyeja themelore pse integrimi mjedisor është kaq i rëndësishëm është i bazuar në arsyetimin se zhvillimi ekonomik dhe social dhe mjedisi janë rrënjësisht të ndërvarura. Në përgjithësi, mënyra se si ne menaxhojmë ekonominë dhe institucionet politike dhe sociale ka ndikime kritike në mjedis. Ndërsa, cilësia e mjedisit dhe qëndrueshmëria, nga ana tjetër, janë jetike për ecurinë e ekonomisë dhe mirëqenies sociale. Si e tillë, detyra e integritit mjedisor është në ballë të zhvillimit të planifikimit dhe formulimit të politikave.³⁶

Ky raport është i bazuar në informatat e mbledhura nga hulumtimet e të dhënave kompjuterike, rezultatet e anketës, analizime dhe katër punëtori (mbajtur më 15 mars 2013, 3 Maj 2013, 13 qershor 2013, 25 korrik 2013 dhe 31 tetor 2013) që u ndoq nga aktorët kryesorë nga pushteti lokal dhe qendror, sektori privat dhe vullnetar. Si në përmbledhje, ajo mund të vihet në dukje se kohët e fundit është një kërkesë margjinale të inkorporojnë integrimin e mjedisit në zhvillimet e politikave dhe vendim-marrjes! Nga ana tjetër, sfidat mjedisore vazhdojnë të rriten në norma konstante, parashikimet janë që në një të ardhme shumë e afërt – problemet mjedisore do të bëhen të patolerueshme dhe të paraqesin një pengesë të madhe për zhvillimet.

Për më tepër, gjendja e mjedisit është diskutuar që ka disa probleme që duhen adresuar. Këtë çështje më tej janë të grupuar në katër kategoritë e mëposhtme: menaxhimin e mbeturinave, rrjedhat e lumenjve, zona të gjelbëruara publike dhe cilësia e ajrit. Është vërejtur se degradimi i mjedisit në rritje të vazhdueshme ka qenë e njohur në të gjithë komunën e Prizrenit dhe ka prirje të rritet me zgjerimin e mirëqenies sociale të banorëve. Njohja është bërë për vazhdimin e përpjekjeve për të në zbutur rrezikun mjedisor; megjithëse një inkurajim i fortë është bërë për të gjitha palët e përfshira që të bashkojnë përpjekjet dhe të punojnë me komunitetin lokal në gjetjen e zgjidhjeve më efikase.

Autoritetet lokale dhe akterët të tjerë që e sjellin vendime në baza ditore duhet të japin një konsideratë të fuqishme për çështjet mjedisore që ata trajtojnë. Në këtë drejtim, konsideratat mjedisore nuk duhet të jenë përgjegjësi e vetme e udhëzimeve, në vend të kësaj, të gjithë individët relevantë dhe sektorët duhet të bashkëpunojnë dhe të përpiqen shumë me shumë - ku rezultatet do të bëhen të dukshme. Me fjalë të tjera, çështjet e mjedisit duhet të kuptohen dhe duhet reaguuar ndaj tyre 'vendim-marrësit dhe jo vetëm nga 'sektor' mjedisore'. Por, në mënyrë që të përmirësojë të kuptuarit, akterët e mjedisit, nga ana tjetër, duhet të kuptojnë konsideratat e zhvillimit.

³⁶ B. Dalal-Clayton, S. Bass (2009). Experience of integrating environment into development institutions and decisions. International Institute for Environment and Development (IIED)

Historiku

OJQ EC Ma Ndryshe është mbështetur nga Qendra Ndërkombëtare Olof Palme për të zhvilluar një studim mbi planifikimin përfshirës për zhvillimin e qëndrueshëm në Prizren. Dokumenti i mëposhtëm është një rezultat i studimit me të dhëna të nxjerra nga kompjuteri; analizat fushore dhe diskutimet e mbajtura me akterët kyç në fushën e mjedisit. Qëllimi i studimit është të forcojnë përfshirjen e çështjeve mjedisore dhe shqetësimet në mënyrë më efektive në planifikimin komunal dhe proceset e zhvillimit. Siç thuhet në Vlerësimin e Ekosistemit të Mijëvjeçarit³⁷, *kur sistemet urbane menaxhohen në mënyrë më të barabartë dhe humbja e shërbimeve të ekosistemit është adresuar qëllimisht, ...përfitimet për mirëqenien njerëzore mund të jenë thelbësore* - ky aktivitet kontribuon në këtë proces.

Çfarë është integrimi mjedisor!

Ka mjaft përkufizime të integritimit mjedisor, edhe pse në përgjithësi mesazhi kryesor është shprehur se me avancimin e mjedisit është menduar që projektuesit e politikave duhet të gjejnë mënyra për të përfshirë interesat mjedisore në zhvillimet e niveleve të ndryshme. Në vijim janë paraqitur citate nga institucionet kryesore që merren me politikën e mjedisit:

Integrimi mjedisor është:

*"Përfshirja e informuar e shqetësimeve përkatëse **mjedisore** në vendimet dhe institucionet që drejtojnë politikën, rregullat, planet, investimet dhe veprimet kombëtare, sektoriale dhe lokale".*
[Instituti Ndërkombëtar për Mjedisin dhe Zhvillimin, 2009]

*"Procesin Përsëritës I **integritit të varfërisë mjedisorene krijimin e politikave**, buxhetimin dhe procesin e implementimit në nivele kombëtare, sektoriale dhe nënkombëtare."*
[Iniciativa Varfëria- Mjedisore Kombeve të Bashkuara (UNPEI) 2009]

Përkufizime të tjera thonë:

*Për të arritur **zhvillim të qëndrueshëm, mbrojtja e mjedisit** do të përbëjë një **pjesë integrale** të procesit të zhvillimit dhe nuk mund të konsiderohet e izoluar nga ajo.*
[Parimi 4, Deklarata e Rios për Mjedisin dhe Zhvillimin, 1992]

*Çrrënjosja e varfërisë, duke ndryshuar modelet e paqëndrueshme të prodhimit dhe konsumit, dhe në **mbrojtjen dhe menaxhimin e bazës së burimeve natyrore** të zhvillimit ekonomik dhe social është gjithëpërfshirja e objektivave të, dhe kërkesat thelbësore për **zhvillim të qëndrueshëm**.*
[Paragrafi 2, WSSD Plani i Zbatimit, 2002]

Arsyeja kryesore për integrimin e mjedisit është i bazuar në argumentin se mjedisi është një nga tri shtyllat³⁸ e zhvillimit të qëndrueshëm dhe është veçanërisht e rëndësishme për pjesën e popullsisë me të ardhura të ulëta, të cilët janë më të prekshëm në degradimin e burimeve natyrore, ndotjes ekologjike dhe fatkeqësive.

Për më tepër, një pjesë e madhe e pasurisë së Kosovës dhe një pjesë të varfër të popullsisë është i përbërë nga asetet mjedisore. Këtosigurojnë themelet për zhvillim të qëndrueshëm. Tokat pjellore, uji i

³⁷ UNEP, Millenium Ecosystem Assessment, <http://www.unep.org/maweb/en/index.aspx> (shikuar më 09/11/13)

³⁸ Tri dimensionet e zhvillimit të qëndrueshëm (mjedisor, ekonomik dhe social) njihen si 'shtyllat' e zhvillimit të qëndrueshëm. Këto shtylla janë të ndryshme por afërsisht të lidhura. Kjo nënkupton se shtylla mjedisore ka lidhje cilat duhet të zhvillohen!

pastër, biomasa dhe biodiversiteti prodhojnë një varg të mallrave dhe shërbimeve që sjellin te ardhura, ruajnë shëndetin publik dhe rritjen e fuqisë ekonomike. Në anën tjetër, keqmenaxhimi i aseteve mjedisore, kontrolli i dobët i rreziqeve mjedisore të tilla si ndotja dhe përgjigjja e papërshtatshëm ndaj sfidave mjedisore të tilla si ndryshimi i klimës, kërcënojnë zhvillimin.

Në këtë drejtim, zhvillimi dhe mbrojtja e mjedisit janë reciprokisht të varura. Integriteti dhe diversiteti i natyrës, shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore janë themelet e ekzistencës së njeriut, zhvillimin social dhe aktiviteteve ekonomike, jo vetëm sot, por edhe për gjeneratat e ardhshme. Lidhjet midis mjedisit, burimeve natyrore, zhvillimi dhe siguria njerëzore janë kuptuar mirë, por shpesh nuk praktikohet. Lidhjet janë të kuptuara me qarte nga pjesa e shoqërisë me të ardhura me të ulëta - si zonat më të privuara ekonomikisht dhe të paqëndrueshme në aspektin social gjithashtu prirjen të jenë më të degraduara ekologjikisht.³⁹

Në përfundim të këtij kapitulli vlen të përmendet se qëllimi i përgjithshëm i zhvillimit të qëndrueshëm mund të arrihet vetëm nëse aktivitetet ekonomike dhe zhvillimet institucionale dhe sociale respektojnë dhe shërbejnë për të mbrojtur integritetin dhe diversitetin e natyrës dhe të sigurojë që përdorimi i burimeve natyrore është i barabartë dhe ekologjikisht i qëndrueshëm.

Situata aktuale

Gjendja e mjedisit në Komunën e Prizrenit po debatohet gjithnjë e më shumë me nivele të ndryshme të qeverisjes dhe në mesin e akterëve të ndryshëm. Megjithëse, një gjë është e sigurtë dhe si e tillë, ka një kërkesë margjinale për të avancuar integritimin e mjedisit në zhvillimet e politikave dhe marrjen e vendimeve! Ndërsa, sfidat mjedisore vazhdojnë të rriten me ritëm të qëndrueshëm, parashikimet janë që në një të ardhme shumë të afërt - problemet e mjedisit do të bëhen të patolerueshme dhe do të paraqesin një pengesë të madhe për zhvillim⁴⁰.

Në vijim, ky dokument shpreh çështjet kyçe mjedisore nxjerrë nga shqyrtimi i dokumenteve përkatëse (PZHK, PZHU, PLVM), dhe nga komentet e bëra gjatë debateve nga palët e interesuara:

Duhet të theksohet se bazuar në aferën fatkeqe dhe ndërprerjen e aktiviteteve industriale në periudhën e pasluftës, mjedisi është mbajtur 'i padëmtuar'. Është besuar, se në çdo situatë tjetër - degradimi i mjedisit do të kishte qenë enorm! Megjithatë, degradimi i mjedisit ka arritur në shifra alarmante me nxjerrjen e paligjshme dhe të pakontrolluar të zhavorrit e të mbeturinave dhe sasi e kontaminuar të përziera (kryesisht mbeturinave shtëpiake) në bazenet e lumenjve të Drini I Bardhë, Toplluhë, Deshticë dhe Lumëbardh.

Trajtimi i ujërave të zeza në zonën e Prizrenit është një shqetësim i madh, siç është theksuar se një sasi e konsiderueshme e ujërave të zeza derdhen në këto lumenj dhe në disa pjesë direkt në hapësirë të hapur, pa distilim. Ka ende disa zona pa një sistem të duhur të kanalizimeve publike. Një ane e ndritshme është se kompania lokale e ujit është duke planifikuar përmirësimet e pjesëshme të sistemit dhe vendosjen e elementeve të infrastrukturës përkatëse.

³⁹UNDP Environmental Mainstreaming Strategy (2004). UNDP Environmental Operations and Policy Advisor

⁴⁰Strategic Environmental Assessment (SEA) Report for Prizren MDP. UN-Habitat 2012

Përveç kësaj, zona të reja të tokës erozive janë raportuar në vazhdimësi që rezultojnë nga prerja ilegale dhe / apo e pakontrolluar të drurit e të pyjeve, dhe / ose ndërtimeve të paplanifikuara e të paligjshme dhe abuzimin e tokës bujqësore.

Ajri është duke u degraduar⁴¹ kryesisht nëpërmjet përdorimit të lëndëve djegëse alternative në prodhimin e energjisë elektrike, trafikun e mbingarkuar në zonën e qytetit dhe deponive ilegale të mbeturinave. Ndërsa uji po ndotet dhe është i kontaminuar në nivelin mbitokësor dhe nëntokësor. Përgjatë keqpërdorimit të burimeve të ujit vazhdohet me nxjerrjen e tepruar të rërës dhe zhavorrit në lumë, e cila shkakton efekte të rënda negative mjedisore dhe degradimin e lumenjve.

Në përmbledhje, rritja e vazhdueshme e degradimi të mjedisit është e vërejtur në të gjithë komunën e Prizrenit dhe ky fenomen do të rritet me rritjen e mirëqenies sociale të banorëve. Njohja është bërë për përpjekjet e vazhdueshme për të zvogëluar rrezikun mjedisor; megjithëse një inkurajim i fortë është bërë për të gjitha palët e përfshira që të bashkojnë përpjekjet dhe të punojnë me komunitetin lokal në gjetjen e zgjidhjeve më efikase.

Të gjeturat

Grupeve të ndryshme të palëve të interesuara janë takuar dhe kanë diskutuar në datat në vijim: 15 mars 2013, 3 maj 2013, 13 qershor 2013 25 korrik 2013 dhe 31 tetor 2013. Zyrtari i autoritet lokal të Prizrenit dhe palët tjera relevante kanë marrë pjesë në takime. Më poshtë janë paraqitur temat që kanë prezantuar sfidat, problemet dhe prioritetet e paraqitura gjatë këtyre takimeve.

Parametrat mjedisore janë diskutuar të kenë probleme të shumta që duhet adresuar. Është e kuptueshme që Komuna e Prizrenit ka një plan për administrimin e mbetjeve, por zbatimi nuk arrin të përmbushë pritjet!

Menaxhimi i mbeturinave

Në veçanti, është vërejtur dështimi i autoriteteve lokale për të përfshirë fshatrat rreth zonës Zhup për t'u përfshirë në praktikën e menaxhimit të mbeturinave. Mbeturinat përbëjnë një kërcënim shumë serioz për mjedisin dhe të gjithë sektorëve të tjerë. Ka shqetësime se deponia Landovica mund të jetë shkak kryesor dhe potencial për përhapjen e infeksioneve! Prizrenit po ashtu i mungon një vend që trajton mbetjet organike (të tilla si mishi dhe kockat të kafshëve) që shkaktojnë kundërmim ekstrem. Aktualisht, ato hidhen poshtë në lokacionin 'Guri kuq' dhe të përzihen me mbeturina të tjera inerte (të tilla si mbetjet e ndërtimit).

Në këtë drejtim, edhe pse vendi i caktuar zyrtar për mbetjet e ndërtimit është i vendosur të jetë deponia te 'Guri kuq', është e zakonshme që mbeturinat të hidhen në çdo vend boshe, pothuajse çdo fushë të gjelbër, fushat kafe dhe përgjatë shtretërve të lumenjve. Përveç kësaj ekzistojnë shqetësime se me keqpërdorimin e deponisë 'Guri Kuq', mjedisi përreth është duke u ndotur në masë të madhe.

Në një farë mënyre, mbeturinat e hedhura po dalin përsëri në lumin Lumbardhë, pasi barten përmes erërave të forta dhe shiut. Në mënyrë të përsëritur, degradimi krijohet edhe nga mjetet transportuese, që së pari hyjnë në deponi dhe pastaj pa u pastruar fare të njëjtë automjete lëvizin përmes pjesëve të ndjeshme të qytetit.

⁴¹Local Environmental Action Plan (2011). Prizren Municipality

Çfarë është duke ndihmuar vazhdimin e degradimit të mjedisit janë ndërtimet e paligjshme dhe të paplanifikuara që vazhdojnë të shfaqen kudo si dhe ndikojnë vazhdimisht në gjendjen e mjedisit me mbetjet e materialeve të ndërtimit. Zërat shqetësuese janë ngritur mbi ndërtime ilegale dhe / apo te paplanifikuara që vazhdimisht ndodhin në të gjitha pjesët e qyteteve - por me ndikim të rëndë në qendrën e qytetit.

Rrjedhat e lumenjve

Degradimi i lumit Lumbardhe është shumë shqetësues dhe pati thirrje për rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit dhe përpjekjet e përbashkëta për të sjellë lumin në lavdinë e mëparshme. Është vërejtur se Komuna e Prizrenit nuk i kanë vendosur ende kufijtë e lumit për të bërë të mundur definimin mes pronësisë private dhe publike, dhe me ketëminimizojnë potencialin e zhvillimit. Në veçanti, hapësira publike është duke u përdorur për qëllime private, të cilat kufizojnë qasjen e publikut. Në lidhje me këtë, mbrojtja e burimeve ujore bëhet problematike dhe keqpërdorimi i ujit, zhavorrit dhe burimeve të tjera natyrore është proces i pandalshëm.

Është vërejtur se është përgjegjësi e çdo familje që ka mbyllur lidhjet fizike me lumin Lumbardhe, duhet për t'u kujdesur dhe jo të hedhin mbeturinat e tyre në lumë. Zgjidhjet janë hulumtuar për të zhvilluar një fabrikë filtrimi përgjatë çdo fshati në zonën Zhub. Ky veprim se bashku me zbatimin rigoroz teplanit të menaxhimit të mbeturinave do të sjellë dobi për mjedisin.

Sipërfaqet publike të gjelbëruara

Në përgjithësi, ekziston një nevojë e madhe për të bërë hapësira të gjelbra për zonat e komunitetit brenda lagjeve të ndryshme. Ndërtesa të larta që shfaqen kudo nuk po sigurojnë hapësira publike. Kjo çështje duhet të adresohet seriozisht dhe zyrtarët lokalë duhet të veprojnë para se te jete vonë! Ka pasur shqetësime për mirëmbajtjen e parkut të qytetit ekzistues, dhe thirrje të forta për përmirësime në pastrim dhe kujdes. Si dhe nevoja për të shtuar në park mobilje të tilla si zona të uljes dhe të përmirësojë sigurinë me ndriçim të shtuar.

Menaxhimi mjedisor duhet të jetë një pjesë integrale e programit arsimor për të siguruar që brezat e ardhshëm janë më mirë të informuar dhe të aftë për mbajtjen e burimeve natyrore. Me interes të madh të pjesëmarrësve ishte diskutimi mbi zonën e përkeqësuar të malit në Prevall. Brengat kryesore reflektuan nevojën për të vepruar dhe për të ndaluar ndërtimin e paligjshëm përdorimin e materialit jo të qëndrueshëm për ndërtime dhe deponimin e mbeturinave.

Cilësia e ajrit

Edhe pse nuk ka masa zyrtare dhe statistika të variacioneve të cilësisë së ajrit, pjesëmarrësit e seminarit ndjenë fuqimisht se cilësia e ajrit është duke u degraduar vazhdimisht për shkak të zakoneve të paqëndrueshme të jetesës. Nga përdorimi i tepruar i transportit personal (automjetet), përdorimi i karburantit për ngrohje dhe biznesi i transportit ka nevojë për tu mbështetur në kamionë të mëdhenj - të gjitha zonat urbane janë të prekura dhe në veçanti qendra historike e qytetit.

Në këtë drejtim, është rekomanduar që të ketë një ndalim të plotë i qasjes së automjeteve të motorizuara neper qendrën e qytetit, si dhe si qasje selektive të rreptë ndaj automjeteve të mëdha që kalojnë nëpër zona urbane. Duhet vënë në dukje se diskutimet e akterëve kryesorë gjatë gjithë punëtorive të mbajtura përqendruan diskutimin e tyre mbi problemet themelore mjedisore që duhet adresuar, ndërsa ata flisnin pak për çështjet që pengojnë integrimin e mjedisit në vendimmarrjen lokale, kështu, tabela e mëposhtme është bazuar nga diskutimet me ambientalistët kyç dhe bërësit e politikave marrësit dhe gjetjet kërkimore nga të dhënat kompjuterike.

Kufizimet kryesore për integrimin e çështjeve mjedisore në vendimet e zhvillimit, dhe si në anketat e vendeve të IIED janë:

- *Modeli dominues i zhvillimit, e cila trajton mjedisin si një 'e jashtme' institucionale dhe ekonomike*
- *Mungesa e të kuptuarit, të dhënave / informacioni, aftësitë dhe kapaciteti institucional për të punuar në linçe të zhvillimit mjedisor*
- *Iniciativat e dobëta mjedisore të përgjithshme në datën për të vepruar si një precedent*
- *Mungesa e vizionit të zhvillimit dhe vullneti politik për ndryshime*
- *Korrupsioni*
- *Mungesa e kapaciteteve absorbuese për burimet e disponueshme financiare (financimi ndërkombëtar si BE, SHBA, dhe agjenci të tjera të zhvillimit)*
- *Fragmentimi i përgjegjësisë mjedisore*
- *Pengesat për angazhimin e shoqërisë civile*

Në përfundim të këtij kapitulli janë theksuar nevojat dhe rekomandimet nga të gjitha seminarët:

- Së pari dhe më kryesorja, politikat zhvillimore komunale duhet të përpiqen për të balancuar investimet në mes të zonave urbane dhe rurale në kërkimin për të balancuar zhvillimet,
- Burimet e ujit tokësore janë një burim i paçmuar i furnizimit me ujë për publikun, industrinë, bujqësinë dhe gjithashtu kryejnë një rol të rëndësishëm në mbështetjen e rrjedhjes së lumenjve. Duhet të theksojmë se ekziston një nevojë urgjente për të adresuar çështjen e ndotjes së lumit,
- Ekziston nevoja për të vepruar menjëherë në adoptimin e praktikave të qëndrueshme e klasifikimin e mbeturinave shtëpiake, për shembull, kazanë të veçanta për plastike, metal dhe mbeturina të përgjithshme,
- Vendi potencialmë i mirë për ndërtimin e një pike grumbullimi dhe trajtimit të ujërave të zeza është rajoni i Vlashnjës,
- Autoritetet lokale duhet të imponojë dënime financiare për individ apo biznes që degradojnë mjedisin dhe / ose hedhin mbeturinat në mënyrë papërgjegjshme,
- Ekziston nevoja për të rritur numrin dhe vendndodhjen e kazanëve publike, sidomos në rrugët kryesore urbane,
- Nevoja për të eksploruar mbi mënyrat për të zhvilluar një fabrikë filtrimi përgjatë çdo fshati në zonën e Zhubit,
- Menaxhimi mjedisor duhet të jetë një pjesë integrale e programit arsimor për të siguruar që brezat e ardhshëm janë më mirë të informuar dhe të aftë për mbajtjen e burimeve natyrore,
- Ndalimi gjithëpërfshirës mbi qasjen e automjeteve të motorizuaranëqendër të qytetit, si dhe qasjen të rreptë selektive ndaj automjeteve të mëdha që kanë nevojë për qasje përmes zonës urbane,
- Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal të Prizrenit, Planit Zhvillimor Urban, Planit të Menaxhimit të Mbetjeve, Planit të Veprimit për Mjedisin dhe çdo dokument tjetër strategjik ka nevojë të pasohet nga një procedurë e zbatimit të rreptë, kjo do të ndihmojë përmirësimin e mjedisit të gjithë zonën përreth.

Rekomandimet

Një sfond historik i komplikuar dhe një periudhë e gjatë kohore, pa aktivitete të duhura të planifikimit strategjik hapësor kanë shkaktuar (zhvillimet e zgjerimit të vendbanimeve, industri të reja, etj) për të dukur mjaft e rastësishme. Një balancë të duhur në mes të zonave kryesore të përdorimit të tokës është thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të Prizrenit. Ekziston nevoja për të kanalizuar zonat ekonomike

në mënyrë që ato nuk do të kërcënojnë zonat bujqësore dhe natyrore të vlefshme. Si qytet Prizren vepron si një qendër tërheqëse urbane, masat adekuate për të zbutur ndikimet e mundshme negative të urbanizimit të shpejtë dhe degradimit të tokës në zonat rurale. Duhet të vendoset një rrjet adekuat vendbanimesh dhe struktura me shërbimin e nevojshëm publik.

Në divergjenca, në disa vende (për shembull në Republikën Çeke), ka një kërkesë të fortë për të forcuar integrimin mjedisor në planifikim dhe vendim-marrje, ndërsa në Kosovë, kuptimi 'tradicional' është se *"për tu kujdesur për mjedisin është një detyrë për autoritetet mjedisore, e cila është reflektuar pastaj në praktikën e shumicën se institucioneve"*. Edhe pse është në fokus të fortë të pushtetit në nivel lokal dhe qendror për zhvillimin e dokumenteve të ndryshme të planifikimit strategjik, por duke prodhuar vetëm një plan të mirë nuk është garanci për sukses! Siç vihet re në doracakun e Integritimit Mjedisor (2007):

"Edhe Plani më i mirë ndonjëherë", që i integron në mënyrë perfekte të gjitha çështjet relevante mjedisore nuk do të thotë se ndryshimet reale automatikisht do të ndiqen në teren apo sektor, nëse nuk mbështetet nga përfaqësuesit politikë dhe liderët⁴². Përveç kësaj, Qendra Miqësore Daneze arriti në përfundimin se "Integrimi Mjedisor nuk duhet vetëm të jetë shqetësimi i ministrive të mjedisit apo departamenteve, ajo ka të bëjë me të gjithë sektorët, privat dhe publik, dhe secili ka një rol për të luajtur".

Vlera e shtuar e përfshirjes së mjedisit në planifikimin hapësinor / urban dhe proceset e zhvillimit rrjedh nga perspektiva e konsideruar në procesin e jo si një qëllim në vetvete, por si një mjet për të sjellë vlerë të shtuar, në mënyrat e mëposhtme:

- Bashkë-menaxhimi i mjedisit duke i përfshirë të gjitha palët e interesuara do të thotë bashkëpunim paqësor-paqja dhe siguria do të forcohet me shumë.
- Rreziku i katastrofave mjedisore dhe sociale të shkaktuara nga krizat degradimit mjedisor do të zbutet.
- Nevoja për ndihma emergjente do të reduktohet, si dhe kostot sociale, ekonomike dhe financiare do të ruhen nga veprim parandalues.
- Adresimi i aspekteve mjedisore do të përmirësojë efikasitetin dhe efektivitetin e përpjekjeve të reduktimit të varfërisë
- Zgjidhjet e balancuara dhe fitues-fitues mund të gjenden në mes të shqetësimeve të ndryshme, përfshirë globale dhe lokale, ekonomike, sociale dhe mjedisore, materiale dhe kulturore.
- Ndërgjegjësimin mjedisor dhe ngritja e kapaciteteve për menaxhimin mjedisor mund të kenë një potencial të jashtëzakonshëm të fuqizimit për të varfëritë, për gratë, për popullsinë vendëse dhe për të gjithë qytetarët në përgjithësi në atë që ata nxisin një kulturë të përbashkët demokracisë, pjesëmarrjes dhe të drejtat vetëdijes.⁴³

Integrimi Mjedisor është, pra, një përpjekje ndryshimi afat-gjatë shoqërore dhe institucional që përfshin bashkimin e një serie të re të sistemeve dhe një sërë vlerash shoqërore, rregulla, norma, procedura dhe mjete tjera që punojnë për kontekste të caktuara - sfidë e qeverisjes. Kjo sfidë përfshin vlerat, besimet dhe kornizat vendimmarrëse që nuk janë të lehta për t'u marrë me to përveç nëse drejtimi i 'Integritimit' është i përcaktuar qartë si qasje e zhvillimit institucional.

Më pas, kur është fjala për integrimin e mjedisit, Prizreni është në nevojë për udhëheqje të vërtete dhe mveshje të kujdesshme me kontekstin lokal institucional. Nga të cilat, qëllimisht është ndryshuar

⁴²Environmental Integration Handbook, 2007

⁴³Environmental Integration Handbook, 2007

mënyra se si institucionet dhe njerëzit e shohin mjedisin dhe prandaj sillen –si diçka që mund t'i qasen, për shembull, nëpërmjet edukimit mjedisor. Për më tepër, integrimi mjedisor duhet arritur në një varg të peshores në raport me kohën, të ndikimit gjeografik, akterët / institucionet e përfshira dhe më e rëndësishmja të ketë/ofrojë konsideratë financiare të kujdesshme.

Mjedisi gjithashtu duhet të konsiderohet në nivele lokale, ku organizatat lokale dhe individët të marrin vendime të përditshme në lidhje me mënyrën që ata përdorin dhe për të menaxhuar asetet mjedisore. Kështu, konsideratat mjedisore duhet të adresohen si në nivelin qendror (p.sh. planifikimi në nivel qendror dhe ministritë e financave) dhe nivelet sektoriale (p.sh., qeveria, organizatat e biznesit dhe akterëve përgjegjëse për bujqësi, industri, etj), me fjalë të tjera, ata duhet të jenë kuptuar dhe të përgjigjen nga vendimmarrësit tipike dhe jo vetëm nga 'sektori' i vetë mjedisit. Por, në mënyrë që të përmirësojë të kuptuarit, akterët e mjedisit, nga ana tjetër, duhet të kuptojnë konsideratat e zhvillimit.

X. Kultura dhe planifikimi urban në Prizren

Trashëgimia kulturore

Shkruar nga, Hajrulla Çeku

Përmbledhje ekzekutive

Ekziston një nevojë imediate për ridefinimin e rolit të kulturës në politika publike në përgjithësi, e në planifikim urban në veçanti. Në anën tjetër, planifikimi urban nuk guxon të mbetet një aktivitet thjesht fizik e teknik, por duhet ta ketë të integruar dimensionin njerëzor. Sot flitet për “kthesën kulturore” të planifikimit urban, ndërsa avokuesit argumentojnë se, sado të rëndësishëm që janë, planerët urban duhet të zgjerojnë agjendën dhe qasjen e tyre. Qytetet dhe jeta në qytete nuk ka të bëjë vetëm me dizajnimin e hapësirës fizike, pasi që njerëzit e zhvillojnë jetën e tyre pikërisht brenda këtyre hapësirave, jo rrallë në mospërputhje me qëllimet origjinale të planerëve. Planifikimi urban duhet të përfshijë një koncept shumë më të gjerë social e kulturor, sesa vetëm vizatimi i vijave me ngjyra të ndryshme mbi një copë letër.

Planifikimi hapësinor (dhe urban) është ndër mangësitë themelore të dy nivele të qeverisjes, ndërsa ky sektor pothuaj nuk ka komunikim institucional me atë të trashëgimisë kulturore. Njëra nga pasojat më të dhimbshme të këtij procesi ishte ndërtimi i pakontrolluar në zonat që gëzojnë statusin e qendrave historike. Qytetet e vjetra të Prishtinës, Prizrenit dhe Gjakovës janë ndër më të prekurat, ndërsa këtij fati nuk i kanë shpëtuar as qytetet e tjera të Kosovës.

Institucionet e shtetit, në të dyja nivelet e qeverisjes, as sot nuk e kanë krijuar sistemin e koordinimit mes dy sferave të politikave publike, planifikimit hapësinor (dhe urban) dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Kosova (rrjedhimisht edhe Prizreni) ende nuk ka zhvilluar qasje të integruar të planifikimit dhe zhvillimit të politikave. Në rastin konkret, politika e konservimit të integruar paraqet domosdoshmërinë për koordinim institucional për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

Bazuar në të gjeturat e projektit si dhe dokumenteve dhe analizave ekzistuese në fushën e kulturës (trashëgimisë kulturore) dhe planifikimit urban, në vijim janë rekomandimet e raportit:

- Ridefinimi i rolit të kulturës dhe rritja e komunikimit me sferat e tjera të politikave publike,
- Respektimi i përpiktë i pëlqimeve të lëshuara nga QRTK nga autoritetet lokale të Prizrenit dhe ndërtuesit,
- Hartimi i planit lokal të trashëgimisë kulturore për koordinim më të mirë ndër-sektoral bazuar në parimet e konservimit të integruar (sidomos me planifikimin urban),
- Koordinimi efektiv mes drejtorive për urbanizëm dhe inspektorat në parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe tejkalimeve të tjera,
- Rritja e koordinimit inspektorat – urbanizëm – QRTK në shërbim të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore,
- Rrënimi i ndërtimeve pa leje në Qendrën Historike të Prizrenit për të parandaluar zhdukjen totale të trashëgimisë kulturore,
- Përfshirja e trashëgimisë kulturore në hartimin e planeve urbane të Prizrenit,
- Hartimi i strategjisë për turizëm kulturor përmes koordinimit mes shumë sektorëve të politikave lokale,
- Buxhetimi me pjesëmarrje në sektorin e kulturës për definimin të buxhetit komunal, Fokus më i madh në përmbajtje kulturore (aktivitete) se sa në infrastrukturë,

- Respektimi i të gjitha ligjeve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Prizrenit për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të Prizrenit,
- Krijimi i një mentaliteti të ri ku trashëgimia kulturore të jetë pjesë e kurikulës shkollore dhe të mësuarit për trashëgiminë kulturore do të fillojë në shkollën fillore,
- Përcaktimi i kritereve për ndarjen e granteve për kulturën e pavarur.

Hyrje

Kultura nuk është një sektor i veçantë i politikave, por pjesë integrale e planifikimit zhvillimor, e në këtë kuadër edhe e planifikimit urban. "Artet dhe burimet kulturore në përgjithësi po shndërrohen në asete strategjike të planifikimit dhe zhvillimit urban, duke luajtur rol qenësor në zhvillimin e ekonomisë së re."⁴⁴ Raporti i UN Habitat "State of the World's Cities Report" i vitit 2004 ka dokumentuar trendin në rritje të ribrendimit të qyteteve si parajsa kulturore, që sipas raportit paraqet një "përpjekje kreative nga shumë qeveri lokale për t'i zhvilluar ekonomitë që kanë nevojë për mekanizma ringjallëse urbane".⁴⁵ Raporti gjithashtu konstaton se "mbi supozimin që kultura mund të jetë motor i gjenerimit të punësimit, qeveritë janë duke i orientuar investimet kah industrinë dhe distriktet kulturore, përfshi hapësirat publike, komoditetet kulturore të së cilës kanë prirje të harmonizojnë interesat e ndryshme shoqërore dhe të ngrisin cilësinë e jetesës urbane".⁴⁶

Koncepti i zhvillimit me fokus vetëm në ekonominë ishte i pamjaftueshëm për të trajtuar në mënyrë adekuate sfidat zhvillimore të fundshekullit 20. Si rezultat, në vitet e 80-a artikullohet koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm, me promovimin e trekëndëshit ekonomi – shoqëri – mjedis. Megjithatë, u deshën më pak se dy dekada që të sfidohej edhe trekëndëshi. Rrjedhimisht, sot flitet për kulturën si shtyllën e katërt të zhvillimit të qëndrueshëm. Dhe atë, jo vetëm si një dimension të zhvillimit, por si përbërës të barabartë të procesit, krahas ekonomisë, shoqërisë dhe mjedisit.⁴⁷

Mësimi që shtetet e zhvilluara të botës kanë nxjerrë nga procesi zhvillimor është se niveli më i përshtatshëm është ai i qytetit (niveli lokal i zhvillimit). Ndërsa, ndër shembujt më të suksesshëm të zhvillimit lokal (të qyteteve) pa dyshim se janë ato të bazuara në kulturë. Konferenca e Kombeve të Bashkuara mbi Tregtinë dhe Zhvillimin (UNCTAD) ka raportuar se produktet dhe shërbimet kulturore përbëjnë një pjesë gjithnjë në rritje të tregtisë ndërkombëtare dhe BPV-së dhe se në një numër të caktuar shtetesh shkalla e rritjes së tyre është më e madhe se e pjesës tjetër të ekonomisë.⁴⁸ Pjesa më e madhe e kësaj ekonomie është e koncentruar në qytete: në disa nga qytetet e mëdha botërore, sektori kulturor dhe kreativ është sektori i dytë ose i tretë më i madh i ekonomisë.⁴⁹

⁴⁴ Colin Mercer, Cultural planning for urban development and creative cities, 2006, në http://burgosciudad21.org/adftp/Shanghai_cultural_planning_paper.pdf

⁴⁵ UN Habitat, State of the World's Cities Report, 2004, në <http://www.unhabitat.org/pmss/listItemDetails.aspx?publicationID=1163>

⁴⁶ Po aty

⁴⁷ European Cultural Foundation, Local Cultural Policies Handbook, 2012, në http://www.culturalfoundation.eu/sites/www.culturalfoundation.eu/files/local_cultural_policies_handbook_eng_2011.pdf

⁴⁸ UNCTAD and UNDP, Creative Economy Report 2010, në http://unctad.org/en/docs/ditctab20103_en.pdf

⁴⁹ World Cities Culture Report 2012, në <http://www.worldcitiesculturereport.com/sites/all/themes/wccr/assets/pdfs/WorldCitiesCultureReport-lowres.pdf>

Planifikimi urban nuk guxon të mbetet një aktivitet thjesht fizik e teknik, por duhet ta ketë të integruar dimensionin njerëzor. Sot flitet për “kthesën kulturore” të planifikimit urban, ndërsa avokuesit argumentojnë se, sado të rëndësishëm që janë, planerët urban duhet të zgjerojnë agjendën dhe qasjen e tyre. Qytetet dhe jeta në qytete nuk ka të bëjë vetëm me dizajnimin e hapësirës fizike, pasi që njerëzit e zhvillojnë jetën e tyre pikërisht brenda këtyre hapësirave, jo rrallë në mospërputhje me qëllimet origjinale të planerëve. Planifikimi urban duhet të përfshijë një koncept shumë më të gjerë social e kulturor, sesa vetëm vizatimi i vijave me ngjyra të ndryshme mbi një copë letër.

Ekziston një nevojë imediate për ridefinimin e rolit të kulturës në politika publike në përgjithësi, e në planifikim urban në veçanti. Arti dhe kultura duhet të kenë mjete komunikimi me sferat e tjera të politikave, si psh. planifikimi hapësinor, zhvillimi ekonomik, turizmi, rinia dhe arsimit, politika e jashtme, qeverisja lokale, etj. Kjo do të promovonte qasjen e re qeveritare ndaj kulturës, duke e vendosur atë në qendër të planifikimit të politikave shtetërore. Kjo qasje, përveç që ndikon në rritjen e buxhetit shtetëror për kulturën, do të siguronte ndërveprimin e kulturës me sistemin arsimor dhe edukimin artistik të fëmijëve, planifikimin hapësinor dhe mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik përmes industrive kreative, politikën e jashtme dhe diplomacinë kulturore, qeverisjen lokale dhe sferat e tjera potenciale.⁵⁰

Situata aktuale

Planifikimi hapësinor (dhe urban) është ndër mangësitë themelore të dy nivele të qeverisjes, ndërsa ky sektor pothuaj nuk ka komunikim institucional me atë të trashëgimisë kulturore. Menjëherë pas lufte dhe në vakuumin e përgjithshëm ligjor e institucional, qytetet e Kosovës u përfshinë nga një valë agresive ndërtime, që erdhën si reagim ndaj nevojave të mëdha të krijimit të hapësirave të reja të banimit dhe zhvillimit të aktiviteteve të biznesit. Shkaku kryesor i këtij zhvillimi ishte migrimi i brendshëm rural – urban, i cili ka shtuar në mënyrë drastike numrin e popullsisë në qendrat urbane të Kosovës. Përveç mungesës së legjislacionit qendror për planifikim hapësinor, sistemi institucional i Kosovës ishte i papërgaditur edhe në nivelin komunal. Me struktura mjaft të brishta të qeverisjes dhe menaxhimit urban, komunat e Kosovës kishin shumë pak mundësi të kontrollojnë këtë urbanizim kaotik. Për më tepër, ishin vetëm zyrtarët komunalë, ata që u përfshinë në mënyrë direkte në shumë parregullsi urbanistike të kësaj periudhe, të cilat me intensitet të ndryshëm vazhdojnë të ndodhin edhe sot.⁵¹

Njëra nga pasojat më të dhimbshme të këtij procesi ishte ndërtimi i pakontrolluar në zonat që gëzojnë statusin e qendrave historike. Qytetet e vjetra të Prishtinës, Prizrenit dhe Gjakovës janë ndër më të prekurat, ndërsa këtij fati nuk i kanë shpëtuar as qytetet e tjera të Kosovës. Institucionet e shtetit, në të dyja nivelet e qeverisjes, as sot nuk e kanë krijuar sistemin e koordinimit mes dy sferave të politikave publike, planifikimit hapësinor (dhe urban) dhe mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Me një fjalë, planifikimi hapësinor dhe urban vazhdon të mbetet një sferë e izoluar e hartimit dhe zbatimit të politikave, duke e neglizhuar në tërësi nevojën për të marrë në konsideratë mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Në nivelin qendror, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Mjedisit dhe

⁵⁰ Forumi Kulturor, Pse na duhet një strategji e kulturës?, 2012, në <http://forumikulturor.net/cms/wp-content/uploads/2012/11/Pse-na-duhet-nj%C3%AB-Strategji-e-Kultur%C3%ABs.pdf>

⁵¹ EC Ma Ndryshe për Forumin 2015, Gabim pas Gabimi, 2013, në http://ecmandryshe.org/repository/docs/Gabim_pas_gabimi_ALB.pdf

Planifikimit Hapësinor i kanë hartuar dhe miratuar të gjitha ligjet dhe politikat e rëndësishme pa e involvuar njëra tjetrën.⁵²

Në nivelin komunal, moskomunikimi institucional është edhe më fatal për fatin e trashëgimisë kulturore. Pothuaj në të gjitha rastet, drejtoritë komunale të urbanizmit dhe planifikimit hapësinor dështojnë të koordinohen me Institutet për Mbrojtjen e Monumenteve të Kulturës. Janë konstatuar me dhjetëra raste të shkeljes së pëlqimeve që i lëshojnë këto institute, si nga ana e institucioneve komunale, ashtu edhe vetë ndërtuesit. Sektori i ndërtimeve në Kosovë vazhdon të jetë njëri ndër më të përfolurit për keqpërdorime dhe korrupsion.⁵³ Konkretisht, disa zyrtarë të komunës së Prizrenit dhe disa kompani ndërtimi janë nën hetime nga Prokuroria e Qarkut për parregullsi urbanistike.⁵⁴ Ndonëse zhvillimi i hetimeve nuk paragjykon asgjë mbi vërtetësinë e akuzave, numri i konsiderueshëm i rasteve hetimore është tregues i mirë i parregullsive në urbanizëm.

Prizreni është një rast tipik i dështimit të institucioneve të shtetit në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Degradimi i vlerave të Qendrës Historike të qytetit ka ardhur si pasojë e mosrespektimit të kornizës ligjore për trashëgiminë kulturore nga të dyja nivelet e qeverisjes. Derisa MKRS nuk e ka kryer obligimin e vet mbikëqyrës, qeveria lokale e Prizrenit ka qenë e paaftë në parandalimin e veprimeve shkatërruese të ndërtuesve në dëm të trashëgimisë kulturore. Më keq se kaq, qeveria lokale e Prizrenit, me shpërfilljen e ligjeve, Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit⁵⁵ dhe planeve rregullative urbane,⁵⁶ ka qenë kontribuesi kryesor në procesin e zhdukjes së vlerave kulturore dhe historike të qytetit.⁵⁷

Kosova (rrjedhimisht edhe Prizreni) ende nuk ka zhvilluar qasje të integruar të planifikimit dhe zhvillimit të politikave. Në rastin konkret, politika e konservimit të integruar paraqet domosdoshmërinë për koordinim institucional për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Një qasje e tillë presupozon se trashëgimia kulturore është përgjegjësi shumë më e gjerë se sa e një institucioni të vetëm. Konservimi i integruar ka të bëjë me bashkëpunimin ndërsektoral mes organeve të ndryshme publike administrative, si dhe me koordinimin e masave legjislative në mënyrë që të plotësojnë dhe zgjerojnë njëra tjetrën.⁵⁸

Konkretisht, struktura institucionale e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore në Kosovë, përtej kompetencave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përfshin edhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe qeveritë lokale. Në këtë pikë, mund të shihet më së miri paaftësia e institucioneve të Kosovës për të krijuar një strukturë shtetërore për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

⁵² Në mesin e këtyre ligjeve dhe politikave bëjnë pjesë Ligji për Trashëgiminë Kulturore, Politika e Konservimit të Integruar të Trashëgimisë Kulturore, Ligji për Planifikimin Hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës

⁵³ EC Ma Ndryshe, Më në fund – hetime për krimin urbanistik në Prizren, në http://www.online-transparency.org/repository/docs/Komunikate_9.08.pdf

⁵⁴ Zëri, Banesat që shpiejnë të krimi, në <http://www.zeri.info/artikulli/1/1/58630/banesat-qe-shpiejne-te-krimi/>

⁵⁵ Komuna e Prizrenit, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, 2008, në <http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/25fdb992-4fa8-4623-9811-ae22a0bd6b2a/Plani-i-Konservimit-dhe-Zhvillimit-te-Zones-Histor.aspx>

⁵⁶ Komuna e Prizrenit, Planet Rregullative, në <http://kk.rks-gov.net/prizren/Projects/Planet-Rregullative.aspx>

⁵⁷ EC Ma Ndryshe për Forumin 2015, Gabim pas Gabimi, 2013, në http://ecmandryshe.org/repository/docs/Gabim_pas_gabimi_ALB.pdf

⁵⁸ Baza e parimeve të konservimit të integruar për herë të parë u vendos në Kartën Evropiane të Trashëgimisë Arkitekturale dhe Deklaratën e Amsterdimit, miratuar në vitin 1975 nga Komisioni i Ministrave i Këshillit të Evropës

Në të njëjtën kohë, kjo situatë është dëshmi dhe pasojë direkte e mungesës së një Plani Kombëtar në këtë sektor.⁵⁹

Të gjeturat

Katër çështjet kryesore sipas përfqësuesve të organizatave kulturore apo aktivistëve që merren me trashëgimi kulturore janë: shkatërrimi i qendrës historike të qytetit, ndotja e ajrit mungesa e një plani për zhvillim të qëndrueshëm dhe problemet e qarkullimit për persona me aftësi të kufizuar.⁶⁰ Këto të gjetura të anketimit me mostër të gjerë në Prizren konfirmohen edhe nga fokus grupet dhe debatet e organiizuara me grupin e komunitetit të kulturës në kuadër të projektit “Qyteti Gjithëpërfshirës...”.

Gjatë fokus grupeve të projektit me komunitetit e kulturës, në pah kanë dal shumë shqetësime të këtij sektori në raport me planifikimin urban. Në pjesën pasuese, këto të gjetura janë të paraqitura të grupara në kuadër të trashëgimisë kulturore, degradimit urban dhe turizmit kulturor.

Trashëgimia kulturore

- Objektet e trashëgimisë kulturore, përveç mungesës së investimeve të nevojshme për ruajtjen e tyre, ballafaqohen edhe me mungesë të shenjzimit, ndriçimit dhe rrethimit adekuat,
- Shtëpitë e vejtra qytetare janë në gjendje të rëndë, e dëshmi e kësaj janë edhe fasadat e tyre të cilat në mënyrë të dukshme shpërfaqin moskujdesin institucional,
- Hamami i Gazi Mehmed Pahës ka pësuar me vite të tëra nga mungesa e një plani restaurues dhe menaxhues, ndërsa një pjesë e madhe e dëmeve janë të pariparueshme,
- Komuna ka qenë investuese e disa projekteve restauruese të cilat janë kryer në kundërshtim me parimet profesionale të intervenimit. Rast tipik është projekti i shtëpisë së Shuaip Pashës, i cili përveç tjerash, ka mbet edhe pa një plan të menaxhimit,
- Qytetarët dhe shoqëria civile shumë shpesh kanë ndërmarrë veprime konkrete për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, por një pjesë e madhe e tyre nuk kanë patur ndikim real për shkak të apatisë dhe mosinteresimit të institucioneve shtetërore,
- Qytetarët nuk janë treguar shumë të interesuar për të marrë pjesë në diskutime publike, sidomos për hartimin e planeve urbane,
- Ka mungesë angazhimi për të ngritur vetëdijen e fëmijëve dhe nxënësve shkollorë për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe angazhimin e tyre për mbrojtjen e qytetit,
- Komuna dhe autoritetet e zbatimit të ligjit shpesh janë të paafta t’i ndalin veprimet e paligjshme në Qendrën Historike për shkak të mungesës së vullnetit për t’u ballafaquar me persona që konsiderohen të fuqishëm dhe mbi ligjin,

Degradimi urban

- Përgjegjësia për degradimin e trashëgimisë kulturore është e ndarë mes qeverisë lokale, asaj qendrore dhe vetë qytetarëve të Prizrenit,
- Ka mungesë të theksuar koordinimi mes institucioneve, sidomos mes komunës dhe Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore,
- Edhe brenda komunës, planifikimi urban funksionon pothuaj tërësisht i shkëputur nga sektorët e kulturës, inspektoratit dhe turizmit, duke e pamundësuar qasjen e planifikimit të integruar,

⁵⁹ EC Ma Ndryshe për Forumin 2015, Gabim pas Gabimi, 2013, në http://ecmandryshe.org/repository/docs/Gabim_pas_gabimi_ALB.pdf

⁶⁰ EC Ma Ndryshe, Planifikim urban për qytetarët, 2013, në http://ecmandryshe.org/repository/docs/ANALIZA_Planifikim_urban_per_qytetaret.pdf

- Ndërtimet pa leje, sidomos ato brenda Qendrës Historike të Prizrenit, janë shkaktari kryesor i degradimit të trashëgimisë kulturore,
- Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit, i miratuar nga Kuvendi i Komunës më 2008 është dokument që është shkëlur në mënyrë sistematike nga vetë autoritetet komunale,

Turizmi kulturor

- Qyteti nuk ka arritur të strukturojë dhe paraqesë ofertën e vet kulturore dhe turistike, ndërsa mungojnë edhe produktet bazike si pakot turistike,
- Ndonëse kohëve të fundit janë prodhuar disa materiale promovuese për turizmin kulturor, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk janë me përmbajtje dhe prezantim atraktiv për turistin,
- Info Qendra turistike e vendosur brenda objektit të Beledijes funksionon me kapacitete të kufizuara, ndërsa nuk i shërben ndonjë numri të madh vizitorësh, kryesisht për shkak të lokacionit të fshehtë,
- Jo vetëm Prizreni, por edhe Kosova në përgjithësi ka mungesë ekspertësh të turizmit, ndërsa shpesh turizmi nuk trajtohet si pjesë integrale e planifikimit të politikave kulturore, trashëgimisë kulturore zhvillimit urban e rural, zhvillimit ekonomik, etj,
- Mungojnë cicëronët e shkolluar, që njohin mirë historinë e kulturës së Prizrenit dhe që kanë aftësi komunikuese në disa gjuhë të huaja,
- Kalaja e qytetit si destinacioni më i rëndësishëm turistik i qytetit, është pa kurrfarë përkujdesje, derisa nuk ka as një plan për revitalizimin e hapësirës së saj,
- Prizrenit i mungon një mekanizëm matës për zhvillimin e turizmit, i cili do të përpilonte analiza në aspektin hapësinor, duke ofruar të dhëna mbi zhvillimin e turizmit, numrin dhe profilin e vizitorëve, hapësirën e nevojshme për turizëm, etj,
- Mungesa e politikave adekuate për zhvillimin e turizmit kulturor është treguesi më i mirë i përkushtimit të mangët të qeverisë lokale për zhvillimin e turizmit.

Rekomandimet

Bazuar në të gjeturat e projektit përmes fokus grupeve, debateve, anketimeve me qytetarë, si dhe dokumenteve dhe analizave ekzistuese në fushën e kulturës (trashëgimisë kulturore) dhe planifikimit urban nga EC Ma Ndryshe dhe organizatat e institucionet e tjera të sektorit, në vijim janë rekomandimet specifike për qeverinë lokale të Prizrenit për integrimin e komponentës së kulturës (konkretisht trashëgimisë kulturore) në hartimin dhe zbatimin e planeve urbane.

- Ekziston një nevojë imediate për ridefinimin e rolit të kulturës në politika publike. Arti dhe kultura duhet të kenë mjete komunikimi me sferat e tjera të politikave, si psh. planifikimi hapësinor, zhvillimi ekonomik, turizmi, rinia dhe arsimit, politika e jashtme, qeverisja lokale, etj. Prizreni ka nevojë për një strategji të zhvillimit të kulturës që do të promovonte qasjen e re ndaj kulturës, duke e vendosur atë në qendër të planifikimit të politikave publike komunale, me theks të veçantë në planifikimin urban,
- Respektimi i përpiktë i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor, ku çdo pëlqim i lëshuar nga kjo qendër duhet të jetë detyrues për komunën e Prizrenit, pasi që ato bazohen në standardet ndërkombëtare dhe ligjet shtetërore të trashëgimisë kulturore. Prandaj, çdo tejkallim i masave të parapara me pëlqime të QRTK-së duhet të pengohet dhe/ose të ndëshkohet nga autoritetet lokale dhe qendrore,

- Hartimi i planit lokal të trashëgimisë kulturore do të ndihmonte planifikimin strategjik të trashëgimisë kulturore, ndërsa komuna e Prizrenit do të valirizonte një potencial të rëndësishëm për zhvillimin lokal ekonomik. Plani lokal i trashëgimisë kulturore do të hapte rrugë edhe për koordinim më të mirë ndër-sektoral bazuar në parimet e konservimit të integruar (sidomos me planifikimin urban),
- Koordinim efektiv mes drejtorive për urbanizëm dhe inspektorat, ngase dështimi për të komunikuar mes këtyre dy sektorëve është fatal për trashëgiminë kulturore. Kryetari i komunës duhet të kushtojnë vëmendje të veçantë koordinimit të urbanizmit dhe inspektoratit në parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe tejkalimeve të tjera,
- Rritja e koordinimit inspektorat – urbanizëm – QRTK për ruajtjen e trashëgimisë kulturore është parakusht i funksionimit adekuat institucional në shërbim të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore,
- Rrënimi i ndërtimeve pa leje në Qendrën Historike të Prizrenit për të parandaluar zhdukjen totale të trashëgimisë kulturore. Autoritetet komunale duhet të ndërmarrin veprime konkrete për rrënimin e ndërtimeve pa leje dhe tejkalimeve të tjera që janë në kundërshtim me parimet e trashëgimisë kulturore,
- Përfshirja e trashëgimisë kulturore në hartimin e planeve urbane duhet të jetë komponentë qendrore e planifikimit urban në Prizrenit. Gjatë hartimit të Planeve Zhvillimore Komunale, Planeve Zhvillimore Urbane dhe Planeve Rregullative Urbane, komunat duhet të respektojnë të gjitha parimet e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore,
- Hartimi i strategjisë për turizëm kulturor, ndërsa planifikimi dhe realizimi i kësaj politikave lokale duhet të ndjekë linjën e integruar, sipas të cilës zhvillimi kulturor nënkupton koordinimin mes shumë sektorëve të politikave lokale,
- Buxhetimi me pjesëmarrje në sektorin e kulturës është kusht elementar i demokracisë në qeverisjen dhe planifikimin e qytetit. Komuniteti i kulturës duhet të jenë pjesë e definimit të buxhetit komunal, e sidomos për pjesën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore,
- Fokus më i madh në përmbajtje kulturore (aktivitete) se sa në infrastrukturë, pasi që zhvillimi kulturor nuk mund të realizohet vetëm përmes investimeve në hapësira fizike. Krijimi dhe pasurimi i përmbajtjes kulturore (prodhimtarisë artistike) është në thelbin e ofertës kulturore dhe turistike të qytetit,
- Respektimi i të gjitha ligjeve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Prizrenit, si obligim i panegociueshëm i institucioneve qendrore dhe lokale për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të Prizrenit,
- Krijimi i një mentaliteti të ri ku trashëgimia kulturore të jetë pjesë e kurikulës shkollore dhe të mësuarit për trashëgiminë kulturore do të fillojë në shkollën fillore, duke e përfshirë lëndën përkatëse në kurrikulat zyrtare shkollore,

- Përcaktimi i kriterëve për ndarjen e granteve për kulturën e pavarur (shpenzimi i buxhetit komunal për kulturën e pavarur) duhet të realizohet përmes një sistemi të kriterëve dhe të bazuar në merita.

EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “EC Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t’i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2014), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – Ilogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qytet i kulturës” - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “Online Transparency”,; 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale ne Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).